



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Maj 2022



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Nr.	PËRMBAJTJA	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-13
I.1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4-6
I.2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	6-12
I.3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	12-13
II.	HYRJA	13-18
II.1.	Objekti i auditimit	
II.2.	Qëllimi i auditimit	
II.3.	Identifikimi i çështjes	
II.4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
II.5.	Përgjegjësitë e audituesve	
II.6.	Kriteret e vlerësimit	
II.7.	Standardet e auditimit	
II.8.	Metodat e auditimit	
II.9.	Dokumentimi i auditimit	
III.	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	18-140
III.1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	18-20
III.2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	20-140
III.2.1	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin	20-32
III.2.2	Mbi auditimin e brendshëm	32-37
III.2.3	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	37-117
III.2.4	Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2020	118-132
III.2.5	Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit	132-135
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	135-149



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Shkurtime

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PBA	Projekt-Buxheti Afatmesëm
PF	Pasqyrat Financiare
TNI	Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
USH	Urdhër Shpenzimi
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim financiar në Bashkinë Mat, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e implementimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, si dhe të transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar. Gjithashtu pjesë e këtij auditimi ishte edhe trajtimi i ankesës së banorëve të Njesisë Administrative Derjan, Bashkia Mat, me objekt óShkalla e ndjekjes nga autoritetet publike të përfshira, të kuadrit juridik përkatës lidhur me projektin e HEC-eve Sekë dhe Zais, brenda Parkut Kombëtar Lurë Mali i Dejësô, administruar në KLSH me shkresën nr.82 prot., datë 17.01.2022. Gjatë periudhës së auditimit nga data 19.01.2022 deri më datë 25.02.2022, grupi i auditimit auditoi periudhën nga data 01.01.2019 deri më datë 31.12.2021.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej 9 akt-konstatime dhe 1 akt-verifikim. Në përfundim të punës audituese në terren është kryer takimi ballafaques me përfaqësuesit e Bashkisë Mat. Mbi aktet e mbajtura dhe Projekt Raportin e grupit të auditimit, nga subjekti i audituar, janë paraqitur observacionet, të cilat janë reflektuar rast pas rasti në mënyrë të përmbledhur nga grupi i auditimit.

Në mënyrë të përmbledhur, në përfundim rezultoi se nga auditimi:

-Kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Mat me palët e treta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (përlllogaritje e gabuar e tarifave, mosaplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e tarifave të qirave, etj), veprime dhe mosveprime të cilat kanë krijuar dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën **21,133,920 lekë**.

-Të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifave vendore, për periudhën 2019-2021, u konstatua se, në fund të vitit 2021 në Bashkinë Mat dhe NJA borxhi tatimor është në vlerën **76,416,391 lekë** vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Mat.

-Procedurave të ndjekur për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV dhe Policia Bashkiake, u konstatua se, për gjobat e vendosura nga IMTV dhe Policia Bashkiake, nga Titullari i Bashkisë Mat dhe Kryeinspektori i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit nuk është bërë kërkesë në gjykatën përkatëse për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të tyre, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën **4,476,742 lekë** me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Mat.

-Dokumentacionit mbi përlllogaritjet për taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit për subjektet óBiznesi Vipô, óBiznesi i Madhô dhe óBiznesi i Vogëlô, që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë Mat, u konstatua se, për periudhën 2019-2021 janë përjashtuar/përlllogaritur gabim taksa e ndërtesës dhe tarifa e shërbimit për subjektet e mësipërme, konkretisht: Për taksën e ndërtesës 10 subjekte óbiznesi i madhô, 40 subjekte óbiznesi i vogëlô dhe 6 subjekte me aktivitet HEC; Për tarifën e shërbimit 42 subjekte óbiznesi i madhô dhe 10 subjekte me aktivitet HEC, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën **15,148,685 lekë**, me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Mat.

-Dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve u konstatua se, në 18 raste të subjekteve, që operojnë në territorin në Juridiksionin e Bashkisë Mat nuk është aplikuar saktë tarifa e licencimit, me pasojë të ardhura të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

munguara në vlerën prej **18,850,000 lekë** për buxhetin e Bashkisë Mat. Gjithashtu konstatohet se, 14 subjekte për 17 stacione të shitjes së karburanteve, të cilët kanë ushtruar aktivitet për tregtimin e karburanteve përgjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2021, nuk janë pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit, si dhe 3 prej tyre, nuk janë të regjistruar në QKB, duke operuar në informalitet.

-Procedurave për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e shërbimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike në territorin e Bashkisë Mat, ukonstatua se, për periudhën 2019-2021 kanë kryer punime ndërtimi me fondet e Bashkisë Mat, 10 operatorë ekonomik të shpallur fitues, nga të cilët vetëm 1 prej tyre ka paguar tarifën e shërbimit dhe 9 të tjerë jo, duke krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ për buxhetin e Bashkisë në vlerën **550,667 lekë**.

-Vendimeve gjyqësore me objekt 0Dëmshpërblimin për largim nga puna pa shkaqe ligjore, ka pasur 5 raste të punonjësve që kanë ankimuar në gjykatë ndaj Bashkisë Mat për largime nga puna pa shkaqe të arsyeshme ligjore, për të cilët ka përfunduar gjykimi dhe vendimi ka marrë formë të prerë për shumën 11,638,547 lekë, një pjesë e të cilave i përkasin periudhave të para këtij auditimi. Për likuidimin e detyrimit të mësipërm janë kryer pagesa pjesore në vlerën **1,930,648 lekë**, që përbëjnë efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Mat (praktikisht paguhen dy persona për një vend pune) duke ndikuar në performancën financiare dhe funksionale të institucionit.

-Kontratave për investime të Bashkisë Mat, financuar nga Ministria e Linjës, në 3 raste në vlerën 2,247,632,489 lekë, janë ndërmarrë angazhime buxhetore duke hyrë në marrëdhënie kontraktuale me operatorë ekonomik, për investime në punë publike, pa pasur në dispozicion fondet e plota për realizimin e kontratës.

-Planifikimit të procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli, konstatohet se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet në nivele të ulta në vitin 2019, konkretisht në masën 75%, në vitin 2020 duke ardhur me një rritje të tyre në vlerën 91%, si dhe duke vijuar me vitin 2021 në vlerën 88%.

-Raportimit të transaksioneve dhe ngjarjeve ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2020, ka rezultuar kontabilizimi jo i saktë dhe i drejtë për:

-Llogarinë 213 0Rrugë, rrjete, vepra ujore është pasqyruar më shumë për vlerën 185,352,032 lekë;

-Llogarinë 202 0Studime e kërkime" është pasqyruar më shumë për vlerën 30,066,269 lekë;

-Llogarinë 26 0Pjesëmarrje në kapitalin e vetë është pasqyruar më pak për vlerën 729,777,000 lekë;

-Llogarinë 466 0Kreditorë për mjete në ruajtje është pasqyruar më shumë për vlerën 5,841,471 lekë për vitin 2020 dhe 5,037,881 lekë për vitin 2019;

-Llogarinë 467 0Kreditorë të ndryshëm është pasqyruar më pak për vlerën 14,330,439 lekë.

-Zbatimit të dispozitave ligjore për implementimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm u konstatua se, akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët e MFK si: 0Mjedisi i kontrollit, 0Menaxhimi i Riskut, 0Aktivitetet e Kontrollit, 0Informimi dhe Komunikimi dhe 0Monitorimi;

-Veprimtarisë së Sektorit të Auditit të Brendshëm në Bashkinë Mat për periudhën objekt auditimi, NJAB nuk ka vlerësuar si duhet riskun, duke mos audituar drejtoritë që mbartin risk të lartë. Për rekomandimet e lëna nuk ka analizuar dhe nuk ka hartuar program të veçantë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, si dhe nuk ka bërë kontrollin e cilësisë për çdo auditim, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Ankesës së bërë ngabanorët e Njësisë Administrative Derjan, Bashkia Mat, në përfundim rezultoi se gjatë procesit të vendimmarrjes së Këshillit të Bashkisë Mat, finalizuar me VKB nr.110, datë 20.12.2018, për miratimin e kërkesës për heqjen nga fondi pyjor dhe kullor të sipërfaqes së kërkuar nga subjekti S. H., nuk është marrë asnjë masë për pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes, si dhe të kryerjes së seancave të këshillimit me publikun.

-Nuk është lidhur marrëveshja ndërmjet Bashkisë Mat dhe subjektit S.H, për ripyllëzimin e fondit pyjor dhe kullor të hequr, me qëllim mbrojtjen dhe rehabilitimin e tij.

I.2. Në mënyrë të përmblëdhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon.

Gjetja	Përmblëdhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Mat me palët e treta, u konstatua se nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve, Sektori i Infrastruktursë, Emergjencës dhe Pronave, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (përlllogaritje e gabuar e tarifave, mosaplikim i kamatvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e tarifave të qirave, etj), veprime dhe moveprime të cilat kanë krijuar dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën 21,133,920 lekë, nga të cilat 4,682,674 lekë krijuar brenda vitit 2021.	28-109	E Lartë	Kryetari i Bashkisë Mat të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës 21,133,920 lekë, sipas aneksit nr.VII, bashkangjitur raportit përfundimtar të auditimit. Menjëherë
2	Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifat vendore, për periudhën 2019-2021, u konstatua se në fund të vitit 2021 në Bashkinë Mat dhe NJA janë debitor 425 subjekte në vlerën 39,819,389 lekë (11,036,034 lekë debitor krijuar brenda vitit 2021), vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Mat, e ndarë si më poshtë vijon: -5 subjekte óBiznesi Vipó debitor në vlerën 5,114,318 lekë -59 subjekte óBiznesi i Madhó në vlerën 13,890,241 lekë -273 subjekte óBiznesi i Vogëló në vlerën 16,659,480 lekë -10 subjekte óLojra Fatió në vlerën 722,515 lekë -2 subjekte óKompani sigurimeshó në vlerën 60,500 lekë -46 subjekte óTregtar Ambulantó në vlerën 1,053,335 lekë -30 subjekte óInstitucioneó në vlerën 2,319,000 lekë.	28-109	E Lartë	Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë Mat, me qëllim përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët (bllokim të llogarive bankare, njoftim të Drejtorisë Rajonale të Transportit për vendosje të barrës siguroese për mjetet dhe në ASHK për pasuritë e paluajtshme, etj) për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, në vlerën 39,819,389 lekë. Menjëherë
3	Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga	28-109	E Lartë	Kryetari i Bashkisë Mat të marrë masat e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	taksat dhe tarifat vendore, për periudhën 2019-2021, u konstatua se në fund të vitit 2021 në Bashkinë Mat dhe NJA, vlera debitore e kategorisë ofamiljarë është 36,597,002 lekë (26,950,964 lekë debitor krijuar brenda vitit 2021), vlerë e cila përbën të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Mat, e ndarë si vijon: -5,094 familje debitore nga 11211 gjithësej, në vlerën 1,018,800 lekë për tarifën e ndriçimit; -10,676 familje debitore nga 11211 gjithësej, në vlerën 13,578,900 lekë për tarifën e shërbimit (pastrim, gjelbërim, dekor); -9323 familje debitore nga 11211 gjithësej, në vlerën 8,692,984 lekë për taksën e ndërtesës; -5351 familje debitore nga 11211 gjithësej, në vlerën 460,480 lekë për taksën e truallit; -10,666 familje debitore nga 11211 gjithësej, në vlerën 3,199,800 lekë, për tarifën e infrastrukturës arsimore.			nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar si pasojë e detyrimeve të krijuara nga puna e dobët e UK ShA., Mat (në rolin e agentit tatimor) për taksat dhe tarifat vendore nga abonentët familjarë, me qëllim marrjen e përgjegjësiwe ligjore nga palët dhe shmangien e veprimeve abuzive në mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore. Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Administratorët e Njësiwe Administrative, të marrë masa për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifat vendore si edhe të përditësohet regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave. Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 36,597,002 lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë. Menjëherë
4	Nga auditimi i dokumentacionit mbi përlogaritjet për taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit për subjektet òBiznesi Vipò, òBiznesi i Madhò dhe òBiznesi i Vogëlò, që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë Mat, u konstatua se, për periudhën 2019-2021 janë përjashtuar/përlogaritur gabim taksa e ndërtesës dhe tarifa e shërbimit për subjektet e mësipërme, konkretisht: Për taksën e ndërtesës 10 subjekte òbiznesi i madhò, 40 subjekte òbiznesi i vogëlò dhe 6 subjekte me aktivitet HEC; Për tarifën e shërbimit 42 subjekte òbiznesi i madhò dhe 10 subjekte me aktivitet HEC, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën 15,148,685 lekë, në buxhetin e Bashkisë Mat.	28-109	E Lartë	Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masat e nevojshme, duke vlerësuar dokumentacionin (kontratë qiraje, dokument pronësie, leje ndërtimi, etj), kryer verifikimet në terren për subjektet e mësipërme, si dhe në vijim, njoftimin për vlerësimin e detyrimit tatimor, si dhe ndjekjen e të gjithë procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës 15,148,685 lekë. Menjëherë
5	Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Mat, konkretisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore, u konstatua se në 6 raste për vlerën 14,262,191 lekë, nuk është respektuar rradha e likuidimit të tyre, sipas parimit òhyrje e parë-dalje e parëò, si dhe nuk janë kryer likuidimet e plota të detyrimeve, megjithëse Bashkia Mat në fund të viteve 2019-2020-2021 ka patur disponibilitete në thesar. -Sipas të dhënave të Sektorit Juridik, ka pasur 5	28-109	E Lartë	Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura nga vendimet gjyqësore, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit. Kryetari i Bashkisë Mat të marrë masat e nevojshme për analizimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, duke identifikuar personat përgjegjës dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	raste të punonjësve që kanë ankimuar në gjykatë ndaj Bashkisë Mat për largime nga puna pa shkaqe të arsyeshme ligjore, për të cilët ka përfunduar gjykimi dhe vendimi ka marrë formë të prerë për shumën 11,638,547 lekë, një pjesë e të cilave i përkasin periudhave të para këtij auditimi. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë, si dhe në urdhrin e likuidimit nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij ka krijuar detyrime të Bashkisë Mat ndaj palëve të treta. Për likuidimin e detyrimit të mësipërm janë kryer pagesa pjesore në vlerën 1,930,648 lekë, që përbëjnë efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Mat (praktikisht paguhen dy persona për një vend pune) duke ndikuar në performancën financiare dhe funksionale të institucionit.			vendosjen e masave administrative ndaj tyre, si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Sektorin Juridik të bashkëveprojnë për shmangien e penalizimeve të tilla financiare. Menjëherë dhe në vijimësi
6	Nga auditimi i kontratave për investime të Bashkisë Mat, financuar nga Ministrinë e Linjës, konstatohet se, në 3 raste në vlerën 2,247,632,489 lekë, janë ndërmarrë angazhime buxhetore duke lidhur kontratë me operatorë ekonomik, për investime në punë publike, pa pasur në dispozicion fondet e plota për realizimin e kontratës.	28-109	E Lartë	Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të marrë masat e nevojshme në mënyrë që lidhja e kontratës me operatorët ekonomik të bëhet vetëm pasi fondi i nevojshëm sipas vlerës së kontratës, të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor. Për çdo rast të angazhimeve buxhetore, kryesisht të investimeve për punë publike, Nëpunësi Zbatues të japë opinion me shkrim, për fondin buxhetor që është i disponueshëm për lidhjen e kontratës përkatëse. Në vijimësi
7	Nga auditimi i raportit të inventarizimit të aktiveve të institucionit dhe kontratës së shërbimit të pastrimit në Bashkinë Mat, u konstatua: 1. Kontraktuesi i shërbimit të pastrimit të Bashkisë Mat, përpara vitit 2018, ka qenë kompania óKô shpk dhe administrator z. G. K. 2. Kontraktuesi i shërbimit të pastrimit të Bashkisë Mat, nga data 09.03.2018 deri 31.12.2021 ka qenë kompania óA. Gô shpk me dhe administrator të asaj periudhe z. K.M, si dhe administrator aktual z. B. B. Kjo kompani është përfaqësuar dhe i ka transferuar 100% të detyrimeve kontraktuale nëpërmjet prokurës nr.312 rep, nr.82/2 kol tek kompania óE 1ô shpk me dhe administrator z. K. K.. 3. Nga data 09.03.2018 deri 29.06.2019, kontenierët e bashkisë Mat, nuk i janë dorëzuar kontraktuesit óA- Gô shpk, megjithëse në	109-123	E Lartë	Kryetari i Bashkisë Mat të mmarë masa për ngritjen e një grupi pune për inventarizimin e aktiveve që janë nën përgjegjësinë materiale të Drejtorisë së Shërbimeve, duke përfshirë këtu dhe të gjitha aktivet që i janë dorëzuar shoqërisë A- G SHPK. Gjithashtu nga ana e Kryetarit të Bashkisë Mat, të ndërmerren hapa konkretë në evidentimin e kushteve në të cilën ka vepruar dhe ekzekutuar kontratën e shërbimit të pastrimit shoqëria A- G SHPK, në raport me AK Bashkia Mat, duke pasur parasysh evidencat që kanë dalë nga auditimi. Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	situacionet e tyre paraqiten zërat e grumbullimit të mbeturinave dhe marrja e tyre nga kontenierët për në vend depozitim. 4. Në datën 29.06.2019 u janë transferuar kontenierët, me një autorizim të datës 28.06.2019 në kundërshtim me ligjin dhe udhëzimin për ruajtjen e aktiveve, nga kompania óKô shpk me administrator z. G K , tek marrësi në dorëzim z. K. K, ky i fundit administrator i përfaqësueses óE 1ô shpk si dhe i biri i z. G. K (referuar statutit të themelimit të shoqërisë). 5. Referuar pikës 3, në popullatën e likuidimeve të faturave të kontraktuesit óA. Gô shpk për shërbimin e pastrimit të Bashkisë Mat nga data 09.03.2018 deri 29.06.2019, është përzgjedhur kampioni prej 2 muaj (shkurt, mars 2019). Në këtë kampion janë konstatuar situacione me zërat e punimeve grumbullimi i mbeturinave dhe marrja e tyre nga kontenierët për në vend depozitim. 6. Në ekstraktin historik të shoqërisë óA- Gô shpk, ekstrakt ky i nxjerrë në datën 04.02.2021 nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në seksionin óVende të tjera të ushtrimit të aktivitetit, në asnjë rast nuk paraqitet ushtrimi i aktivitetit në territorit të Bashkisë Mat. Gjithashtu kjo kompani nuk rezulton as në regjistrat e biznesit të Bashkisë Mat.			
8	Bashkia Mat, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të óUjësjeles Matô ShA. me NUIS óJ68103917Fô e cila është shoqëri aksionere me objekt óShërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mëmbajtja e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Numri i aksioneve është 1 me vlerë nominale 729,777,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 729,777,000 lekë Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Mat në óUjësjeles Matô ShA., në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2019 dhe 2020, më konkretisht në llogarinë 26 óPjesëmarrje në kapitalet e vetaô	109-123	E Lartë	Drejtorja e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të óUjësjeles Matô ShA me vlerë kontabël 729,777,000 lekë në debi të llogarisë 26 óPjesëmarrje në kapitalin e vetë dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet. Me mbylljen e bilancit kontabël të vitit të ardhshëm
9	Llogaria 467 óKreditorë të ndryshëmô paraqiten faturat e pa likuiduara, vendime gjyqësore dhe investime dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2020 paraqiten në shumën 19,924,791 lekë, e cila përbëhet nga:	109-123	E Lartë	Drejtorja e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë 467 óKreditorë të ndryshëmô, e cila është nënvlerësuar me 14,330,439 për vitin 2020. Ky sistemim të bëhet duke e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	- shpenzime të kryera por të pafinacuara për mallra dhe shërbime në masën 15,212,010 lekë - shpenzimet për vendime gjyqësore në shumën 3,750,850 lekë; - shpenzime të tjera për sigurime shoqërore ,shëndetësore dhe shpërbim këshilli dhe kryetarë fshatrash por të pa likuiduara në shumën 961,931 lekë. dhe që janë pasqyruar në llogarinë 486 në shumën 19,924,791 lekë. Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Mat nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar 3 pagesa faturash të cilat paraqiten të likujduara në 2021 por të paregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2020 me vlerë totale 14,330,439 lekë. Kjo procedurë mospasqyrimi në llogarinë 467 óKreditorë të ndryshëmó të detyrimeve për faturat e likujduara në 2021 por me kompetencë vitin 2020, përbën shtrembërim të informacionit financiar, duke qenë se detyrimet e prapambetura për vitin 2020 të përcjella në Ministrinë e Financave janë nënvlerësuar me 14,330,439 lekë.			transferuar këtë vlerë nga llogaria 41-408 óFurnitorë e llogari të lidhura me toó, në llogarinë 467 óKreditorë të ndryshëmó. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real. Me mbylljen e bilancit kontabël të vitit të ardhshëm
10	Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm u konstatua se akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si: <u>“Mjedisi i kontrollit”</u> Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit. Nga verifikimi rezulton se GSM nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë. Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GSM. Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive. <u>“Menaxhimi i Riskut”</u> Mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Nuk është bërë vlerësimi i riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, duke penguar marrjen e	9-22	E Mesme	Kryetari i Bashkisë Mat me atributet e Kryetarit të GSM në bashkëpunim me Koordinatorin e Riskut të institucionit, të marrë masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë. Menjëherë dhe në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar. <u>“Aktivitetet e Kontrollit”</u> - Bashkia Mat nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT. <u>“Informimi dhe Komunikimi”</u> - Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Nga Bashkia Mat kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, por konsultimet publike nuk janë të plota dhe mungon dokumenti i konsultimit publik. <u>“Monitorimi”</u> - Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Auditimi i Brendshëm nuk ka dhënë vlerësime të plota për sistemin e kontrollit të brendshëm.			

I.3. Konkluzione dhe opinioni i auditimit.

Për drejtimin e Bashkisë Mat.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Mat, për vitin ushtrimor 2020, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i modifikuar:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Sipas opinionit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705¹, dhe ISSAI 1200², pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të modifikuar për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Mat, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2020, të cilat janë të shprehura në bazën për opinionin e modifikuar.

Baza për opinionin e modifikuar³:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Mat, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISSAI 1700.7).

Në planifikim ne kemi llogaritur vlerën e materialitetit, bazuar në ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke marrë parasysh riskun e lartë të auditimit, ndaj të cilit për të marrë një siguri të arsyeshme, audituesi duhet të tolerojë një normë më të ulët të gabimit material. Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 është 31,415 mijë lekë. Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u evidentuan gabime materiale të cilat individualisht dhe si shumë, janë mbi nivelin e materialitetit të përcaktuar për vitin financiar të mbyllur në 2020 (materialiteti 31,415 mijë lekë), por nuk janë gabime materiale të përhapura në llogaritë vjetore të subjektit, fakt ky që përbën bazën e opinionit të modifikuar (ISSAI 1700.7). Për këto arsye kemi dhënë opinion të modifikuar, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Përshkrimi i çështjeve:

- Llogaria 213 óRrugë, rrjete, vepra ujoreô është pasqyruar më shumë për vlerën 185,352,032 lekë;
- Llogaria 202 óStudime e kërkime" është pasqyruar më shumë për vlerën 30,066,269 lekë
- Llogaria 26 óPjesëmarrje në kapitalin e vetô është pasqyruar më pak për vlerën 729,777,000 lekë;
- Llogaria 466 óKreditorë për mjete në ruajtjeô është pasqyruar më shumë për vlerën 5,841,471 lekë për vitin 2020 dhe 5,037,881 lekë për vitin 2019.
- Llogaria 467 óKreditorë të ndryshëmô është pasqyruar më pak për vlerën 14,330,439 lekë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Mat.

¹ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

² Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

³ Audituesi duhet të modifikojë opinionin në rastet kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Strukturat drejtuese të subjektit Bashkia Mat, Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareô.

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare.

Objekti i auditimit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II. HYRJA.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 óPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitô, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 53/1 Prot., datë 18.01.2022, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Mat nga data 19.01.2022 deri në datën 25.02.2022, u krye óAuditimi Financiarô, i cili mbuloi periudhën nga data 01.01.2019 deri më datë 31.12.2021, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K. K., Auditues, Përgjegjës Grupi.
2. E. C., Auditues, Anëtar.
3. A. G., Auditues, Anëtar.

II.1. Objektivi i auditimit.

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitet 2019, 2020 dhe 2021, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

II.2. Qëllimi i auditimit.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

II.3. Identifikimi i çështjes.

Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Mat, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Fushat të cilat u audituan janë si vijon:

1. Aktiviteti i Njësisë së Auditit të Brendshëm;
2. Implementimi dhe zbatimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
3. Planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit;
4. Raportimi financiar.

II.4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Niveli drejtues i Bashkisë Mat (Kryetari i Bashkisë, në rolin edhe të Nëpunësit Autorizues të institucionit) dhe niveli i mesëm drejtues (Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe të Ardhurave, në rolin e Nëpunësit Zbatues), kanë përgjegjësinë për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar; Për krijimin e kontroleve të brendshme të nevojshme, për të mundësuar përgatitjen e drejtë të pasqyrave financiare, pa keq-raportime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; dhe kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

II.5. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e audituesve është të shprehin konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim, pra nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar dhe rezultatet financiare të njësisë ekonomike janë në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi (ISSAI 1200.3). Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së arsyeshme.

Gjatë gjithë procesit të auditimit, audituesi duhet të ushtrojë gjykim dhe skepticizëm profesional dhe ndër të tjera: Identifikon dhe vlerëson risqet e keq-pasqyrimit material, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, bazuar në të kuptuarit e entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë. Merr evidencat e duhura dhe të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e keqraportimeve materiale. Formon një opinion për pasqyrat financiare dhe objektivat shtesë mbi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

të cilat raportimi është i detyrueshëm bazuar në përfundimet e nxjerra nga evidencat e grumbulluara. (ISSAI 1200.7) Raporton rastet e mospërputhshmërisë me bazën ligjore, përfshirë buxhetin dhe përgjegjshmërinë, dhe/ose Raporton mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

II.6.Kriteret e vlerësimit.

Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 óPër Organizimindhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.15, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit sa më poshtë:

Lloji i dokumentit:

Detajet e bazës ligjore dhe rregullatore

Standarde auditimi dhe kuadri ligjor i KLSH:

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj;
Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);
Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI^t, INTOSAI óPër implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit;
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 óPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit;
Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;

Ligje mbi të cilat mbështetet subjekti në aktivitetin e tij:

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 óPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar;
Ligji nr. 139/2015 óPër vetëqeverisjen vendore, i ndryshuar;
Ligji nr. 68/2017 óPër financat e vetëqeverisjes vendore;
Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 óPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;
Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 óPër auditimin e brendshëm publik;
Ligji nr. 25/2018 óPër kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare;
Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 óPër procedurat tatimore në RSH, i ndryshuar;
Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 óPër Sistemin e Taksave Vendore, i ndryshuar;
Ligj nr.9385, datë 4.5.2005 óPër pyjet dhe shërbimin pyjor, i ndryshuar.

VKM:

VKM nr. 807, datë 16.11.2016 óPër disiplinimin e angazhimeve buxhetore, i ndryshuar;
VKM nr. 970, datë 2.12.2015 óPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, i ndryshuar;
VKM nr.54, datë 5.2.2014 óPër përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, e ndryshuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Akte të tjera nënligjore:

VKM nr.391, datë 21.06.2006 óPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave, e ndryshuar;
VKM nr.83, datë 03.02.2016 óPër Miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik.
Udhëzimi MF nr. 8, datë 09.03.2018 óPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme, i ndryshuar;
Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik", i ndryshuar;
Udhëzimi MF nr. 22, datë 30.07.2018 óPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore;
Udhëzimi MF nr.10/1, datë 28.02.2017 óPër përgatitjen e buxhetit vendor, etj;
Udhëzimet vjetore të MFE për zbatimin e buxhetit;
Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 óMbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitet publike;
Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 21, datë 25.10.2016, óPër menaxhimin financiar dhe kontrollin;
Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, dt. 16.10.2017.
VKB për miratimin e rregullores mbi organizimin e funksionimit të Bashkisë Mat, etj;
VKB për miratimin e rregullores së Këshillit të Bashkisë Mat;
VKB për miratimin e paketave fiskale 2019-2021

Akte normative të Bashkisë Mat:

II.7.Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Projekt Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 100, 200, Manualit të Auditimit të Financiar, Rregullores së Procedurave të Auditimit, dhe sigurohet se auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar.

II.8.Metodat e auditimit.

1. Kontrolli aritmetik.
2. Kontrolli i vlerësimeve.
3. Konfirmimi nga të tretët.
4. Kontrolli sipas një treguesi.
5. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe MFK.

II.9.Dokumentimi i auditimit.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, akt-konstatimeve9 gjithsej dhe 1 akt-verifikimi, si dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili shërbeu për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

▪ **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

▪ **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivët, pasivët dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

▪ **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

III.PËSHKRIMI AUDITIMIT

III.1.Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

Zona Gjeografike: Bashkia e Matit kufizohet në veri me bashkinë e Mirditës, në perëndim me bashkinë e Kurbinit, në jug-perëndim me bashkinë Krujë, në jug me bashkinë Klos dhe në lindje me Bashkinë Dibër. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Burrelit.

Në vijim të miratimit dhe të implementimit të reformës administrative në territoriale me ligjin Nr. 115/2014 për ndarjen administrative në territoriale të njëjësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë në konteksti i ri i Bashkisë Mat ndërthur një mori traditash, burimesh natyrore, ekonomike dhe infrastrukturore. Me ndarjen e re administrative dhe territoriale, Bashkia Mat përbëhet nga 8 njësi administrative, si dhe nga 46 qytete/fshatra, të cilat shtrihen në një sipërfaqe totale prej rreth 493 km².

Bashkia	NJA	Qytete dhe fshatra përbërëse
Mat	Burrel	Burrel



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Baz	Baz, Fushë-Baz, Rreth Baz, Karicë, Drita, Bashkim
Derjan	Derjan, Urxallë, Barbullej, Dukagjin, Gjoçaj, Lam i Madh, Zall Gjoçaj
Rukaj	Bruç, Prellë, Rremull, Rukaj, Laç, Urakë
Macukull	Macukull, Dej Macukull, Shëlli, Vig, Shqefën
Komsi	Komsi, Kodër Qerre, Frankth, Selixë, German, Batër e Vogël, Batër e Madhe, Midhë, Fshati Burrel, Zall-Shoshaj
Lis	Lis, Vinjoll, Gjalish, Burgajet, Zenisht, Shoshaj, Mallunxë
Ulëz	Ulëz, Kokërdhok, Stojan, Madhesh, Lundre, Bushkash

Organizimi i BashkisëMat

Bashkia Matka nën varësi njësitë shpenzuese si: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja e Shoqërisë së Ujësjellës dhe Kanalizimeve óSH.A MATô.

Administrata e BashkisëMat përbëhet nga

532 punonjës, si më poshtë vijon:

-Këshilli Bashkiak (21 punonjës), Sekretari i Këshillit (1), Specialist për çështjet juridike (1);
-Kryetari (1), Nënkyetari (2) dhe Sekretari i Përgjithshëm (1), 5 Drejtori (5), 27 Sektorë (308), 4 funksione të deleguara (148), 8 Njësi Administrative (43);

-Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave, e cila përbëhet nga 2 Sektorë, Financë-Buxhet dhe i Tatim-Taksave (1+13);

-Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, e cila përbëhet nga 3 Sektorë, Burimet Njerëzore, Protokoll-Arkivës, Administrimit, IT (1+14);

-Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve, e cila përbëhet nga 3 Sektorë dhe 2 Brigada, Bujqësia, Pyjet, Kullimi, Druve të Zjarrit, Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit (1+44);

-Drejtoria e Shërbimeve Bashkiake, e cila përbëhet nga 5 Sektorë, Infrastruktura, Arsim-Sport-Kulturë, Ndërmarrja e Shërbimeve Bashkiake, Mirëmbajtja e Rrugëve Rurale, Menaxhimit të Mbetjeve (1+161);

-Drejtoria e Mbrojtjes Civile dhe Pronave, e cila përbëhet nga 3 Sektorë, Policia Bashkiake, MNZSH, Mbrojtja Civile dhe Pronat (1+32);

-Drejtoria e Shërbimeve Sociale, e cila përbëhet nga 2 Sektorë, Ndhurma Ekonomike-Paafësia-Strehimi, Barazia Gjinore-Dhuna-Mbrojtja e Fëmijëve (1+7).

-Gjithashtu ka në përbërje Sektorin e Auditit të Brendshëm, Sektorin e Urbanistikës, Apelimet Tatimor, Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Qendra e KAM, Sektori Juridik dhe Prokurimeve, Njësia për Koordinimin e Integritimit Evropian, Diasporës dhe Projekteve, si dhe funksionet e deleguara: Njësia për Koordinimin e Integritimit Evropian, Diasporës dhe Projekteve, QKB, Arsimi Parashkollor, Punonjës zëvendësues të arsimit (185).

-Njësitë Administrative (43).

III.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

III.2.1. Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *óPër menaxhimin financiar dhe kontrollin*, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar sistemin e drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njesisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Mat, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”.

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njesisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

- Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit. (Në zbatim të kërkesave të nenin 20 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

- Është hartuar dhe miratuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Mat me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 717 datë 24.11.2016 óMbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Mat dhe Njësive Administrative, si dhe me urdhër nr. prot 728 të datës 16.03.2018 ka miratuar Kodin e Etikës në të cilat përcaktohen dhe rastet e konfliktit të interesit për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion. Njohja e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë individuale, si dhe nuk ka trajnime për këto raste.

- Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë edhe në Rregulloren e Brendshme. Ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen.

- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sportelet e Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun), duke iu adresuar strukturave të Bashkisë sipas problematikave, të cilat do të trajtojnë ankesat dhe kërkesat dhe përgjigjet do të firmosen nga Drejtorët sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën. Kjo procedurë është përcaktuar në nenin 78 të Rregullores së Brendshme.

- Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip një herë në 6 muaj. Po ashtu ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Nga drejtuesi i institucionit, duhet të sigurohet mbikëqyrja e monitorimi i punës për secilin punonjës, në mënyrë që të sigurohet si duhet integriteti personal dhe etika profesionale, duke përjashtuar konfliktin e interesit në kryerjen e detyrave funksionale, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, në lidhje me nderjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, dhe kontrollin.

Në lidhje me parimin 2 ËTitullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

- Për vitet 2019-2021 nuk ka plan-veprimi për MFK, i cili të përfshijë aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit, mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

- Për vitin 2019, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit nuk janë hartuar çdo 4 - muaj, nuk ka raportime periodike por vetëm vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit fondevë dhe analizat faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak. Për vitet 2020 në 2021 Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë hartuar periodikisht dhe janë paraqitur pranë këshillit bashkiak si dhe në MFE. Ka Raportime periodike vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit fondevë dhe analizat faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Ndërsa nga shoqëritë e përbashkëta, ku bashkia është aksionere dhe nga ndërmarrjet në varësi të saj, Bashkia merr raportime në lidhje me vendim-marrjen e këshillit drejtues, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat, përveç raportimeve financiare për efekt argumentimi subvencionit.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe Njësia e Harmonizimit në MFE si dhe nga Projekti ëBashki të Fortaë.

- Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 ËTitullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

Struktura Organizative e Bashkisë Mat, e ndërmarrjeve dhe institucioneve në vartësi ka pasur disa ndryshime:

Për vitin 2019 Struktura është miratuar me Urdhër nr. 17 datë 21.01.2019 dhe ka në përbërje të saj 446 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara, me Urdhër nr. 111 datë 04.04.2019 dhe ka në përbërje të saj 448 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara, me Urdhër nr. 419 datë 25.09.2019 dhe ka në përbërje të saj 415 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara, me Urdhër nr. 629 datë 26.11.2019 dhe ka në përbërje të saj 423 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara.

Për vitin 2020 Struktura është miratuar me Urdhër nr. 41 datë 20.01.2020 dhe ka në përbërje të saj 426 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara, me Urdhër nr. 182 datë 17.03.2020 dhe ka në përbërje të saj 438 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara, me Urdhër nr.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

329 datë 21.05.2020 dhe ka në përbërje të saj 438 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara, me Urdhër nr. 411 datë 30.06.2020 dhe ka në përbërje të saj 470 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara, me Urdhër nr. 538 datë 07.08.2020 dhe ka në përbërje të saj 477 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara, me Urdhër nr. 666 datë 09.10.2020 dhe ka në përbërje të saj 477 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara, me Urdhër nr. 779 datë 04.12.2020 dhe ka në përbërje të saj 477 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara, me Urdhër nr. 848 datë 31.12.2020 dhe ka në përbërje të saj 485 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara.

Për vitin 2021 Struktura është miratuar me Urdhër nr. 255 datë 25.05.2021 dhe ka në përbërje të saj 485 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara.

- Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Mat është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

- Për periudhën objekt auditimi rezulton se, ka pasur ndryshime të shpeshta të strukturës, në numrin e saj, por edhe në krijimin apo shkrirjen e sektorëve/drejtorive, çka në gjykimin e grupit të auditimit ndikon negativisht në performancën institucionale dhe realizimin e objektivave.

- Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, por është bërë pjesë e dokumentit të PBA-ve, por këto nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme.

Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe planveprimeve të menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

Për çdo drejtori janë përcaktuar objekti, qëllimi, detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist, por nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. Në përcaktimin e pozicioneve nuk ka mbivendosje. Mungon raporti i vlerësimit nga njësi e auditit të brendshëm për përputhjen e rregullores me strukturën organike, ku nga grupi i auditimit është konstatuar se, rregullorja nuk reflekton ndryshimet në strukturë/funksione që ka pësuar Bashkia Mat përgjatë periudhës 2019-2021.

- Nuk është kryer vlerësimi i punës së strukturës organike, sepse bashkia duhet ta kryejë nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të vetëvlerësimit, të cilat nuk administrohen.

Në lidhje me parimin 4 ÒNjësi publike demonstron angazhimin në realizimin e kompetencave.

- Në Bashkinë Mat nuk është hartuar òHarta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetortë trajnimeve.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

- Për Bashkinë Nëpunësi Autorizues është Kryetari i Bashkisë, si dhe Zëvendëskryetari për dy funksione (autorizuar nga Kryetari i Bashkisë), i cili është menaxheri i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë, në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave.

- Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin, të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe e të Ardhurave.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Në lidhje me parimin 5 “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Në Rregulloren e Brendshme është parashikuar që Delegimi i kompetencave në zbatim të ligjit 44/2015 që Kodi i Procedurave Administrative si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokoll i institucionit rezultoi se, për periudhën objekt auditimi nuk ka patur Autorizime apo Urdhëresa për delegime detyrash me përjashtim të një rasti ku Kryetari i Bashkisë ka lëshuar Autorizim të Posaçëm, Znj. F. B për delegim të kompetencave me Urdhër nr. 1088 prot., datë 09.03.2020, e cila ka të drejtë të kryejë këto veprime: 1. Të kryejë procedurat e nënshkrimit elektronik në Sistemin Informatik i Qeverisë (SIFQ) që Web Portali AFMIS që degës së Thesarit, në cilësinë e që Nënpunës Autorizues, në lidhje me dërgimin e Urdhrave të Prokurimit dhe Formularëve të Njoftimit të procedurave të prokurimit që do të zhvillohen nga Bashkia Mat në cilësinë e Autoritetit Kontraktor; 2. Të kryejë procedurat e nënshkrimit elektronik në Sistemin Informatik i Qeverisë (SIFQ) që Web Portali AFMIS që degës së Thesarit, në cilësinë e që Nënpunës Autorizues, në lidhje me dërgimin e Marrëveshjeve/ kontratave të nënshkruara për mallra/shërbime/ punë të prokuruar nga Bashkia Mat në cilësinë e Autoritetit Kontraktor.

- *Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).*

Në zbatim të nenit nr. 24 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 që Për menaxhimin e sistemit buxhetor, i ndryshuar; ligji nr. 139/2015 që Për vetëqeverisjen vendore, i ndryshuar; ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 që Për financat e vetëqeverisjes vendore, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 që Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MFE nr. 23, datë 30.07.2018 që Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore, Bashkia Mat me Urdhër nr. 405 datë 18.12.2018 për periudhën 2019 ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik ku Kryetar i GSM ka qenë znj. A. SH zv/Kryetare e Bashkisë, dhe me urdhër nr.735 datë 19.12.2019 për periudhën 2021-2023 ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik ku kryetar i GSM është znj. F. B zv/Kryetare e Bashkisë.

Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) rezultoi se:

- Bashkia Mat nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik.

- Nuk administrohen procesverbalet e takimit të GSM, për të dokumentuar funksionimin e këtij grupi.

- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihen Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.

Nga Bashkia Mat përcaktohen objektiva sasior (vlerë monetare) vetëm në hartimin e PBA-ve dhe buxheteve vjetore. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se nga Bashkia Mat nuk ka plane operationale të punës, si dhe nuk është hartuar ende plani i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5 vjeçar) të Bashkisë Mat, sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr.68/2017 për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla, kryesisht në planin e buxhetit vjetor me planin e buxhetit të parashikuar në PBA.

Në lidhje me parimin 7: ÒNjësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.

Në Bashkinë Mat nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut, si dhe nuk ka një strukturë të miratuar dhe një koordinator të deleguar të riskut.

- Bashkia Mat administron në formatin Excel Regjistrin e Riskut, ku jepet informacion mbi përshkrimin e riskut, risku para kontrolli, kontrolli ekzistues, risku pas kontrolleve ekzistuese, nevoja për kontrolle shtesë, veprime për të adresuar riskun dhe struktura përkatëse për të ndërmarrë veprime. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi riskun dhe menaxhimin e tij konstatohet se, regjistri i riskut dhe planet për menaxhimin/minimizimin, nuk janë të miratuar me urdhër të NA, nuk jepet informacion mbi nivelin e riskut pas ndërmarrjes së veprimeve korrigjuese për çdo risk të identifikuar dhe vlerësuar, nuk administrohet raporti i NA për GMS dhe MFE sa i përket funksionimit të sistemit të menaxhimit të riskut sipas regjistrit të vënë në dispozicion. Nuk është përditësuar regjistri i riskut me periodicitet me pak se 2 vjet. Në regjistrin e riskut nuk identifikohet asnjë risk mbi nivelin e realizimit të të ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore, nuk identifikohet asnjë risk lidhur me disa Drejtori të Bashkisë Mat si ajo e Bujqësisë dhe Pyjeve, me rëndësi (niveli i arkëtimit të të ardhurave nga kontratat e qiradhënies së fondit pyjor/kullor), Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Sektori i urbanistikës dhe i menaxhimit të territorit, Inspektoriati i mbrojtjes së territorit etj.

- Sa më sipër konstatohet se, për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillen institucionet ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet të vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar ku citohet se: "Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut".

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht në programin Microsoft Office Excel. Hedhja, pasqyrimi i të dhënave personale dhe profesionale të çdo punonjësitë punësuar kryhen nëpërmjet programit Excel-it apo Word-it.

- Në Bashkinë Mat, po ashtu Drejtoria Ekonomike për mbajtjen e Kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave e cila kryhet nga sektori i financës, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Në bazë të këtij programi me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria e Ekonomike dhe hartimi i Pasqyrave Financiare, gjithashtu edhe Sektori i Tatim-Taksave operon me programin Excel për monitorimin e të ardhurave. Për çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me Degën e Thesarit Mat për të ardhurat dhe shpenzimet si dhe me Agjentët Tatimorë.

Në lidhje me parimin 8: ÒNjësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Në lidhje me parimin 9: ÒNjësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Bashkia Mat në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj nuk ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke mos marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke mos përcaktuar detyrat me personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara. Bashkia Mat nuk ka një sistem të kontrollit të brendshëm.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolliô.

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar pak a shumë edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj).

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe të Ardhurave (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe të Ardhurave, hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të pagesave, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA.

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të përlllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimeve/shërbimeve.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumenta autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj., të vulosura nga dega e Thesarit, e cila konfirmon me regjistrimin në SIFQ dhe kalimin e veprimit financiar, pasi ka bërë çeljen e fondeve sipas kërkesës së institucionit, duke konfirmuar fondet disponibël.

- Në Rregulloren e Brendshme për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publikô i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

përgjegjësit materiale. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.

- Në përgjithësi për procedurat e inventarizimit, vlerësimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të AAGJM, ka gjurmë auditimi, pasi ekziston dokumentacioni i firmosur nga komisionet dhe punonjësit përkatës si: Urdhri i NA për ngritjet e komisionit të inventarizimit, vlerësimin dhe nxjerrjes jashtë përdorimi si dhe për asgjësimin e tyre. Ekzistojnë fletët e inventarit, relacioni i vlerësimin për aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, procesverbale dhe relacionet për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve dhe procesverbalet për asgjësimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi. Janë prerë dokumentet bazë (fletë-daljet) dhe kryer veprimet kontabël përkatës.

- Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Mat, kurse një pjesë e taksave dhe tarifave arkëtohen nëpërmjet agjentëve tatimorë sipas marrëveshjes së Bashkisë Mat të bërë me këta agjentë si: me DRT Dibër për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin, me ASHK (ose ish-ZVRPP) për taksën e kalimit të pronësisë, me D.R.SH.T Rugor për taksën vjetore të mjeteve të përdorura, UKT. Për këto të ardhura në përgjithësi janë bërë akt-rakordimet përkatëse periodike dhe vjetore dhe janë kontabilizuar, *në veçanti janë trajtuar në akt-konstatimin nr.8, datë 25.02.2022.*

- Bashkia Mat në bashkëpunim me Degën e Thesarit Mat, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për cdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

Në lidhje me parimin 11: ÒNjësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë.

- Bashkia Mat nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

Në rregulloren e brendshme nuk përcaktohen detyrat e specialistit të IT, i cili varet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe ka vetëm detyra për administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit kompjuterik dhe instalimin e programeve bazë e profesional në kompjuterat e bashkisë.

Në Bashkinë Mat nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Sipas Strukturës Organike të miratuar Sektori i Administrimit të zyrave me një ndalesë, sistemeve dhe IT, pjesë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT, pasi secili nga këta specialistë mund të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, testimin, menaxhimin e Serverit qendror, sigurimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve TIK etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk është përfshirë si drejtim auditimi nga sektori i auditimit të brendshëm.

Në lidhje me parimin 12: ÒNjësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

- Në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë të Drejtorëve dhe Përgjegjësve të sektorëve, ku vihen re mbivendosje/mbingarkesë të funksioneve. Konkretisht në Drejtorinë e Shërbimeve Bashkiake, ku funksioni i monitorimit të projekteve është për drejtuesin e drejtorisë, por edhe për përgjegjësin e sektorit, ose specialisti i sektorit të emergjencave civile dhe pronave, ka si detyrë: *“Të drejtojë organizimin dhe bashkërendimin e punëve për hartimin e planeve të përgatitjes për emergjencë civile në bashkinë përkatëse dhe për zbatimin e masave të mbrojtjes”*, ndërkohë që specialisti është niveli më i ulët në hierarkinë e kësaj drejtorie dhe nuk mund të ketë kompetenca drejtuese/organizuese.
- Me vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve merret Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi dhe rregullores së brendshme.
- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë Ekonomike.
- Nuk ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.08.2018 óPër hartimin e PFô). Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV. Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: óNjësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësoró.

BashkiaMatdispononfaqenesajzyrtarenë web www.bashkiamat.gov.al kupasqyrohetaktivitetiisaj si Rregullorja e Brendshme, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, buxheti vjetor, plani i prokurimeve, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve. Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

Përdoret sistemi e-Albania për deklarime online për të marrë dokumente të ndryshme informimi. Nëpërmjet sistemit on-line të informimit, Bashkia Mat nuk ka krijuar të gjitha mundësitë për pjesëmarrjen e publikut dhe të gjitha palëve të interesuara në procesin e prioriteteve buxhetore, nuk ka shpallur publikisht kalendarin e dëgjësive publike për çdo drejtori, sipas programeve respektive për vitin 2019 dhe 2021 si:

1. Dëgjesa publike për programin óPaketa Fiskaleó
2. Dëgjesa publike për programin óInvestime në infrastrukturë rugore dhe transport publikó
3. Dëgjesa publike për programin óStrehimi dhe Shërbimi Socialó
4. Dëgjesa publike për programin óArsimi parashkollor dhe parauniversitaró dhe óShërbimet publike, investimet në Arsimitó



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Për vitin 2019 dhe 2021 nga Bashkia Mat (për vendimmarrje për dhënien e pasurive të paluajtshme me qira, buxhetin) nuk janë kryer konsultime me publikun dhe palët e interesit. Drejtuesit në Bashkinë Mat nuk kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacional, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm sistemin elektronik dhe shkresor.

Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në nenet 164 óMarrëdhëniet me publikunô.

Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Në Bashkinë Mat punonjësit punojnë me këto sisteme informatike Word dhe Excel. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë elektronike/verbale.

Grupi auditues konstaton se, nuk e kanë të gjithë punonjësit mundësinë e përdorimit të email-it zyrtar të institucionit duke qenë se sistemi ofron një numër të kufizuar adresash email-i. Komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet me komunikim verbal e shkresor, gjithashtu kryhet edhe nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale.

V. Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”

Në lidhje me parimin 16: óNjësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshmeô.

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion nuk konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, nuk administrohen raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen e objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili duhet të hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen e objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

- Bashkia Mat lidhur me pyetësin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm e administron në formatin Excel dhe jo dokument shkresor të miratuar nga NA. Në dokumentacionin e vendosur në dispozicion, nuk administrohet shkresa përcjellëse e pyetësorit të vetëvlerësimit dhe deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, pranë Ministrisë së Financave, çka në gjykimin e grupit të auditimit krijohet bindja e arsyeshme se këto detyra nuk janë kryer. Këto mosveprime bien në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 óPër menaxhimin financiar dhe kontrollinô, i ndryshuar.

- Në Bashkinë Mat mungojnë rregullat të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

- Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime nga KLSH.

- Në Bashkinë Mat aktivitetet e vlerësimit të njësisë nuk janë në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mos realizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

Në lidhje me parimin 17: ÒNjësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë.

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

- Titullari i këtij institucioni për rekomandimet e lëna nga KLSH, nuk është angazhuar për ndërmarrjen e masave korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe nuk ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Titulli i gjetjes: KLSH ka konstatuar se, në Bashkinë Mat funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit ka shfaqur mangësi, duke sjellë fenomenin që sistemet e kontrollit nuk kanë funksionuar plotësisht. Për ta përmirësuar atë në të ardhmen kërkohet një vëmendje e shtuar për implementimin dhe respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin* ò i ndryshuar.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga pyetësi i vetëvlerësimit dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

“Mjedisi i Kontrollit”

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga verifikimi rezulton se GSM nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GSM për hartimin e planit strategjik dhe PBA. Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtremeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme.

“Menaxhimi i Riskut”

Mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Në Bashkinë Mat, Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave, Sektori i Financës dhe Sektori i Tatim Taksave nuk përdorin program për mbajtjen e kontabilitetit por operojnë me programin Excel ku niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Mat nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (*back-up*) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi një punonjës kontrollon të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin e testimit etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk ka qenë fushë drejtimi auditimi nga AB.

“Informimi dhe Komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë së saj.

- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Nga Bashkia Mat kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, por nuk janë të plota dhe mungon dokumenti i konsultimeve publike.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Audit i Brendshëm nuk ka dhënë vlerësime të plota për sistemin e kontrollit të brendshëm.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 *óPër menaxhimin financiar dhe kontrollin* i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 *óPër menaxhimin financiar dhe kontrollin* i ndryshuar. Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë Mat.

Ndikimi/Efekti: Mosnjohje e plotë dhe sa duhet i koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *óPër menaxhimin financiar dhe kontrollin* nga niveli i lartë drejtues i kriterëve të MFK, duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Shkaku: Mungesa e trajnimeve të dedikuara për gjithë stafin në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat me atributet e Kryetarit të GMS në bashkëpunim me Koordinatorin e Riskut të institucionit, të marrë masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësive si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësive.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 53/12 prot, datë 26.0.2022 Mbi Projektraportin e Auditimit, nga Z.D. Rr për sa më poshtë:

Pretendimi i Subjektit:

1. Në lidhje me parimin 5, Bashkia Mat administron procesverbalet e takimit të Grupit të Menaxhimit Strategjik GMS, është e vërtetë që Bashkia Mat nuk ka miratuar një plan pune vjetor lidhur me funksionimin e grupit të GMS, por ka funksionuar mbi bazën e kalendarit të miratuar në Këshillin Bashkiak.

2. Në lidhje me parimin 13, Ky argument nuk qëndron sepse nga ana e Drejtorise Ekonomike dhe të Ardhurave janë kryer dëgjuesat publike për hartimin e buxhetit 2020, 2021, për paketën fiskale të vitit 2020, 2021 dhe për PBA.

Kjo e dokumentuar edhe me foto të takimeve që janë kryer në të 8 (tetë) njësitet administrative të Bashkisë Mat si dhe me listëprezencën e qytetarëve pjesëmarrës që kanë qenë pjesë e dëgjësave publike. Njoftuar nga faqja zyrtare e Bashkisë Mat dhe nga Media Lokale, ftesë për dëgjuesat publike Buxhet, Paketën fiskale dhe PBA.

3. Në lidhje me parimin 16, Ky argument nuk qëndron sepse Pyetësin e vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm e administrojmë jo vetëm në formë Exceli, të dërguar në ministri por edhe me dokumentacion shkresor të miratuar nga NA.

Shkresa përcjellëse dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për raportimin dhe funksionimin e sistemit të Kontrollit të Brendshëm. Nr 920 Prot., Date 28.02.2020.

Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2019.

Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të Brendshëm në Bashkinë Mat për Vitin 2019.

Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2020 Nr. 991 Prot., datë 26.02.2021;

Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të Brendshëm në Bashkinë Mat për Vitin 2020. Nr. 991/1 Prot., datë 26.02.2021.

4. Në lidhje me parimin 7, Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht në programin Microsoft Office Excel. Hedhja, pasqyrimi i të dhënave personale dhe profesionale të çdo punonjësi të punësuar kryhen nëpërmjet programit Excel- it apo Word- it.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Në Bashkinë Mat, po ashtu Drejtoria Ekonomike për mbajtjen e Kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave e cila kryhet nga sektori i financës, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Në bazë të këtij programi me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria e Ekonomike dhe hartimi i Pasqyrave Financiare, gjithashtu edhe Sektori i Tatim-Taksave operon me programin Excel për monitorimin e të ardhurave. Për çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me Degën e Thesarit Mat për të ardhurat dhe shpenzimet si dhe me Agjentët Tatimorë.

5. Në lidhje me pikat 1.1-1.8, Të dërguar nga ana juaj në observacion në mënyrë elektronike në lidhje me trajnimet e stafit, ku në mënyrë të përmbledhur ju jeni shprehur se rregullorja e brendshme është një akt me karakter rregullator administrativ të brendshëm, si dhe nuk nevojitet kryerja e trajnimeve.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

1. Në lidhje me parimin 5, Pretendimi juaj nuk qëndron pasi ju nuk keni dërguar procesverbalet e takimeve të GMS, Bashkia Mat nuk ka të miratuar një plan pune vjetore lidhur me funksionimin e grupit të GMS.

2. Në lidhje me parimin 13, Pretendimi juaj nuk qëndron pasi nuk keni paraqitur asnjë dokument justifikues dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Mat nuk janë të plota takimet për dëgjuesat me publikun;

Dëgjesa publike për programin "Paketa Fiskale";

Dëgjesa publike për programin "Investime në infrastrukturë rrugore dhe transport publik";

Dëgjesa publike për programin "Strehimi dhe Shërbimi Social";

Dëgjesa publike për programin "Arsimi parashkollor dhe parauniversitar" dhe "Shërbimet publike, investimet në Arsim".

3. Në lidhje me parimin 16. Nga dokumentacioni i dërguar në observacion nga ana juaj, ky argument qëndron për pyetësoin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, të cilin e administroni jo vetëm në formë Exceli, por edhe me dokumentacion shkresor të miratuar nga NA.

Shkresa përcjellëse e dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për raportimin dhe funksionimin e sistemit të Kontrollit të Brendshëm Nr. 920 Prot., datë 28.02.2020,

Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2019,

Deklarata për cilësinë e sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Bashkinë Mat për Vitin 2019,

Raporti për funksionimin e sistemit të Kontrollit të Brendshëm për vitin 2020 Nr. 991 Prot., datë 26.02.2021,

Deklarata për cilësinë e sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Bashkinë Mat për Vitin 2020 me Nr. 991/1 Prot., datë 26.02.2021.

4. Në lidhje me trajnimet e stafit, si fillim sqarojmë se e kemi të qartë se çfarë përfaqëson rregullorja e brendshme, më sakt ajo është një përmbledhje e ligjeve, mbi të cilat mbështetet Bashkia Mat në kryerjen e aktiviteteve të saj. Si e tillë, si dhe mbështetur në manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Kap., 3 óPolitikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore, Kap., 3.5 óRolet në procesin e monitorimit në óStafi, gjykojmë se rregullorja e brendshme një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, sa herë që hartohet si e re/pëson ndryshime duhet të shoqërohet me trajnim të stafit përkatës/të gjithë stafit të institucionit, me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

qëllim që të kuptojnë pozicionin e tyre në strukturën e institucionit, detyrat që kanë, me kë duhet të bashkëpunojnë, si dhe për çdo paqartësi që mund të krijohet gjatë zbatimit të saj.

III.2.1.1. Mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimitarisë së njësisë së auditit të brendshëm.

Në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik, është krijuar njësia e Auditit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditit të Brendshëm duke përbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100, i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm. Kapaciteti auditues i strukturës së Njësisë së Auditit të Brendshëm të Bashkisë Mat, është bazuar në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik, i ndryshuar.

Njësia e Auditit të Brendshëm nga periudha e krijimit ka funksionuar sipas strukturës organizative të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mat me Urdhër nr. 70 prot., datë 22.02.2016, i përbërë nga dy Specialist dhe një Përgjegjës Sektori, ku aktualisht përgjegjës i NJAB në Bashkinë Mat është emëruar Z. G. H, me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë me nr. 1340 prot., datë 23.03.2021 i cili është i pajisur me certifikatën e Audituesit.

Struktura e njësisë AB, në formë tabelore për periudhën e audituar për vitet 2019, 2020 dhe 2021, paraqitet si me poshtë:

NR	EMËR BIEMËR	Pozicioni	Arsimi Bazë	Eksperi en e Punës Vitet et e Punës në AB	TË DHËNAPËRAUDITUESITË BRENDSHËM				
					Zhvillimi Profesional				
					Certifikimi		Trajnimi në fushën e AB		
					I pacertif ikuar	Në proc escertif ikimi	I certifikua r në vitin	Nga Inst. Kombëtare ose Ndërkombëtare	Publikim e në fushën e AB
Përvitin 2019									
1	L. Xh	P/Sektor	Ekonomist	2	-	-	-	Nga Aspa/ DRAB	po
2	G. H	Auditues	Ekonomist	Mbi 7	-	-	2015	Nga Aspa/ DRAB	po
3	F. Th	Auditues	Ekonomiste	Mbi 6	-	-	-	Nga Aspa/DRAB	jo
Përvitin 2020									
1	L. XH	P/Sektor	Ekonomist	3	-	-	-	Nga Aspa/ DRAB	po
2	G. H	Auditues	Ekonomist	Mbi 8	-	-	2015	Nga Aspa/ DRAB	po
3	F. Th	Auditues	Ekonomiste	Mbi 7	-	-	-	-	jo
Përvitin 2021									
1	L.XH	P/Sektor (mars Pension)	Ekonomist	4	-	-	-	Nga Aspa/ DRAB	po
2	G. H	P/Sektor (mars vazhdim)	Ekonomist	Mbi 9	-	-	2015	Nga Aspa/ DRAB	po
3	F. TH	Auditues	Ekonomist	Mbi 8	-	-	-	Nga Aspa/ DRAB	jo
4	D. H	Auditues	Financ Kont	1	-	po	-	Nga Aspa/ DRAB	po

Burimi: NJAB Bashkia Mat

Nga auditimi i procedurave të emërimit të audituesve të NJAB është konstatuar se:

1. Znj. F. Th me arsim të lartë, diplomuar në Universitetin e Tiranës në vitin 1984, në degën Financë, është emëruar në detyrën e audituesit të NJAB në Bashkinë Mat me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 407 datë 06.07.2016, duke qenë e pa pajisur me certifikatën e audituesit, dhe brenda periudhës 2 vjeçare nuk është pajisur me certifikatë auditimi, veprim ky që bie në kundërshtim me nenin nr. 11, pika 2, germa ó ç ô, e Ligjit nr. 114/2015, për Auditin e Brendshëm Publik.

2. Z. D. H, me arsim të lartë, diplomuar në Universitetin e Shkodrës Luigj Gurakuqi në vitin 2018 në degën Financë në Kontabilitet, dhe në vitin 2021 është diplomuar Master Profesional në degën Financë në Bankë, i cili është emëruar në detyrën e audituesit të NJAB në Bashkinë Mat



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë, nr. 154, datë 26.03.2021 i cili është i pajisur me çertifikatën e audituesit, nuk kapërvojëpunë 3 vjet në profesion, veprim ky që bie në kundërshtim me nenin nr. 11, pika 2, gërma ó ç ô, e Ligjit Nr. 114/2015, óPër Auditin e Brendshëm Publikó

Nga auditimi rezultoi se:

1) Karta e Auditimit të NJAB nuk është përgatitur dhe miratuar nga Titullari i Bashkisë Mat , në kundërshtim me nenin nr. 4 , pika 12, të ligjit nr. 114/2015, si dhe në kundërshtim me pikën 2.5, Kapitulli II të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

2) Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 óPër auditimin e brendshëm në sektorin publikó neni 13 óKomitetit të Auditimit të Brendshëmó, *i cili përcakton se“Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm.*

3) Plani strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2019-2021, por ai nuk është përpiluar në përputhje me standartin e përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.1.6.

4) Planifikimet vjetore të auditimeve për vitin 2019 - 2021 edhe pse janë përgatitur rregullisht, ata nuk janë përpiluar në përputhje me standartin e përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.2.

5) Struktura e projektraporteve dhe e raporteve përfundimtare të auditimit për vitet 2019-2021 është hartuar e plotësuar sipas standardit të vendosur nga MAB në Kapitullin IV, pika 4.1.12, Hapi 11.

6) Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësive vendore, pormbahennëambientetebrendshmetëSektorittëAuditittëBrendshëmnë kundërshtim me ligjin 9154, datë 06.11.2003 óPër arkivató.

7) Dosjet e përhershme për çdo njësi publike të audituar nuk janë çelur as elektronikisht dhe as manualisht për ti shërbyer auditimit pasardhës, veprim që bie në kundërshtim me MAB, Kapitulli nr. VI, pika 6.3.

Hartimi dhe zbatimi i planeve të Auditit të Brendshëm, përgatitja dhe hartimi i programeve dhe llojet e auditimeve të ushtruara.

Nga Sektori i Auditit të Brendshëm janë hartuar dhe miratuar për çdo vit në zbatim të ligjit nr. 114/2015 óPër Auditimin e brendshëm ne sektorin Publikó, Planet strategjike dhe vjetore sipas formateve të dërguar në Njësinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (Ministria e Financave) dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë.

Nga auditimi rezultoi se:

Për vitin 2019 Sektori i AB ka planifikuar 11 (njëmbëdhjetë) auditime dhe janë realizuar 11 (njëmbëdhjetë) auditime të plota nga të cilat 2 (dy) Përputhshmërie, 1 (një) Financiar, 5 (pesë) Kombinuara, 3 (tre) Performance sipas strukturës së auditimeve me shkresë nr. 13/1 datë 22.01.2020. Auditime të planifikuara për vitin 2019 janë si më poshtë :

1.Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Ujitjes dhe kullimit.

2.Drejtoria e Qendrës Kulturore

3.Pallati i Kulturës + Bibloteka e Qytetit

4.Auditimi i Kopshteve 1+2+3 (3 raporte auditimi)

5.Auditimi i çerdheve

6.Auditimi i Konviktit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

7.Ndërmarrja e shërbimeve Bashkiake

8.Auditimi i Muzeut Historik

9.Klub 6Futbolli Burreliô shpk

Për vitin 2020 Sektori i AB ka planifikuar 9 (nëntë) auditime dhe janë realizuar 9 (nëntë) auditime të plota nga të cilat 3 (tre) auditime Përputhshmërie, 1 (një) Financiar, 3 (tre) Kombinuara, 2 (dy) Performancë sipas strukturës së auditimeve me shkresë nr. 707 datë 12.02.2021. Auditime në përputhje me planin konfirmuar dhe dërguar pranë Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në Ministrinë e Financave, raporti i veprimtarisë së sektorit të AB. Auditime të planifikuara për vitin 2020 janë si më poshtë :

1.Njësia Administrative Burrel

2.Njësia Administrative Koms

3.Njësia Administrative Ulez

4.Njësia Administrative Baz

5.Njësia Administrative Macukull

6.Njësia Administrative Derjan

7.Njësia Administrative Rukaj

8.Njësia Administrative Lis

9.Ujsjellësi Mat sh.a

Për vitin 2021 Sektori i AB ka planifikuar 5 (pesë) auditime dhe janë realizuar 4 (katër), nga të cilat 2 (dy) auditime Përputhshmërie, 1 (një) Financiar, 1 (një) Performance, duke mbetur për tu realizuar dhe 1 (një) auditim në përputhje me planin konfirmuar me shkresën nr. 4147/1 datë 15.10.2020 dërguar pranë Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në Ministrinë e Financave, raporti i veprimtarisë së sektorit të AB për vitin 2021. Auditime të planifikuara për vitin 2021 janë si më poshtë :

1.Drejtoria e Burimeve Njerëzore

2.Sektorin Juridik dhe e Prokurimeve Publike.

3.Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave, Sektorin e Financës dhe Buxhetit.

4.Sektorin e Tatim Taksave Vendore dhe Taksat e Pasurisë

5.Të ndryshme DLDP në

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

Tabela nr. 2

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT		Nga te realizuarat, sipas llojit				
		Auditim e ta planifikuara	Auditime te realizuara	Perputh	Financ	Kombi	Performace	Tjera
2	Viti 2019	11	11	2	1	5	3	0
3	Viti 2020	9	9	3	1	3	2	0
4	Viti 2021	5	4	2	1	-	1	0

Burimi: NJAB Mat

Nga auditimi i raportimit 2019-2021, konstatojmë se janë dhënë 187 rekomandime gjithsej, Rekomandimet janë pranuar të gjitha, prej të cilave 37 rekomandime janë zbatuar, dhe 150 janë në proces zbatimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Në mënyrë të përmblëdhur paraqiten në tabelë si vijon:

Tabela nr. 3									
Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dëmi)			
		Gjithsej numër	ne	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej numër	ne	Zbatuar
1	Viti 2019	84	-	84	-	-	2	2	-
2	Viti 2020	52	37	15	0	3	0	3	0
3	Viti 2021	51	-	51	-	-	-	-	-
TOTALI		187	37	150	0	5	2	3	0

Burimi: NJAB Mat

Në rekomandimet e dhëna nga Auditimi i Brendshëm, konstatohet se janë dhënë vetëm rekomandime përmasa organizative, nuk është rekomanduar asnjë masë disiplinore ndaj personave përgjegjës për rastet e konstatimeve të problematikave të raportuara në raportet e auditimit në subjektet e audituara, si dhe rekomandimet që janë dhënë me shpërblim dëmi nuk është marrë asnjë masë organizative për zbatimin e tyre që bie në kundërshtim me nenin 16, gjërma 6 e Ligjit Nr. 114/2015, që të japin rekomandime për njësinë e audituar për përmirësimin e veprimtarisë, efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe për masat që duhen ndërmarrë në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare për zhdëmtimin e tyre dhe për të ulur mundësinë e përsëritjes, duke bërë që NJAB të mos realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në auditimet kryera për periudhën e vitit 2019-

2021, konstatohet se Sektori i Auditimit të Brendshëm (AB), nuk ka planifikuar kryerjen e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme. Kjo ka sjellë që titullari i njësisë të mos informohet mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet kryera, në kundërshtim me nenin 6 gjërma 6 e Ligjit Nr. 114/2015, që për Auditin e Brendshëm Publik.

Vlerësimi i procedurave dhe standarteve të kryerjes së auditimit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura u konstatua se përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 114/2015 që për auditimin e brendshëm në sektorin publik, që Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB), administrohen dokumente që vërtetojnë se në çdo auditim është zbatuar programi i sigurimit të cilësisë së AB, në përputhje me Kap. VII, pika 7.1, dhe 7.1.1, të MAB.

Nga auditimi i projektraportit dhe raportit përfundimtar, rezulton se në procesin e auditimit në përgjithësi, NJAB nuk ka kryer auditim në zonat me risk të lartë, si: Prokurimet me vlerë të vogël vlerë të lartë, Lejet zhvillimore të lëshuara nga Sektori i PLZHT (taksën e ndikimit në infrastrukturë), Shpenzimet operative për të gjitha llojet e blerjeve, Administrim-Menaxhimi të thelluara, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Zbatimi i kontratave të punimeve dhe shërbimeve, menaxhimi i borxhit tatimor dhe rritja nga njëra periudhë në tjetrën, nuk është hartuar regjistri i riskut, etj; në kundërshtim me MAB pika 3.1.2:

Titulli i Gjetjes: Mbi krijimin dhe funksionimin e Njësive të Auditimit të Brendshëm Publik.

Situata: 1. Nga audituesit e brendshëm, nuk është hartuar planifikimi i angazhimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

2. Disa nga subjektet e audituara pavarësisht se kanë pranuar rekomandimet e lëna, nuk kanë paraqitur Plan Veprimin për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

3. Drejtuesi i Njesisë së Auditit të Brendshëm, nuk ka kryer sigurimin e cilësisë së punës.

4. NJAB, pavarësisht planifikimit për auditim të drejtorive me risk të lartë siç është Drejtoria e Financës apo Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Prokurimetmevlerëtëvogële vlerë të lartë, etj., angazhimi nuk është kryer. Gjithashtu, NJAB nuk ka planifikuar në asnjë rast në Planin Strategjik për vitet në vijim auditimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe auditimin e Njësive Administrative të Bashkisë Mat.

Për veprimet e mësipërme, mban përgjegjësi z. G. H.

Kriteri: Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 *óPër Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikó*; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 *óPër miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikó*; Urdhri i Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016 *óPër Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikó*, Kapitulli IV, pika 4.1.1 *óPlanifikimi i një angazhimi auditimió*, Kapitulli IV, pika 4.1.12 Hapi 11, Kapitulli VII, pika 7.1.1 *óVlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet vetë nga NJABó*.

Ndikimi/Efekti: Nuk jep siguri të arsyeshme për objektivat e përcaktuara nga Institucioni. Nuk pasqyron aktivitetin e drejtorive me risk të lartë si Financa, Taksat apo Prokurimet.

Shkak: Nga neglizhenca, dhe mos përmbushja e angazhimeve për auditim sipas planifikimit të bërë.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandim: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Mat, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Mat, të marrë masa të menjëhershme për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat të marrë masa që punonjësit pa çertifikatë të NJAB, të pajisjen me certifikata të auditit të brendshëm, si dhe kryerjen e trajnimeve të vazhdueshme.

Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Mat, të marrë masa që të sigurojë paraqitjen në mënyrë periodike para nivelit drejtues të institucionit dhe Këshillit Bashkiak të raporteve të përmbledhura për rezultatet e veprimtarisë së auditimit, në mënyrë që të realizojë misionin e saj, ku veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari e pavarur, që mbështet menaxhimin e njësisë vendore për arritjen objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime, që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

III.2.2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjet vjetore “Për buxhetin e shtetit” të vitit 2019, 2020 dhe 2021, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.

Në bazë të programit të auditimit nr. 53/1, datë 18.01.2022, me objekt: *óAuditim financiar në Bashkinë Mató*, pika 2. *óMbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 óPër menaxhimin e sistemit buxhetor në*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

*RSH*o, ligjet vjetore *óPër buxhetin e shtetit*o, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit, u audituan çështjet e mëposhtme.

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për periudhën 2019-2021;

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;

-Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID-19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi;

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.);

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

2.2.6. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

➤ **Dokumentacioni i audituar si më poshtë:**

1. Dokumentacioni i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministrinë e Linjës;
2. Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;
3. Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat;
4. Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative;
5. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve, si fatura të palikuiduara dhe vendime gjyqësore;
6. Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe saktësia e pasqyrimin të ndryshimeve në shtesa dhe pakësim me planin përfundimtar.
7. Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;
8. Dokumente të tjera mbështetëse (baza të ndryshme të dhënash në programin *óExcel*o, si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet, të ardhurat etj.).

Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, u konstatua se:

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitet 2019-2021.

Për periudhën 2019-2021 PBA dhe buxhetet vjetore, që i korrespondojnë kësaj periudhe, janë miratuar me VKB nr.03, datë 04.01.2019 (buxheti vjetor 2019, PBA 2019-2021 *nuk administrohet në dosje*), VKB nr.61 datë 24.12.2019 (PBA 2020-2022) dhe VKB nr.57, datë 24.12.2019 (buxheti vjetor), VKB nr.139, datë 22.12.2020 (PBA 2021-2023) dhe VKB nr.138,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

datë 22.12.2020 (buxheti vjetor), si dhe VKB përkatëse për miratimin e fondeve të trashëguara për çdo fillim viti buxhetor. Gjithashtu janë konfirmuar me shkresat e Prefektit të Qarkut Dibër, respektivisht shkresat nr.12/1 prot., datë 04.01.2019, nr.1845/1 prot., datë 07.01.2020 dhe nr.1882/1 prot., datë 29.12.2020. Në vija të përgjithshme gjatë hartimit dhe miratimit të kërkesave buxhetore, janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve të reja, përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, rehabilitimin dhe investimin e infrastrukturën bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, përmirësimin e sistemit të edukimit dhe trajnimit profesional, mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Mat.

Fusha me prioritet në shpenzimet për investime janë konsideruar:

- a. *Infrastruktura rrugore;*
- b. *Urbanistika;*
- c. *Furnizimi me ujë të pijshëm;*
- d. *Ujitja dhe Kullimi;*
- e. *Shërbimi zjarrfikës;*
- f. *Konviktet.*

PBA janë hartuar pjesërisht bazuar në Udhëzimin e MFE nr.23 datë 30.07.2018 *óPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësive të Qeverisjes Vendoreó*. Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (*kontratat në vazhdim*), angazhimet (*detyrimet e prapambetura sipas llojit*), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (*kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme*).

Programi i të ardhurave për vitet 2019-2021 është bërë mbi bazën e paketave fiskale të miratuara me VKB nr.1, datë 04.01.2019, VKB nr.54, datë 24.12.2019 dhe VKB nr.137, datë 22.12.2020.

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuara nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit.

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për periudhën 2019-2021, vijnë nga dy burime:

Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera, donacione dhe të ardhura që trashëgohen.

Nga burimet qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuara, transfertat specifike për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuara.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitet 2019-2021, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet planifikimi sipas PBA-ve dhe buxheti vjetor.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Tabela nr.1 PBA për periudhën 2019-2021 sipas programeve ekonomike që menaxhon Bashkia Mat

Nr	Kodi	Emërtimi	PBA 2019	Buxheti Vjetor (i Fundit) 2019	Diferenca (2-1)	PBA 2020	Buxheti Vjetor 2020	Diferenca (2-1)	PBA 2021	Buxheti Vjetor 2021	Diferenca (2-1)
			1	2		1	2		1	2	
1	1110	Aparati	121,201	145,731	24,530	148,402	122,011	-26,391	124,873	159,706	34,833
2	4240	Ujitja e kullimi	10,950	22,137	11,187	10,250	15,958	5,708	10,000	14,891	4,891
3	4220	Bujqesia	13,000	10,805	-2,195	9,700	174,595	164,895	8,499	30,357	21,858
4	4260	Sherbimi pyjor	6,750	7,774	1,024	7,772	9,286	1,514	8,550	9,250	700
5	4520	Sektori rrugëve	40,832	63,170	22,338	41,132	63,985	22,853	32,830	51,401	18,571
6	5100	Menaxhimi mbetjeve	24,267	26,625	2,358	24,328	28,626	4,298	23,100	39,770	16,670
7	6260	Sherbimet vendore	1,500	1,837	337	1,500	2,470	970	1,500	1,653	153
8	06260 Nd vartesi	Nderrmarrja e Sherbimeve Bashkiake	22,500	28,141	5,641	24,000	29,775	5,775	28,000	39,934	11,934
9	3140	Policia Bashkiake	8,500	6,942	-1,558	9,000	9,088	88	10,500	9,630	-870
10	6440	Ndricimi rrugor	4,700	4,000	-700	4,500	4,500	0	4,500	4,500	0
11	6330	Ujesjellesi	7,900	16,395	8,495	7,900	7,051	-849	1,000	5,728	4,728
12	10430	Cerdhet	10,899	12,103	1,204	10,270	11,583	1,313	12,280	12,725	445
13	8130	Sporti	12,900	18,788	5,888	12,000	15,050	3,050	16,500	17,279	779
14	8220	Kultura	9,795	8,888	-907	9,800	8,226	-1,574	9,000	10,080	1,080
15	4980	Fondi rezerve dhe Kontigjenca	4,000	0	-4,000	3,500	360	-3,140	5,000	145	-4,855
16	10910	Emergjencia civile	5,000	4,795	-205	5,000	11,620	6,620	12,000	7,904	-4,096
17	9120	Arsimi 9 vjecar	76,350	88,082	11,732	78,267	91,917	13,650	78,480	140,058	61,578
18	9230	Arsimi mesem	20,319	37,611	17,292	19,903	35,114	15,211	24,510	27,489	2,979
19	6140	Urbanistika	0	0	0	0	300	300	4,000	4,000	0
20	3280	Sherbimi zjarrfikës	15,370	16,426	1,056	14,710	17,756	3,046	18,415	24,252	5,837
21	10460	Sherbimet sociale		1,909	1,909	0	3,571	3,571	300	3,182	2,882
22	4130	QKB	1,600	1,601	1	1,600	1,607	7	1,600	1,622	22
23	10430	Ndihma Ekonomike dhe PAK	274,587	277,363	2,776	274,587	343,318	68,731	316,114	399,923	83,809
24	1170	Gjendja Civile	5,800	5,757	-43	5,800	7,073	1,273	5,600	6,495	895
25	1620	Shpenzime per KZAZ	0	1,553	1,553	0	22,953	22,953	0	2,097	2,097
26	10910	Shpenzime per Termetin	0	2,939	2,939	0	9,966	9,966	0	0	0
27	06190	Banesat sociale							0	4,575	4,575
28	10661	Banesat sociale							0	1,523	1,523
29	06370	Ujesjellesa Fonde nga Ministria							0	712,168	712,168
		TOTAL	698,720	811,372	112,652	723,921	1,047,848	323,927	757,151	1,742,337	985,186

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, mbi planifikimin buxhetor afatmesëm 2019-2021, pjesë e të cilit është edhe planifikimi për vitin buxhetor, si dhe krahasimi i tij me planin progresiv të vitit buxhetor, rezulton se, ka diferenca në programe të ndryshme buxhetore, ku veç atyre programeve për të cilat Bashkia Mat nuk mund të bëjë planifikim të saktë fondeve që do të shpenzohen (investime të reja gjatë vitit buxhetor me fonde të Ministrisë së linjës), ka programe si, aparati, menaxhimi i mbetjeve, ndërmarrja e shërbimeve bashkiake, shërbimi zjarrfikës, për të cilat Bashkia Mat gjatë vitit buxhetor nuk ka pritshmëri për alokim të fondeve shtesë. Këto diferenca në gjykimin e grupit të auditimit tregojnë pasaktësi në planifikimin e fondeve buxhetore në PBA krahasuar me planin e buxhetit vjetor.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Pjesë e PBA dhe planifikimit të buxhetit vjetor, është edhe planifikimi i të ardhurave, si burim i integruar në programet buxhetore, të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Kështu për periudhën 2019-2021 Bashkia Mat ka planifikuar të arkëtojë të ardhura tatimore dhe jo tatimore, pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr.2 Planifikimi i të ardhurave

Përshkrimi	Plan 2019	Plan 2020	Plan 2021
Te ardhura tatimore	32,831,000	44,269,447	40,898,000
Te ardhura jotatimore	45,746,000	58,058,000	80,422,000
TOTAL	78,577,000	102,327,447	121,320,000

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Titulli i gjetjes: Zbatimi i Procedurave në përgatitjen e PBA 2019-2021, 2020-2022 dhe 2021-2023.

Situata: Nga auditimi i procedurave në përgatitjen e PBA 2019-2021, PBA 2020-2022 dhe PBA 2021-2023, në veçanti u konstatua se:

-Për PBA 2019-2021 dhe PBA 2021-2023 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Mat;

Tabela nr.3 Konsultimet me komunitetin dhe grupet e interesit

Nr.	PBA 2019-2021	PBA 2020-2022	PBA 2021-2023	Buxheti 2019	Buxheti 2020	Buxheti 2021
1					Nj.Adm Burrel dt.27.10.2020	
2					Nj.Adm Komsa dt.20.10.2020	
3					Nj.Adm Ulez dt.20.10.2020	
4					Nj.Adm Lis dt.22.10.2020	
5					Nj.Adm Macukull dt.26.10.2020	
6					Nj.Adm Derjan dt.26.10.2020	
7					Nj.Adm Rukaj dt.22.10.2020	

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Për PBA 2019-2021 dhe Buxhetin vjetor 2019 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 33 të Ligjit nr. 68/2017 *“Për financat e Vetëqeverisjes Vendore, si vijon: “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në këshillin e njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor”.*

-Nuk administrohet dokumenti përfundimtar i PBA për periudhën 2019-2021, por në dosje administrohet vetëm VKB nr.34, datë 18.05.2018 për miratimin e tavanëve përgatitore për PBA 2019-2021, i cili nuk ka dalë në përputhje me përcaktimin e bërë në pikën 6 të nenit 34 në Ligjin nr.68/2017 *“Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”.*

-Për PBA 2019-2021 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 37 të Ligjit nr. 68/2017 *“Për financat e Vetëqeverisjes Vendore, si vijon:*

“Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga Buxheti i Shtetit, të përcaktuara në udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit vendor të Ministrisë së Financave, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

-Për PBA 2019-2021, 2020-2022 dhe 2021-2023 nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;

-Buxheti vjetor i vitit 2019, nuk është miratuar brenda datës 25.12.2018, por është miratuar më datë 04.01.2019 me VKB nr.3, pra jashtë afatit;

-Për PBA 2019-2021 nga Kryetari i Bashkisë nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik, strukturë e cila është përgjegjëse për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të integruar të planifikimit brenda njësisë së vetëqeverisjes vendore;

-Për PBA 2019-2021 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e përcaktuara në shkronjat óa-hô të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 óPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendoreó, për drejtuesit e ekipit të menaxhimit të programeve buxhetore të Bashkisë Mat, lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxheteve vjetore, nuk administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Mat, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;

-Në PBA, si dhe buxhetet vjetore të vitit 2019 dhe 2021, nuk janë planifikuar fonde për investime në fondin pyjor;

Kriteri: Shkronja óçô e nenit 5, pika 1 e nenit 33, pika 6 e nenit 34, pika 1 e nenit 35, pika 1 e nenit 37, pika 2 e nenit 39 dhe pika 3 e nenit 41, në Ligjin nr. 68/2017 óPër financat e Vetëqeverisjes Vendoreó;

Pika 5 e nenit 23 në Ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 óPër pyjet dhe shërbimin pyjoró, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 óPër pyjetó, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020;

Pika 29, shkronjat óa-hô të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 óPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendoreó.

Shkak: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Efekti: Planifikim jo i saktë dhe real i kërkesave buxhetore, si dhe mos kryerjen e investimeve në fusha të caktuara të aktivitetit të Bashkisë Mat.

Rëndësia: I Mesëm.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Mat.

Rekomandimi: Për çdo vit buxhetor të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Mat.

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të celura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit paraardhës.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me Vendim të KB.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse *óPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitô*.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Mat dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuar sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për periudhën 2019-2021, rezultoi se është realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Mat ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Dibër.

U verifikuan situacionet mujore të rakorduara me Degën e Thesarit Dibër dhe u gjetën të rakorduara me shpenzimet e kontabilizuara për pjesën e të ardhurave nga taksat dhe tarifat e Bashkisë dhe nga grantet. Të gjitha veprimet për arkëtimet dhe pagesat, për llogari të Bashkisë Mat janë kryer në bankat e nivelit të dytë, të cilat janë të dokumentuara dhe të rregullta, edhe në mbështetje të rakordimeve periodike me Degën e Thesarit Mat, për çdo muaj dhe në mënyrë progresive.

Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve.

Nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, në Bashkinë Mat rezultoi se:

Për vitin 2019, totali i shpenzimeve të planifikuara përbëhet nga:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Të ardhurat e trashëguara nga viti 2018 në vlerën 103,204,092 lekë;
Transferta e pakushtëzuar 183,303,603 lekë;
Transferta specifike në vlerën 141,051,465 lekë;
Të ardhurat e planifikuara për tu mbledhur gjatë vitit në vlerën 87,077,000 lekë;
Total për tu shpenzuar 514,636,160 lekë.

Përgjatë vitit 2019 buxheti i Bashkisë Mat ka pësuar **6 ndryshime**⁴, me efekt në shtesa/pakësim të fondeve për artikull ekonomik, konkretisht:

Me VKB nr.33 datë 21.03.2019, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve në sport, rikonstruksion ujësjellësi dhe emergjencat civile në vlerën 7,495,454 lekë gjithësej.

Me VKB nr.71 datë 22.07.2019, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve në shërbimet bashkiake (ndriçim) në vlerën 805,768 lekë gjithësej.

Me VKB nr.12 datë 29.08.2019, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve në sport në vlerën 4,000,000 lekë gjithësej.

Me VKB nr.13 datë 29.08.2019, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve në shërbimet bashkiake dhe aparatit e Bashkisë, në vlerën 9,627,182 lekë gjithësej.

Me VKB nr.21 datë 25.09.2019, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve në për turizmin dhe shërbime bashkiake në vlerën 510,000 lekë gjithësej.

Me VKB nr.22 datë 25.09.2019, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve në paga dhe sigurime shoqërore në vlerën 1,113,632 lekë gjithësej.

Gjithësej plani vjetor progresiv i buxhetit për vitin 2019 ka qenë 811,372,000 lekë, ose 296,735,840 lekë më tepër nga plani fillestar. Realizimi i buxhetit të vitit 2019 ka qenë në vlerën 739,842,000 lekë, ose 71,530,000 lekë më pak.

Nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, në Bashkinë Mat rezultoi se:

Për vitin 2020, totali i shpenzimeve të planifikuara përbëhet nga:

Të ardhurat e trashëguara nga viti 2019 në vlerën 21,599,144 lekë;

Transferta e pakushtëzuar 187,686,122 lekë;

Transferta specifike në vlerën 142,288,833 lekë;

Të ardhurat e planifikuara për të mbledhur gjatë vitit në vlerën 102,591,000 lekë;

Total për tu shpenzuar 454,165,099 lekë.

Përgjatë vitit 2020 buxheti i Bashkisë Mat ka pësuar **5 ndryshime**, me efekt në shtesa/pakësim të fondeve për artikull ekonomik, konkretisht:

Me VKB nr.17 datë 03.03.2020, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve për blerje makineri në vlerën 21,541,006 lekë gjithësej.

Me VKB nr.19 datë 03.03.2020, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve në kamera dhe çekma publike në vlerën 3,090,000 lekë gjithësej.

Me VKB nr.33 datë 20.03.2020, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve për ndihmë financiare, në vlerën 140,000 lekë gjithësej.

Me VKB nr.101 datë 28.08.2020, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve investime për riveshjen me asfalt-beton të rrugëve të qytetit në vlerën 3,000,000 lekë gjithësej.

⁴Pasqyruar në tabelën nr.1 në Kapitullin Aneksë – 1.1.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Me VKB nr.124 datë 09.11.2020, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve për festa, blerje soba, ndihmë financiare, në vlerën 6,450,086 lekë gjithësej.

Gjithësej plani vjetor progresiv i buxhetit për vitin 2020 ka qenë 1,047,848,000 lekë, ose 593,682,901 lekë më tepër nga plani fillestar. Realizimi i buxhetit të vitit 2020 ka qenë në vlerën 976,379,000 lekë, ose 71,469,000 lekë më pak.

Nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, në Bashkinë Mat rezultoi se:

Për vitin 2021, totali i shpenzimeve të planifikuara përbëhet nga:

Të ardhurat e trashëguara nga viti 2020 në vlerën 45,255,315 lekë;

Transferta e pakushtëzuar 191,370,844 lekë;

Transferta specifike në vlerën 148,936,594 lekë;

Të ardhurat e planifikuara për t'u mbledhur gjatë vitit në vlerën 107,192,000 lekë;

Total për tu shpenzuar 492,754,753 lekë.

Përgjatë vitit 2021 buxheti i Bashkisë Mat ka pësuar **5 ndryshime**, me efekt në shtesa/pakësim të fondeve për artikull ekonomik, konkretisht:

Me VKB nr.14 datë 19.02.2021, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve për mbikëqyrje rikonstrukcion dhe kolaudim në vlerën 701,777 lekë gjithësej.

Me VKB nr.41 datë 07.04.2021, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve për blerjen e materialeve të ndryshme në vlerën 2,000,000 lekë gjithësej.

Me VKB nr.92 datë 26.08.2021, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve rikonstrukcion, mbikëqyrje dhe kolaudim për rikonstrukcion në vlerën 1,522,966 lekë gjithësej.

Me VKB nr.104 datë 25.10.2021, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve për ndihmë financiare, blerje materiale dekorative, oponencë teknike, në vlerën 3,685,286 lekë gjithësej.

Me VKB nr.129 datë 17.12.2021, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve për blerje makineri, bashkëfinancim për ndërtimin e ujësjellësit fshati German në vlerën 3,596,550 lekë gjithësej.

Gjithësej plani vjetor progresiv i buxhetit për vitin 2021 ka qenë 1,742,337,000 lekë, ose 1,249,582,247 lekë më tepër nga plani fillestar. Realizimi i buxhetit të vitit 2021 ka qenë në vlerën 1,570,764,000 lekë, ose 171,573,000 lekë më pak.

-Mbështetur në përcaktimin e bërë në pikën 149 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, i ndryshuar, në gjykimin e grupit të auditimit ndryshimet buxhetore të shpeshta përgjatë vitit buxhetor, tregon për një performancë mesatare në zbatimin e buxhetit.

Tabela nr.5 Realizimi i buxhetit vjetor në nivel programi ekonomik

Nr	Emërtimi	Buxheti Vjetor 2019	Realizimi	%	Buxheti Vjetor 2020	Realizimi	%	Buxheti Vjetor 2021	Realizimi	%
1	Aparati	145,731	139,942	96%	122,011	117,495	96%	159,706	115,534	72%
2	Ujitja e kullimi	22,137	16,442	74%	15,958	12,798	80%	14,891	10,194	68%
3	Bujqesia	10,805	10,163	94%	174,595	173,575	99%	30,357	28,062	92%
4	Sherbimi pyjor	7,774	6,860	88%	9,286	8,316	90%	9,250	8,100	88%
5	Sektori rrugeve	63,170	54,162	86%	63,985	61,594	96%	51,401	43,736	85%
6	Menaxhimi mbetjeve	26,625	17,771	67%	28,626	19,868	69%	39,770	17,881	45%
7	Sherbimet vendore	1,837	1,542	84%	2,470	1,367	55%	1,653	1,085	66%
8	Nderrmarrja e Sherbimeve Bashkiake	28,141	27,471	98%	29,775	29,720	100%	39,934	39,709	99%
9	Policia Bashkiake	6,942	6,824	98%	9,088	8,886	98%	9,630	9,589	100%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

10	Ndricimi rrugor	4,000	2,701	68%	4,500	4,397	98%	4,500	2,887	64%
11	Ujësjetlesi	16,395	15,044	92%	7,051	4,189	59%	5,728	3,737	65%
12	Cerdhet	12,103	11,856	98%	11,583	11,014	95%	12,725	12,279	96%
13	Sporti	18,788	18,689	99%	15,050	14,863	99%	17,279	16,794	97%
14	Kultura	8,888	7,996	90%	8,226	8,060	98%	10,080	9,857	98%
15	Fondi emergjences civile	4,795	4,104	86%	11,620	8,995	77%	7,904	7,167	91%
16	Arsimi 9 vjecar	88,082	71,521	81%	91,917	74,772	81%	140,058	81,931	58%
17	Arsimi mesem	37,611	24,087	64%	35,114	29,656	84%	27,489	19,225	70%
18	Urbanistika	-	-	-	300	120	40%	4,000	3,944	99%
19	Sherbimi zjarrfikës	16,426	12,675	77%	17,756	16,380	92%	24,252	21,861	90%
20	Sherbimet sociale	1,909	1,250	65%	3,571	1,860	52%	3,182	2,636	83%
21	QKB	1,601	1,466	92%	1,607	1,543	96%	1,622	1,537	95%
22	Ndihma Ekonomike dhe PAK	277,363	277,344	100%	343,318	339,143	99%	399,923	386,621	97%
23	Gjendja Civile	5,757	5,440	94%	7,073	6,939	98%	6,495	6,282	97%
24	Shpenzime per KZAZ	1,553	1,553	100%	22,953	10,863	47%	2,097	2,085	99%
25	Shpenzime per Termetin	2,939	2,939	100%	9,966	9,966	100%	-	-	-
26	Banesat sociale							4,575	4,575	100%
27	Banesat sociale							1,523	1,292	85%
28	Ujësjetlesja Fonde nga Ministria							712,168	712,164	100%
	TOTAL	811,372	739,842	91%	1,047,759	976,379	93%	1,742,337	1,570,764	90%

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, rezultojnë se:

Për vitin 2019 realizimi i buxhetit është në nivelin 91%, si dhe programi ekonomik që paraqitet me realizimin më të lartë është **Ndihma Ekonomike dhe PAK**, transfera specifike, që vjen nga Ministria e Shëndetësisë;

Programi ekonomik me realizimin më të ulët është **Arsimi i mesëm dhe konviktet**.

Për vitin 2020 realizimi i buxhetit është në nivelin 93%, si dhe programi ekonomik që paraqitet me realizimin më të lartë është **Ndërmarrja e Shërbimeve Bashkiake**;

Programi ekonomik me realizimin më të ulët është **Urbanistika**.

Për vitin 2021 realizimi i buxhetit është në nivelin 90%, si dhe programi ekonomik që paraqitet me realizimin më të lartë është **Ndërtimi i ujësjetlesit**;

Programi me realizimin më të ulët është **Menaxhimi i mbetjeve**.

Titulli i gjetjes: Angazhime buxhetore pa pasur fonde në dispozicion.

Situata: Nga shqyrtimi i kontratave për investime të Bashkisë Mat, financuar nga Ministria e linjës, konstatohet se:

-Në vitin 2020 Bashkia Mat ka lidhur kontratën e sipërmarrjes nr.4321 prot., datë 09.10.2020 me BOE E shpk dhe E shpk, për ndërtimin e ujësjetlesit për furnizim me ujë të fshatrave të Njërive Administrative Derjan dhe Rukaj në Loti I me vlerën 557,546,953 lekë pa TVSH dhe 669,056,344 lekë me TVSH, ndërkohë ka pasur në dispozicion fonde buxhetore deri në momentin e lidhjes së kontratës vetëm 145,856,919 lekë, ose 523,199,425 lekë më pak nga vlera e kontraktuar (referuar shkresës nr.1870 prot., datë 23.07.2020 nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetlës Kanalizime), me qëllim kryerjen e prokurimit përkatës për Lotin I;

-Në vitin 2021 Bashkia Mat ka lidhur kontratën e sipërmarrjes nr.954 prot., datë 24.02.2021 me BOE E shpk dhe E shpk, për ndërtimin e ujësjetlesit për furnizim me ujë të fshatrave të Njërive Administrative Derjan dhe Rukaj në Loti II me vlerën 279,860,372 lekë pa TVSH dhe 335,832,447 lekë me TVSH, ndërkohë ka pasur në dispozicion fonde buxhetore deri në momentin e lidhjes së kontratës vetëm 135,980,974 lekë, ose 198,851,473 lekë më pak nga vlera e kontraktuar (referuar shkresës nr.3134 prot., datë 10.12.2020 dhe nr.369 prot., datë 12.02.2021



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizime), me qëllim kryerjen e prokurimit përkatës për Lotin II;

-Në vitin 2021 Bashkia Mat ka lidhur kontratën e sipërmartjes nr.848 prot., datë 19.02.2021 me BOE L-O shpk dhe F shpk, për ndërtimin e rrjetit shpërndarës së qytetit Burrel (Faza I dhe Faza II), Bashkia Mat, me vlerën 1,035,619,748.95 lekë (pa TVSH) dhe 1,242,743,698.74 lekë (me TVSH), ndërkohë ka pasur në dispozicion fonde buxhetore deri në momentin e lidhjes së kontratës vetëm 502,046,322 lekë, ose 740,697,376 lekë më pak nga vlera e kontraktuar (referuar shkresave nr.3038 prot., datë 27.11.2020 dhe nr.369 prot., datë 12.02.2021 nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizime), me qëllim kryerjen e prokurimit përkatës.

Kriteri:Pika 1, 9, 10, 14 dhe 38 të nenit 3, nenin 40, nenin 50, nenin 51 në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; Pika 2 të VKM nr. 807, datë 16.11.2016 për disiplinimin e angazhimeve buxhetore, i ndryshuar;

Neni 70 dhe neni 76 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar (në fuqi për periudhën kur janë lidhur kontratat e mësipërme);

Pikat 81, 142, 155, 165 në Udhëzimin nr.9, datë 20.03.2018 për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, i ndryshuar.

Shkaku:Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Efekti:Përballjen e Bashkisë Mat me riskun e moslikuidimit në kohë të detyrimeve kontraktuale, krijimin e detyrimeve të prapambetura, të cilat mund të shoqërohen edhe me penalitete.

Rëndësia:I lartë.

Rekomandimi:Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të marrë masat e nevojshme në mënyrë që lidhja e kontratës me operatorët ekonomik të bëhet vetëm pasi fondi i nevojshëm sipas vlerës së kontratës, të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor. Për çdo rast të angazhimeve buxhetore, kryesisht të investimeve për punë publike, Nëpunësi Zbatues të japë opinion me shkrim, për fondin buxhetor që është i disponueshëm për lidhjen e kontratës përkatëse.

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Mat, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Mat, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuara me Vendim të KB ose të diktuar nga transfertat e deleguar nga pushteti qendror.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për periudhën 2019-2021, referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.6 Realizimi i buxhetit (000 lekë) në nivel artikulli ekonomik në vitin 2019

Art	Emertimi	Plan	Fakt	%
600	Paga	246,188	232,539	94%
601	Sigurime Shoqërore	40,546	36,872	91%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	124,725	93,763	75%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

604	Transferta Korente të Brendshme	22,470	22,470	100%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	283,387	282,557	100%
230	Kapitale të Patrupëzuara	6,934	5,922	85%
231	Kapitale të Trupëzuara	87,121	65,719	75%
	TOTAL	811,371	739,842	91%

Tabela nr.7 Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik në viti 2020


Art.	Emertimi	Buxheti Vjetor	Fakti	%
600	Paga	242,528	227,462	94%
601	Sigurime Shoqërore	40,118	37,673	94%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	135,114	111,889	83%
604	Transferta Korente të Brendshme	24,516	24,516	100%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	351,189	344,046	98%
230	Kapitale të Patrupëzuara	4,948	4,000	81%
231	Kapitale të Trupëzuara	249,435	226,793	91%
	TOTAL	1,047,848	976,379	93%

Tabela nr.8 Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik në viti 2021

Art.	Emertimi	Buxheti Vjetor	Fakti	%
600	Paga	271,517	258,488	95%
601	Sigurime Shoqërore	45,275	43,367	96%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	137,963	96,441	70%
604	Transferta Korente të Brendshme	16,500	16,500	100%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	409,134	395,505	97%
230	Kapitale të Patrupëzuara	14,890	13,886	93%
231	Kapitale të Trupëzuara	847,058	746,577	88%
	TOTAL	1,742,337	1,570,764	90%

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së


Grafiku nr.1 Pesha e secilit artikull ndaj totalit





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT



Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelave të mësipërme, rezulton se:

Për periudhën 2019-2021 në krahasim me planet vjetore respektive, realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik për 12-mujorin është mesatarisht në masën 91 %, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 604 Transferta Korente të Brendshme, duke vijuar me transfertat për buxhetet familjare në masën ku përfshihet ndihma ekonomike dhe PAK, ndjekur nga shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, si dhe realizimin më të ulët e kanë shpenzimet për mallra e shërbime dhe shpenzime kapitale. Vihet re që përgjatë periudhës 2019-2021 investimet (231) paraqiten me realizim mesatarisht 85%, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët, çka tregon një planifikim jo të saktë të investimeve dhe ekzekutim të fondeve të planifikuara.

➤ Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit:

Tabela nr.9 Buxheti sipas burimeve të financimit 2019-2021



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Art.	Emertimi	Fakt 2019			
		Gjithesëj	Tr. Pakushtezuar dhe Specifike	Te ardhurat e veta	Transferta e kushtezuar
231	Investime	71,641	63,793	7,848	
600	Paga	232,539	183,901	42,695	5,943
601	Sigurime Shoqërore	36,872	30,032	5,848	992
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	93,763	64,215	24,985	4,563
604	Transferta Korente të Brendshme	22,740	22,740		
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	282,557	5,213		277,344
	Total	740,112	369,894	81,376	288,842
Art.	Emertimi	Fakt 2020			
		Gjithesëj	Tr. Pakushtezuar dhe Specifike	Te ardhurat e veta	Transferta e kushtezuar
231	Investime	230,793	41,911	14,984	173,898
600	Paga	227,462	192,564	28,774	6,124
601	Sigurime Shoqërore	37,673	31,846	4,805	1,022
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	111,889	107,876	2,625	1,388
604	Transferta Korente të Brendshme	24,516	9,600	4,950	9,966
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	344,046	3,639		340,407
	Total	976,379	387,436	56,138	532,805
Art.	Emertimi	Fakt 2021			
		Gjithesëj	Tr. Pakushtezuar dhe Specifike	Te ardhurat e veta	Transferta e kushtezuar
231	Investime	760,461	25,892	6,938	727,631
600	Paga	225,126	183,366	35,445	6,315
601	Sigurime Shoqërore	37,585	30,622	5,919	1,044
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	99,554	67,714	29,697	2,143
604	Transferta Korente të Brendshme	16,499	8,699	7,800	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	391,825	3,931	670	387,224
	Total	1,531,050	320,224	86,469	1,124,357

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

-Referuar tabelave të mësipërme, rezulton se, fondet e shpenzuara nga transferta e kushtëzuar, mesatarisht në vlerën 648,668 mijë lekë, kanë peshën më të lartë në krahasim me burimet e tjera të të ardhurave të Bashkisë Mat, ndjekur nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 359,184 mijë lekë dhe të ardhurat e veta në vlerën 74,661 mijë lekë.

Transferta e kushtëzuar.

-Buxheti nga transferta e kushtëzuar për vitin 2019 është realizuar në vlerën **288,842 mijë lekë**, ose **39%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2019, ku peshën kryesore brenda transfertës së kushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për familjar dhe PAK.

-Buxheti nga transferta e kushtëzuar për vitin 2020 është realizuar në vlerën **532,805 mijë lekë**, ose **55%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2020, ku peshën kryesore brenda transfertës së kushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për familjar dhe PAK. Përgjatë këtij viti në krahasim me vitin 2019, rezulton një rritje e konsiderueshme e fondeve të shpenzuara nga transferta e kushtëzuar, pasi kemi rritje të fondit të investimeve, kryesisht për ujësjellës, si dhe fondit për familjar.

-Buxheti nga transferta e kushtëzuar për vitin 2021 është realizuar në vlerën **1,124,357 mijë lekë**, ose **73%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2021, ku peshën kryesore brenda transfertës së kushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për investime. Përgjatë këtij viti në krahasim me vitin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

2020, rezulton një rritje e konsiderueshme e fondeve të shpenzuara nga transfertat e kushtëzuar, pasi kemi rritje të fondit të investimeve, kryesisht për ujësjellës, si dhe fondit për familjar me një rritje të lehtë.

Transferta e pakushtëzuar.

-Buxheti nga transfertat e pakushtëzuar për vitin 2019 është realizuar në vlerën **369,894 mijë** lekë, ose **50%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2019, ku peshën kryesore brenda transfertës së pakushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për paga (funksionet e deleguara nga qeveria qendrore në atë vendore).

-Buxheti nga transfertat e pakushtëzuar për vitin 2020 është realizuar në vlerën **387,436 mijë** lekë, ose **40%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2020, ku peshën kryesore brenda transfertës së pakushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe shpenzime operative. Përgjatë këtij viti në krahasim me vitin 2019, rezulton një rritje e lehtë e fondeve të shpenzuara nga transfertat e pakushtëzuar, pasi kemi rritje të fondit të pagave, si dhe fondit për shpenzime operative.

-Buxheti nga transfertat e pakushtëzuar për vitin 2021 është realizuar në vlerën **1,124,357 mijë** lekë, ose **20%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2021, ku peshën kryesore brenda transfertës së pakushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për paga.

Të ardhurat e veta.

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2019 është realizuar në vlerën **81,376 mijë** lekë, ose **11%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2019, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe shpenzime operative.

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2020 është realizuar në vlerën **56,138 mijë** lekë, ose **0.06%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2020, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe investime (bashkëfinancim të punëve publike me fondet e transfertës së kushtëzuar). Theksojmë se në këtë vit të ardhurat kanë një rënie të konsiderueshme, si rrjedhojë edhe të situatës së krijuar prej Pandemis Covid-19.

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2021 është realizuar në vlerën **86,469 mijë** lekë, ose **0.06%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2021, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe shpenzime operative. Theksojmë se në krahasim me vitin 2020, kemi një rritje të të ardhurave, por kjo nuk është e ndjeshme në peshën totale të të ardhurave të shpenzuara ndaj fondeve në total të shpenzuara për vitin 2021, pasi në këtë vit siç e kemi cituar më sipër, është akorduar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime) fondi prej 588,168 mijë lekë për investim në ndërtim të ujësjellësave.

-Fonde nga FZHR nuk ka pasur.

➤ Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës.

Me miratimin e buxheteve respektive 2019-2021 është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/i kontigjencës, ku për vitin 2019 është planifikuar në masën 4,000 mijë lekë, i cili nuk është përdorur. Për vitin 2020 është planifikuar 360 mijë lekë, i cili nuk është përdorur, si dhe për vitin 2021 është planifikuar 145 mijë lekë dhe nuk është përdorur.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

➤ **Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile.**

Nga Bashkia Mat është krijuar edhe fondi për emergjencat civile, ku për vitin 2019 në total, fondi i planifikuar për emergjencën civile paraqitet në shumën 7,734 mijë lekë dhe përdorur në vlerën 7,043 mijë lekë, për dëme të krijuara nga tërmeti në Bashkinë Mat.

Për vitin 2020 është planifikuar në vlerën 21,956 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 18,961 mijë lekë, për mbulimin e dëmeve të krijuara nga tërmeti dhe përballimin e shpenzimeve të krijuara nga pandemia Covid-19.

Për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 7,904 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 7,167 mijë lekë, për mbulimin e shpenzimeve për rikonstruksionin e banesave sociale në pronësi të Bashkisë Mat.

➤ **Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Mat.**

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se, Bashkia Mat përgjatë periudhës 2019-2021 nuk ka marrë nuk ka dhënë asnjë subvencion.

➤ **Realizimi i Investimeve.**

Titulli gjetjes:Planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli.

Situata:Grupi i KLSH-së konstaton se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet në nivele të ulta në vitin 2019, konkretisht në masën 75%, në vitin 2020 duke ardhur me një rritje të tyre në vlerën 91%, si dhe duke vijuar me vitin 2021 në vlerën 88%.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Mat në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

Kriteri:Shkronja 0a0 në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 *ó*Për financat e vetëqeverisjes vendore; Neni 47 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 *ó*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

Shkaku:Planifikim i procedurave të prokurimeve për mallra/shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke i planifikuar ato në raport me planin dhe jo me faktin e të ardhurave të vitit të mëparshëm.

Efkti: Mos realizim i investimeve të planifikuara.

Rëndësia:I Lartë.

Rekomandimi:Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të marrë masa që planifikimi i fondeve për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave në vitin paraardhës dhe jo të planifikimit të tyre.

➤ **Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 muor në Këshillin Bashkiak.**

Në zbatim të nenit 48 *ó*Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor *ó* të ligjit 68/2017 *ó*Për financat e vetëqeverisjes vendore, ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 *ó*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar neni 65,UMF nr. 2, datë 06.02.2012 *ó*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit *ó* i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 dt.30.07.2018 *ó*Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Vendore⁵, si dhe nenin 44⁵, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 *óPër vetëqeverisjen vendore*, konstatohet se për vitin 2019 nuk janë realizuar raportet 4 dhe 8 mujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit të shtetit, por është realizuar raporti i monitorimit 12 mujor.

Për vitet 2020 dhe 2021 raportet periodike dhe ai vjetor (përfshijë raportin 12-mujor të vitit 2021 që nuk është paraqitur në MFE) për monitorimin e zbatimit të buxhetit, janë realizuar dhe përcjellë në Këshillin Bashkiak, si dhe Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra më sipër.

➤ **Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID-19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.**

Përshkrimi	Vlera
Denzifikim të ambjenteve publike të Bashkisë Mat	2,468,308
Materiale Pastrimi dhe Denzifikimi	823,680
Furnizim dhe shërbim me ushqime	4,165,200
Totali	7,457,188

-Sa i përket fondeve të shpenzuara nga Bashkia Mat për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, rezulton se, përgjatë vitit 2020 janë shpenzuar 7,457,188 lekë gjithësej. Me VKB nr.31, datë 20.03.2020, është miratuar përdorimi i fondit të emergjencave civile të Bashkisë Mat në shumën 2,500,000 lekë për dezinfektimin e ambjenteve publike dhe blerjen e materialeve mbrojtëse ndaj virusit Covid-19. Gjithashtu me VKB nr.34, datë 31.03.2020 është miratuar përdorimi i fondit prej 5,000,000 lekë për blerje ushqimesh për familjet në nevojë dhe materiale të ndryshme që shërbejnë për higjienën familjare.

Titulli i gjetjes: Angazhime buxhetore përtej afatit ligjor.

Situata: Përgjatë periudhës 2020-2021 konstatohet se, Bashkia Mat ka ndërmarrë angazhime të reja buxhetore përtej datës 15 tetor, me vlerë totale **32,323,128 lekë**, duke hyrë në marrëdhënie kontraktuale me operator ekonomik, për kryerjen e punimeve publike të ndryshme, konkretisht:

-Për vitin 2020 janë ndërmarrë **3 angazhime** buxhetore në vlerën **16,044,952 lekë**, sipas kontratës nr.4697 Prot., datë 30.10.2020 me OE C-R-2008 shpk për kryerjen e punimeve *óRiveshje* me asfaltobeton rrugë të brendshme në qytetin Burrel, Bashkia Mat në vlerën 11,794,070 lekë, kontratës nr.5235 prot., datë 27.11.2020 me OE R shpk, për kryerjen e punimeve *óNdërtim* i fushës sportive shkolla 28 Nëntori në vlerën 1,234,896 lekë, si dhe kontratës nr.5749 prot., datë 24.12.2020 me OE Co R 2008 shpk për kryerjen e punimeve *óRehabilitim* i sinjalistikës horizontale, Bashkia Mat në vlerën 3,015,986 lekë.

-Për vitin 2021 janë ndërmarrë **2 angazhime** buxhetore në vlerën **16,278,176 lekë**, sipas kontratës nr.5069 prot., datë 18.11.2021 me OE C shpk për kryerjen e punimeve *óRikonstruksion* i Qendrës Shëndetësore Lis, Ambulancës Zenisht dhe Ambulancës Mallunxë në vlerën 13,038,692 lekë, si dhe kontratës nr.5548 prot., datë 17.12.2021 me OE 2 N shpk, për kryerjen e punimeve *óRikonstruksion* i rrugëve lidhëse me sheshin e Njesisë Administrative Koms, Bashkia Mat, në vlerën 3,239,484 lekë;

⁵ Kryetari i njësive të vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport paraqitet në këshill jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Kriteri: Neni 51 në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Efekti: Angazhime buxhetore të cilat nuk raportohen në dokumentet standarde që shoqërojnë hartimin e PBA dhe buxhetit vjetor.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mat, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrin masat e nevojshme që të eliminojë praktikën e ndërmarrjes së angazhimeve buxhetore përtej afatit ligjor.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Mat, rezulton se, është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për çdo vit buxhetor, janë raportuar periodikisht në Këshillin Bashkiak dhe MFE.

Me fondet buxhetore 2019, 2020 dhe 2021, përgjithësisht janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministritë e linjës sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Sipas raportimit të kryer në strukturat/institucionet e mësipërme, shuma e detyrimit përgjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2021 ka ardhur duke u rritur. Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet zhvillimi i shumës së detyrimit përgjatë periudhës 2019-2021.

Tabela nr. 10 Detyrime për periudhën 2019 - 2021

Detyrime e NJQV 2019	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2018	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2019	Total detyrime	Shlyerja gjatë 3 mujorit të parë 2019	Mbetja në fund të vitit 2019
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
Investime	14,904,892	14,874,211	29,779,103	4,209,270	8,089,821
Mallra dhe shërbime	18,612,212	32,434,511	51,046,723	768,122	21,016,195
Vendime gjyqësore	16,043,415	6,026,131	22,069,546	2,356,631	15,768,315
Tjera ...	31,461,595	7,808,472	39,270,067	30,020,910	3,071,438
Total Detyrime	81,022,114	61,143,325	142,165,439	37,354,933	47,945,769
Gjendja e llogarisë 520 në fund të vitit 2018					
	119,345,093				

Detyrime e NJQV 2020	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2019	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2020	Total detyrime	Shlyerja gjatë 3 mujorit të parë 2020	Mbetja në fund të vitit 2020
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
Investime	8,089,821	27,540,000	35,629,821	6,533,340	-
Mallra dhe shërbime	21,016,195	32,474,659	53,490,854	13,868,631	16,173,941
Vendime gjyqësore	15,768,315	799,000	16,567,315	500,000	3,750,850
Tjera ...	3,071,438	2,191,771	5,263,209	2,455,115	
Total Detyrime	47,945,769	63,005,430	110,951,199	23,357,086	49,436,623
Gjendja e llogarisë 520 në fund të vitit 2019					
	69,562,415				

Detyrime e NJQV 2021	Detyrimi në fillim të vitit 2021	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2021	Total detyrime	Shlyerja gjatë 3 mujorit të parë 2021	Mbetja në fund të vitit 2021
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

	vitit i mbartur 31.12.2020	krijuar gjatë vitit 2021	detyrime	mujorit të parë 2021	fund të vitit 2021
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
Investime		9,322,144	9,322,144	-	279,039,812
Mallra dhe shërbime	16,173,941	63,910,191	80,084,132	11,128,782	16,972,372
Vendime gjyqësore	3,750,850	40,953,887	44,704,737	3,019,015	3,600,293
Tjera ...		3,422,591	3,422,591	757,942	32,854
486					10,018,007
Total Detyrime	19,924,791	117,608,813	137,533,604	14,905,739	316,892,067
Gjendja e llogarisë 520 në fund të vitit 2020	63,657,799				

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Vlera e detyrimeve të mësipërme është kryqëzuar me vlerën e detyrimeve që ka Bashkia Mat ndaj palëve të treta, të pasqyruar në Pasqyrat Financiare 2019, 2020 dhe ato pjesore të vitit 2021, si dhe dokumentacionin justifikues dhe detyrues (faturë tatimore/vendim gjykate) që krijon detyrimin përkatës.

Titulli i gjetjes: Likujdimi i detyrimeve si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore.

Situata: Nga kryqëzimi i të dhënave mbi detyrimet e Bashkisë Mat ndaj palëve të treta, kryesisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore, **konstatohet se:**

-Për vitin 2019 dhe 2020 nuk është pasqyruar detyrimi i Bashkisë Mat ndaj subjektit óSh- Mô shpk, për likujdimin e detyrimit në vlerën 2,551,170 lekë sipas vendimit nr.2981, datë 12.11.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit. Ndaj këtij subjekti është kryer likujdim pjesor në vitin 2020 në vlerën 580,000 lekë, ndërkohë që në fund të vitit 2020 Bashkia Mat ka pasur disponibilitete në thesar, të cilat mund të përdorte për likujdimin e detyrimit ndaj subjektit të mësipërm. Për më tepër konstatohet se, në vitin 2021 ndaj këtij subjekti nuk është kryer asnjë likujdim, ndërkohë që rezulton se, në vitin 2021 Bashkia Mat ka kryer likujdime ndaj subjekteve të tjera (A. R, E. D) për detyrime të krijuara nga vendimet gjyqësore, të cilat kanë dal më vonë në kohë në krahasim me vendimit e gjykatës për subjektin e mësipërm, pra pa e respektuar rradhën e likujdimit sipas paraqitjes së detyrimit.

-Për vitin 2018 (detyrim i mbartur në vitin 2019) nuk është pasqyruar detyrimi progresiv i Bashkisë Mat ndaj subjektit óSh- Mô, për likujdimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr.06, datë 03.02.2012, në vlerën 5,780,080 lekë, si dhe 527,526 lekë detyrim për shpenzime për përmbarrimin. Përgjatë vitit 2018 nuk janë kryer likujdime ndaj detyrimeve të mësipërme ndërkohë që rezulton se, në fund të vitit 2018 Bashkia Mat ka pasur disponibilitete në thesar në vlerën 119,345,093 lekë që mund të përdorte për likujdimin e detyrimit ndaj subjektit óSh-Mô deri në fund të vitit 2018. Në fund të vitit 2019 detyrimi i njohur dhe i pasqyruar ndaj subjektit të mësipërm është në vlerën 600,000 lekë, ndërkohë detyrimi deri në fund të periudhës 5,180,080 lekë dhe 527,526 lekë përmbarrimi. Përgjatë vitit 2019 Bashkia Mat ka kryer likujdime pjesore në vlerën 600,000 lekë, ndërkohë që në fund të vitit 2019 ka pasur disponibilitete në thesar në vlerën 69,562,415 lekë, të cilat mund të përdorte për shlyerjen e detyrimit. Në fund të vitit 2020 nuk është pasqyruar detyrimi i mbetur ndaj subjektit óSh- Mô, ndërkohë është kryer likujdim pjesor në vlerën 300,000 lekë, ndërkohë që në fund të vitit 2020 ka pasur disponibilitete në thesar në vlerën 63,657,799 lekë, të cilat mund të përdorte për shlyerjen e detyrimit. Në fund të vitit 2021 është e njëjta situatë, ku për subjektin e mësipërm nuk pasqyrohet detyrimi i mbetur, ndërkohë që përgjatë këtij viti janë kryer likujdime pjesore në vlerën 2,000,000 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

-Si rrjedhojë e Vendimit nr.2275, datë 07.11.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, ndaj Bashkisë Mat është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit óG-Pô në vlerën 1,929,864 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2021 janë kryer likujdime pjesore në vlerën 1,050,000 lekë, ndërkohë në fund të çdo viti buxhetor siç e kemi cituar edhe më sipër Bashkia Mat ka pasur fonde në dispozicion, të cilat mund të përdorte për likujdimin e detyrimeve për vendimet gjyqësore.Për më tepër konstatohet se përgjatë vitit 2020 Bashkia Mat nuk ka kryer asnjë likujdim ndaj subjektit të mësipërm, ndërkohë që përgjatë këtij viti Bashkia Mat ka kryer likujdime ndaj subjekteve të tjera (A- M, Sh-M) për detyrime të krijuara nga vendimet gjyqësore, të cilat kanë dal më vonë në kohë në krahasim me vendimet e gjykatës për subjektin e mësipërm, pra pa e respektuar rradhën e likujdimit sipas paraqitjes së detyrimit.

-Si rrjedhojë e Vendimit nr.545, datë 21.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit është krijuar detyrimi ndaj subjektit óR- Kô në vlerën 2,470,986 lekë, për të cilin nuk është kryer asnjë likujdim në vitet 2019 dhe 2020 megjithëse Bashkia Mat në fund të viteve përkatëse ka patur disponibilitete në thesar, të cilat mund të përdorte për kryerjen e likujdimeve ndaj subjektit të mësipërm. Për më tepër konstatohet se, përgjatë vitit 2020 Bashkia Mat ka kryer likujdime ndaj subjekteve të tjera (Sh- M) për detyrime të krijuara nga vendimet gjyqësore, të cilat kanë dal më vonë në kohë në krahasim me vendimet e gjykatës për subjektin e mësipërm, pra pa e respektuar rradhën e likujdimit sipas paraqitjes së detyrimit. Ndaj subjektit të mësipërm është kryer likujdim pjesor në vitin 2021 në vlerën 680,648 lekë, por përsëri konstatohet se, nuk është respektuar radha e pagesës në raport me datën e vendimit të gjykatës, pasi është kryer likujdim ndaj subjektit A- R më përpara, ndërkohë që vendimi i gjykatës për këtë subjekt ka dalë më vonë në krahasim me vendimin e gjykatës për subjektin óR-Kô.

-Si rrjedhojë e Vendimit nr.250, datë 04.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, është krijuar detyrimi ndaj subjektit óE-Dô në vlerën 873,841 lekë. Ky detyrim nuk është pasqyruar në detyrimet e fundvitit 2020. Ndaj këtij subjekti është kryer pagesa në vlerën 200,000 lekë në vitin 2021.

-Si rrjedhojë e Vendimit nr.14, datë 16.01.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit, është krijuar detyrimi ndaj subjektit óA-Rô në vlerën 656,250 lekë. Ky detyrim nuk është pasqyruar në detyrimet e fundvitit 2020. Ndaj këtij subjekti në vitin 2020 nuk është kryer asnjë pagesë ndaj subjektit megjithëse Bashkia Mat në fund të vitit ka pasur disponibilitete në thesar.

-Gjithashtu konstatohet për likujdimet e subjekteve të mësipërme janë nxjerrë urdhrat përkatës nga titullari i institucionit, por konstatohet se në urdhrin e likujdimit nuk është nxjerrë edhe përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna, moslikujdimit në kohë të detyrimit pa krijuar shpenzime të përmbarimit) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Mat.

Kriteri: Pikat 8 dhe 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 óPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitô, i ndryshuar;

Udhëzimi nr.1, datë 04.06.2014 óPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesaritô.

Shkaku:Moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës, mungesa e planifikimit në buxhet të likujdimit të detyrimeve të prapambetura.

Efekti:Krijimi i detyrimeve të prapambetura, të cilat ndikojnë negativisht në buxhetin e Bashkisë Mat.

Rëndësia:I Lartë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mat, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë mënyrën dhe kronologjinë e likujdimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin gjatë zbatimit të buxhetit.

-Gjithashtu për çdo rast të likujdimit të detyrimeve të vendimeve gjyqësore, në urdhrin e autorizimit të shpenzimit, të evidentohet dhe të kërkohej nxjerrja e përgjegjësisë administrative, të punonjësit përgjegjës.

➤ **Faturat e palikuiduara brenda afatit 30 ditor**

Titulli gjetjes: Fatura të pa likuiduara brenda afatit 30 ditor, duke krijuar në fund të vitit buxhetor detyrime të prapambetura, si dhe mosrespektimi i rradhës në likujdimin e tyre.

Situata: Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit **30 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Mat, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 2019-2021, ky afat nuk është respektuar në 563 raste për vlerën 279,939,309 lekë, pasqyruar në tabelën përmbledhëse më poshtë⁶:

Tabela nr.11 përmbledhëse e faturave 2019-2021

Llog. 602		Llog. 230-231	
Sasia	Vlera	Sasia	Vlera
537	236,100,914	26	43,838,395

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Faturat e mësipërme ndahen si më poshtë vijon:

- Viti 2019 ñ255 fatura në vlerën 67,021,031 lekë, nga të cilat 247 fatura për shpenzime për mallra/shërbime në vlerën 51,820,098 lekë, si dhe 8 fatura për shpenzime për investime në vlerën 15,200,933 lekë.

Në fund të vitit 2019 detyrimet e Bashkisë Mat ndaj palëve të treta të krijuara gjatë vitit 2019, si rrjedhojë e moslikujdimit të detyrimeve, janë gjithësej 70 fatura për shpenzime për mallra, shërbime dhe investime në vlerën 28,195,142 lekë.

- Viti 2020 ñ193 fatura në vlerën 110,320,004 lekë, nga të cilat 186 fatura për shpenzime për mallra/shërbime në vlerën 88,467,200 lekë, si dhe 7 fatura për shpenzime për investime në vlerën 21,852,804 lekë.

Në fund të vitit 2020 detyrimet e Bashkisë Mat ndaj palëve të treta të krijuara gjatë vitit 2020, si rrjedhojë e moslikujdimit të detyrimeve, janë gjithësej 46 fatura për shpenzime për mallra, shërbime dhe investime në vlerën 43,662,608 lekë.

-Detyrimi progresiv deri më datë 31.12.2020 është në vlerën **49,436,623 lekë**.

-Stoku i detyrimeve të prapambetura, në kuptim të përcaktimit të bërë në Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 óPër monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme, pra për fatura të cilat nuk janë likuiduar brenda 60 ditëve kalendarike dhe vendimet gjyqësore, është në vlerën 15,668,018 lekë⁷.

⁶ Analitikisht në tabelën nr.2, në Kapitullin “Aneksë”.

⁷Llogaria 467 dhe 401-408.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Detyrimi i mësipërm është parashikuar të likujdohet nga Bashkia Mat nëpërmjet të ardhurave të veta dhe nga granti i nivelit qendror, përkatësisht:

11,496,254 lekë nga të ardhurat e veta;

37,940,369 lekë nga granti i nivelit qendror.

- Viti 2021 në 114 fatura në vlerën 104,995,969 lekë, nga të cilat 104 fatura për shpenzime për mallra/shërbime në vlerën 95,813,616 lekë, si dhe 10 fatura për shpenzime për investime në vlerën 9,182,353 lekë.

Në fund të vitit 2021 detyrimet e Bashkisë Mat ndaj palëve të treta të krijuara gjatë vitit 2021, si rrjedhojë e moslikujdimit të detyrimeve, janë gjithësej 57 fatura për shpenzime për mallra, shërbime dhe investime në vlerën 309,026,173 lekë.

-Detyrimi progresiv deri më datë 31.12.2021 është në vlerën **316,892,067 lekë**.

-Stoku i detyrimeve të prapambetura, në kuptim të përcaktimit të bërë në Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme, pra për fatura të cilat nuk janë likujduar brenda 60 ditëve kalendarike dhe vendimet gjyqësore, është në vlerën 32,115,797 lekë⁸.

-Në krahasim me vitin 2020 kemi rritje të stokut të detyrimeve të prapambetura në vlerën 16,447,779 lekë.

Detyrimi i mësipërm është parashikuar të likujdohet nga Bashkia Mat nëpërmjet të ardhurave të veta dhe nga granti i nivelit qendror, përkatësisht:

35,506,378 lekë nga të ardhurat e veta;

279,224,590 lekë nga granti i nivelit qendror⁹.

-Në vitin 2021 kemi rritje të vlerës së detyrimit me 267,455,444 lekë në krahasim me vitin 2020, pasi 257,993,712 lekë përbëjnë detyrim të Bashkisë Mat për ndërtimin e ujësjellësit Burrel dhe Derjan, me financim nga Ministria e Linjës.

-Detyrime për shpronësime në Bashkinë Mat nuk ka patur.

-Sa i përket likujdimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, konstatohet se, nuk respektohet rradha e likujdimit të tyre, pra fatura e parë likujdohet më parë.

-Konkretisht për detyrimin për Trajtim Ushqimor Sportiv i datës 30.06.2011, është likujduar më datë 05.07.2019, ndërkohë që janë kryer likujdime përpara kësaj date për detyrime të krijuara në vitin 2018, pra shumë kohë më pas;

-Për detyrimin ndaj subjektit OI i datës 14.06.2018 në vlerën 1,054,231 lekë, likujduar më datë 24.09.2019, ndërkohë që përpara kësaj date janë likujduar detyrime të krijuara dhe faturuara përgjatë vitit 2018, pas datës 14.06.2018, që i përket faturës së lëshuar nga Infosoft.

-Për detyrimin ndaj subjektit T-C shpk, i datës 30.07.2018 në vlerën 104,905 lekë, likujduar më datë 12.06.2019, ndërkohë që përpara kësaj date janë likujduar detyrime të krijuara dhe faturuara përgjatë vitit 2018, pas datës 14.06.2018, që i përket faturës së lëshuar nga Infosoft.

⁸Llogaria 467 dhe 401-408.

⁹ Analitikisht në tabelën nr.2.1, në Kapitullin "Aneksë".



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

-Për detyrimin në fund të vitit 2018 ndaj subjektit Sh. A, tarifë përmbartimore faturuar më datë 03.12.2018 në vlerën 1,371,483 lekë, për të cilin përgjatë vitit 2019 është kryer likuidim pjesor në vlerën 44,400 lekë, ndërkohë përgjatë vitit 2020 nuk është kryer asnjë likuidim, megjithëse gjatë vitit 2020 janë kryer likuidime të detyrimeve të prapambetura nga viti 2019 (blerje automjet zjarrëfikse në vlerën 2,844,000 lekë faturë e datës 11.11.2019, kancelari në vlerën 1,125,868 lekë faturë e datës 28.06.2019), pra detyrime të mëvonshme të krijuara për Bashkinë Mat, si dhe për vlera edhe më të mëdha se sa fatura e subjektit óSh. Aó. Për më tepër, konstatohet se ky subjekt edhe në vitin 2021 është likuiduar pjesërisht në vlerën 132,000 lekë, më datë 29.12.2021.

Kriteri: Pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 óPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitó, i ndryshuar.

Shkaku: Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesës më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i radhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Efekt: Mos likuidim në kohë i shpenzimeve sjell akumulim të borxhit të institucionit për fatura të palikujduara.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të marrë masa për:

-Sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përfshijë kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë dhe duke respektuar radhën e likuidimit sipas parimit óhyrje e parë ñ dalje e parëó.

-Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR/Ministritë e linjës, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Ekonomike dhe e të Ardhurave për periudhën 2019-2021, në lidhje me investimet publike, rezultoi se nuk ka financim projektesh nga FSHZH/FZHR. Nga grandet dhe fondet e veta, për periudhën 2019-2021 janë financuar gjithësej 137 projekte investimi për vlerën 208,528,008 lekë¹⁰, ndarë si më poshtë vijon:

-2019 ñ 57 projekte investimi me vlerë 91,620,392 lekë, nga të cilat 83,577,484 lekë nga grant, ose 91.3%, si dhe 8,042,908 lekë nga të ardhurat e veta, ose 8.7 %.

-2020 ñ 34 projekte investimi me vlerë 56,396,420 lekë, nga të cilat 44,087,678 lekë nga grant, ose 78.1%, si dhe 12,308,742 lekë nga të ardhurat e veta, ose 21.9 %.

-2021 - 46 projekte investimi me vlerë 60,511,196 lekë, nga të cilat 50,466,123 lekë nga grant, ose 83%, si dhe 10,045,073 lekë nga të ardhurat e veta, ose 17 %.

Sa i përket fondeve të alokuara nga Ministritë e Linjës (Infrastrukturës, Bujqësisë, Shëndetësisë) për periudhën 2019-2021, rezulton se janë financuar 6 projekte investimi me vlerë kontrate

¹⁰Pasqyruar në tabelën nr.3 në Kapitullin Anekse.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

1,974,458,409 lekë, pasqyruar në tabelat si më poshtë vijon:

Tabela nr.14 Fonde të deleguara për vitin 2020 nga Ministria e linjës për investime si dhe likuidimi i tyre

Nr	Objekti i Prokurimit	Vlera kontratës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Likuidimi		Mbetur 31.12.2021
				2020	2021	
1	Ndërtim i rrjetit të KUZ, Blloku Drita Nr.1 dhe Drita Nr.2 dhe Lagjia e Re, qyteti Burrel	71,754,165	B. O.: óCô Sh.p.k dhe óKô Sh.p.k,	22,697,397	16,666,667	32,390,101
2	Rehabilitimi i Digës së Ujëmbledhësit Shoshaj	19,037,062	B. O.: óUô Sh.p.k dhe óNô Sh.p.k,	9,052,785	9,077,675	906,602
3	Ndërtim ujesjellesi per furnizimin me uje i qytetit Burrel, te fshatrave te Njesise Adm.Derjan dhe Rukaj, Loti I+II	557,546,953	B. O.: óEô Sh.p.k dhe óEô Sh.p.k,	111,505,575	100,000,000	346,041,378
TOTAL		648,338,180				379,338,081

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.15 Fonde të deleguara për vitin 2021 nga Ministria e linjës për investime si dhe likuidimi i tyre

Nr	Objekti i Prokurimit	Vlera kontratës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Likuiduar	Mbetur
				2021	
1	Rikonstrukson i godinave në pronësi të NJVV për strehim social	10,640,108	óRô Sh.p.k	4,822,225	5,817,883
2	Ndërtim ujesjellesi per furnizimin me uje i qytetit Burrel, te fshatrave te Njesise Adm.Derjan dhe Rukaj, Loti II	279,860,373	B. O.: óEô Sh.p.k dhe óEô Sh.p.k,	89,696,133	190,164,240
3	Ndërtim i rrjetit shpërndarës së qytetit të Burrel (Faza 1 + Faza II), Bashkia Mat	1,035,619,749	B. O.: óL-Oô Sh.p.k dhe óFô Sh.p.k,	374,192,428	661,427,321
TOTAL		1,326,120,230			857,409,444

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Kontratat nuk janë likuiduar sipas afateve të përcaktuara por në periudha të mëvonshme, kjo si rezultat i mos alokimit të fondeve nga ministritë e linjës dhe për pjesën e Bashkisë Mat nga mos realizmi i të ardhurave nga taksat/tarifat vendore.

-Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Mat dhe të shtrira në kohë sipas financimit e ndarë në tre vitet sipas shkresës përcjellëse nga Ministria e linjës. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

Konkluzion i përgjithshëm:

-Buxhetet e Bashkisë Mat dhe PBA, në përgjithësi janë miratuar në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore të ligjit të buxhetit për periudhën 01.01.2019 në 30.12.2021;

Kanë ndodhur ndryshime në buxhetet fillestare (shtesa/pakësimi), të cilat në çdo rast janë miratuar me VKB.

-Për PBA 2019-2021, 2020-2022 dhe 2021-2023 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxheteve vjetore, nuk administrohet dokumentacion mbi kërkesat për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Mat, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;

-Në PBA, si dhe buxhetet vjetore të vitit 2019 dhe 2021, nuk janë planifikuar fonde për investime në fondin pyjor.

-Në një rast është bërë rishpërndarje e fondeve buxhetore, përtej datës 15 nëntor të vitit buxhetor 2021, veprim i cili mund të ushtrohet deri në datën 15 nëntor.

-Për periudhën 2019-2021 në krahasim me planet vjetore respektive, realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik për 12-mujorin është mesatarisht në masën 91 %, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 604 óTransferta Korente të Brendshmeó, duke vijuar me transfertat për buxhetet familjare në masën ku përfshihet ndihma ekonomike dhe PAK, ndjekur nga shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, si dhe realizimin më të ulët e kanë shpenzimet për mallra e shërbime dhe shpenzime kapitale.

-Nga shqyrtimi i kontratave për investime të Bashkisë Mat, financuar nga Ministria e linjës, konstatohet se në 3 raste nga Bashkia Mat janë lidhur kontrata me vlerën e plotë të projektit ndërkohë që i është deleguar pjesërisht fondi nga ministria e linjës, duke ndërmarrë angazhime buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, si dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit buxhetor.

-Përgjatë periudhës 2020-2021 konstatohet se, Bashkia Mat ka ndërmarrë angazhime të reja buxhetore përtej datës 15 tetor, 5 angazhime me vlerë totale 32,323,128 lekë, duke hyrë në marrëdhënie kontraktuale me operator ekonomik, për kryerjen e punimeve publike të ndryshme.

-Referuar informacionit mbi detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2021, konstatohet se, ka një rritje të konsiderueshme të detyrimeve për investime, kjo pasi Bashkia Mat ka marrë angazhime buxhetore pa pasur fonde në dispozicion. *Në këto kushte, në gjykimin e grupit të auditimit, në kuptim të përcaktimit të bërë në pikën 1 në nenin 55 të Ligjit nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Bashkia Mat në fund të vitit 2021 paraqitet me probleme financiare.*

-Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit **30 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqëruar në Degën e Thesarit Mat, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 2019-2021, ky afat nuk është respektuar në 563 raste për vlerën 279,939,309 lekë.

Është konstatuar se jo në të gjitha rastet janë ndjekur hapat për realizimin e pagesave sipas afateve, megjithëse dokumentacioni që shoqëron pagesën është i plotë, pasi ka kontrata të cilat nuk paguhen në afat kjo për mungesë fondesh nga realizimi i të ardhurave, çelja e fondeve shtesë nga Ministria e Linjës etj (*trajtuar dhe në pjesë të veçanta*).

-Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: z.N. R, ish Kryetar i Bashkisë Mat, z.A. M Kryetar në detyrë i Bashkisë Mat, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z.D. Rr me funksion Drejtor Ekonomik, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, si dhe zj.D. K ish-Përgjegjëse e Sektorit të Financës deri në Gusht të vitit 2019.

2.2.6. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

Në zbatim të pikës II.2, nënpika 2.6, të programit të auditimit nr. 53/1, datë 21.06.2021, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1)Evidencat analitike të llogarive debitore për taksat dhe tarifat vendore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

- 2)Akt rakordimi me degën e thesarit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.
- 3)Evidencat e debitorëve për taksat dhe tarifat vendore për subjektet dhe për detyrimet familjare.
- 4)Të tjera dokumente për arkëtimin e detyrimeve për taksat e tarifat vendore.
- 5)Vendimet e Këshillit të Bashkisë për paketën fiskale.
- 6)Vendimet e Këshillit të Bashkisë për strukturën organike.

1.Përshkrimi i situatës.

Nën pika 2.2.6.Burimi krijimit të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe nxjerrja e detyrimeve tatimore e ndarë sipas viteve.

I.Struktura e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

Për periudhën 2019-2021, pranë Bashkisë Mat është krijuar dhe ka funksionuar Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, si një nga strukturat kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Mat nga taksat dhe tarifat. Ky sektor në aktivitetin e tij për arkëtimin e disa prej llojeve të të ardhurave bashkëpunon edhe me sektor të tjerë pranë Bashkisë, si ai i pronave, pyjeve, urbanistikës, infrastrukturës, ku roli i këtyre sektorëve është hartimi i autorizimit për arkëtim, si dhe roli i sektorit të taksave dhe tarifave vendore është hartimi i faturës për arkëtim, dokument i cili i shërben subjektit për kryerjen e pagesës, duke vijuar me ndjekjen e arkëtimit/marrjen e masave të nevojshme për ekzekutimin e pagesave/detyrimeve të krijuara.

Ky sektor përgjatë periudhës 2019-2021 ka pësuar 2 ndryshime në numër punonjësish dhe strukturë, konkretisht:

-Në vitin 2019 ñ 2 ndryshime (Sektori i Taksave dhe Tatimeve Vendore, ndahet në Sektorin e Taksave dhe Tatimeve Vendore dhe Sektorin e Taksës së Pronësisë), punonjës të punësuar mesatarisht 7-8. Për vitet në vijim nuk ka patur asnjë ndryshim.

Në tabelën më poshtë pasqyrohet informacioni për punonjësit e sektorit të mësipërm, si dhe lëvizjet e tyre në detyrë:

Nr.	Emër Mbiemer	Pozicioni	Date fillimi apo largimit, si dhe ndryshimi në detyrë		
			Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1	B. B	Përgjegjës Sektorit të Taksës	Vijon 22.04.2016-14.11.2019		
		Përgjegjës Sektorit Taksës së Pronës	Ndryshon detyrë 14.11.2019	Largohet(01.10.2020)	
2	E. B	Përgjegjës Sektorit të Taksës	Fillon 22.11.2019	Vijon	Vijon
3	S. R	Specialist i taksës	Vijon (23.05.2016)	Ndryshon detyrë 22.12.2020	
		Përgjegjës Sektorit të Taksës së Pronës		Fillon (22.12.2020)	Ndryshon detyrë 05.07.2021
		Përgj.Sek.Shërbim.Komunit.Nj.Admin.Derjan			Fillon 05.07.2021
4	J. K	Specialist i taksave	Vijon(10.02.2015)	Vijon	Ndryshon detyrë 05.07.2021
		Specialist kadastrës së tokës bujqësore Nj.Admin.Ulëz			Fillon 05.07.2021
5	E.Xh	Agjente tatimore		Fillon (21.09.2020)	Vijon
6	P. S	Agjent tatimor	Vijon(26.04.2017)	Vijon	Largohet(13.08.2021)
7	K. Sh	Specialist i taksave		Fillon(23.12.2020)	Vijon
8	O.H	Specialist i taksave	Fillon(23.12.2019)	Vijon	Vijon
9	R. N	Specialist i taksës së pronës		Fillon(15.05.2020)	Vijon
10	Y. R	Specialist i taksës së pronës		Fillon(04.08.2020)	Vijon

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

II.Taksat dhe Tarifat e aplikuara dhe arkëtuara nga Bashkia Mat.

Paketat fiskale të Bashkisë Mat janë miratuar me VKB nr.1, datë 04.01.2019, VKB nr.54, datë 24.12.2019 dhe VKB nr.137, datë 22.12.2020, si dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresat nr.1842/1 prot., datë 30.12.2019 dhe nr.1881/1 prot., datë 28.12.2020.

Mbështetur në paketat fiskale të mësipërme në Bashkinë Mat, sipas sektorëve përkatës, janë aplikuar këto taksa dhe tarifa:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Lloji i Taksës/Tarifës	2019	2020	2021
Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin	x	x	x
Takse e Zenis se Hapsires Publike	x	x	x
Takse Reklame	x	x	x
Takse Tabele	x	x	x
Tarife Sherbimi (Pastrim Gjelbrim)	x	x	x
Takse Fjetje ne Hotel	x	x	x
Takse e perk.Venodre per infras.arsimore		x	x
Tarife Shkollimi		x	x
Tarife ndricimi	x	x	x
Tarife vendore (vertetime)	x	x	x
Tatim mbi Ndertesen	x	x	x
Takse Trualli	x	x	x
Takse mbi Token Token Bujqesore	x	x	x
Tarife Leje Transporti	x	x	x
Tarife Vendore per leje shfrytezimi karburant (licensim Karburanti / Gazit)	x	x	x
Parkimi	x	x	x
Takse mbi Ndikimin ne Infrastrukture	x	x	x
Tarife per Leje Ndertimi		x	x
Te Tjera Tarifa Administrative (Raste Perjashtimore)	x	x	x
Tarife Vendore nga hidrocentrali uJOR			
Takse per Therje Bagetie	x		
Tarife per Ujin Vadites	x	x	x
Sherbimi Zjarrëfikses	x	x	x
Takse Nacionale e Rregjistrimit te Automjeteve	x	x	x
Takse e Rentes Minerare	x	x	x
Takse e Perkohshme	x	x	x
Takse Rregjistrimi Vendbanimi I Ri	x	x	
Takse mbi kalimin e se drejtes se Pronesise	x	x	x
Takse Pulle	x	x	x
Nr.Gjithësej	25	27	26

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Pra sipas tabelës së mësipërme nga Bashkia Mat për vitin 2019 janë aplikuar/mbledhur 25 lloje taksash dhe tarifash, për vitin 2020 në 27, si dhe për vitin 2021 në 26 lloje.

Për periudhën 2019-2021 subjektet mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Mat dhe Njësitë Administrative, ndahen në 3 kategori:

1.Biznes;

2.Familjar;

3.Institucione.

Kategoritë e mësipërme (përfshirë institucionet) ndahen në disa nënkategoritë për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:

-Kategoria e parë ndahet në Biznesin Vip; Biznesin e Madh; Biznesin e Vogël; Tregtarët Ambulant.

-Kategoria e dytë për efekt të taksave/tarifave ndahet në familje që kanë në pronësi/përdorim banesa private, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid.

Tabela nr.16 Llojet e subjekteve mbi të cilët janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore, si dhe numri i tyre

Nr	Lloji	2019	2020	2021
1	Biznesi Vip	15	16	20
2	Biznesi i Madh	134	134	134



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

3	Biznesi i Vogël	550	516	525
4	Ambulant	34	-	34
5	Institucione	29	34	38
6	Familje	11000	11000	11000
	Total	11762	11700	11751

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Veç taksave dhe tarifave të mësipërme Bashkia Mat ka planifikuar dhe arkëtuar të ardhura nga disa lloje burimesh të ndryshme, si gjoba nga inspektorati i mbrojtjes së territorit, policia bashkiake, qira tokë bujqësore, pyjore, truall, ndërtesë, tregu industrial, lënda drusore etj.

-Të gjitha sa më sipër, mbi planifikimin dhe realizimin e tyre për periudhën 2019-2021, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

	LLOJI I TAKSES	Plani 2019	Fakt 2019	Në %	Plani 2020	Fakt 2020	Në %	Plan. 2021	Fakt 2021	Në %
I	Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore									
	Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin	2,500	518	21%	2,500	335	13%	-	862	
	Takse e Zenis se Hapsires Publike	-	1,175		1,000	2,398	240%	1,500	3,562	237%
	Takse Reklame	704	649	92%	704	1,076	153%	718	848	118%
	Takse Tabele	135	333	247%	135	184	136%	138	149	108%
	Tarife Sherbimi (Pastrim Gjellbrim)	14,484	20,647	143%	16,984	30,922	182%	22,020	31,090	141%
	Takse Fjetje ne Hotel	133	-	0%	133	-	0%	136	-	0%
	Takse e perk.Venodre per infras.arsimore				6,400	1,796	28%	6,528	1,984	30%
	Tarife Shkollimi				-	96		-	90	
	Tarife ndricimi	674	1,227	182%	674	1,571	233%	1,000	1,552	155%
	Tarife vendore (vertetime)	-	10		1,000	5	1%	1,530	128	8%
	Takse vendore per regj biznesi	-	-	-	-	-	-	-	3	
II	Sekt.Takse se Prones (Kadastra Fiskale)									
	Tatim mbi Ndertesen	10,510	11,314	108%	10,510	14,647	139%	10,720	13,671	128%
	Takse Trualli	51	1,500	2.9	151	1,636	1083%	954	1,607	168%
	Takse mbi Token Token Bujqesore	3,499	312	9%	840	846	101%	858	537	63%
III	Sek.Mbrojtjes Civile dhe Pronave									
	Te ardhura nga Privatizimi I Banesave	1,400	867	62%	1,700	3,748	220%	1,734	2,394	138%
	Te ardhura nga Qera Nderitim Objekti	2,400	316	13%	2,500	375	15%	2,550	395	15%
	Te ardhura nga Qira dhe Troje	5,300	1,237	23%	4,500	1,237	27%	4,590	1,031	22%
IV	Sek.Infrastrukture									
	Tarife Leje Transporti	1,000	517	52%	1,150	490	43%	1,173	236	20%
	Tarife Vendore per leje shfrytezimi karburant (licensim Karburanti / Gazit)	-	800		5,200	2,100	40%	5,304	600	11%
	Te ardhura nga Parkingu	1,000	450	45%	1,300	879	68%	16,926	439	3%
V	Sek.Arsimit, Kurtures dhe Sporteve									
	Te ardhura nga Kopshtet	3,500	3,643	104%	4,367	1,971	45%	4,454	3,088	69%
	Te ardhura nga Çerdhet	1,500	1,313	88%	1,739	983	57%	1,773	1,211	68%
	Te ardhura nga Qend.Form.Profesional(konvikti)	368	173	47%	295	92	31%	301	43	14%
	Sherbime te kultures e sportit	1,500	284	19%	1,268	214	17%	1,293	151	12%
	Te ardhura nga Veprimtari te Ndryshme(Muzeu)	350	-	0%	6	-	0%	6	-	0%
	Tarife Sherbimi per licensat radiotelevizive	-	-		-	-		-	1	
VI	Sek.Urbanistikes									
	Takse mbi Ndikimin ne Infrastukture	3,500	8,496	243%	10,000	3,170	32%	8,400	5,109	61%
	Tarife per Leje Ndertimi	-	-		1,000	20	2%	1,020	100	10%
	Te Tjera Tarifa Administrative (Raste Perjashtimore)	-	-		1,000	-	0%	1,122	370	33%
VII	Drejtoria e Bujqesise									



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

	Shfrytezimi i Lendeve Drusore	11,000	366	3%	4,500	1,227	27%	3,777	952	25%
	Te ardhura nga Nd.ne	-	1,100		7,000	-	0%	6,640	-	0%
	Pronesi (Antena+Gurore+Miniera)	-	3,822		-	3,918		-	4,596	
	Tarife Vendore nga hidrocentrali ujqor	230	-	0%	-	-		-	-	
	Takse per Therje Bagetie	-	-		-	-		-	2	
	Tarif Leje Mjedisore	3,500	18	1%	-	293		500	517	103%
	Tarife per Ujqin Vadites	-	-		-	-		-	-	
	Tarife Vendore									
VIII	Drejtoria Emerqjenca Civile / Sekt.MNZ									
	Te ardhura Pro.Mir.MNZ	-	-		-	-		-	-	
	Te ardhura nga Sherbimi MNZ	-	229		300	458	153%	306	130	42%
IX	Te Ardhura nga Institucione Te tjera									
	Takse Nacionale e Rregjistrimit te Automjeteve	6,491	7,479	115%	6,491	10,155	156%	6,621	11,385	172%
	Takse e Rentes Minerare	500	53	11%	1,000	42	4%	1,020	17	2%
	Takse e Perkoshme	500	-	0%	500	1	0%	-	73	
	Te ardhura nga analiza kimike dhe biologjike	-	-		-	-		-	4	
	Takse Rregjistrimi Vendbanimi I Ri	100	-	0%	100	-	0%	-	-	
	Takse mbi kalimin e se drejtes se Pronesise	120	-	0%	120	-	0%	122	-	0%
	Te Tjera Gjeba IMT	-	-		-	-		432	566	131%
	Gjeba policie bashkiake	428	65	15%	424	364	86%	-	107	
	Te Ardhura nga TAP	-	-		700	5,536	791%	5,154	7,296	142%
		-	-		-	-		-	-	
	TOTALI (I-IX)	77,377	68,913	89%	98,191	92,785	94%	121,320	96,896	80%

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Për vitin 2019, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 77,377 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 68,913 mijëlekë ose 89%.

-Për vitin 2020, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 98,191 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 92,785 mijëlekë ose 94%.

-Për vitin 2021, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 121,320 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 96,896 mijëlekë ose 80%.

-Theksojmë se, në disa lloje taksash/tarifash ka realizim më shumë se planifikimi, për arsye se gjatë vitit janë arkëtuar edhe detyrime për taksa/tarifa të prapambetura, si edhe në raste të caktuara për disa lloje taksash/tarifash nuk planifikohet vlerë për t'u arkëtuar, megjithëse gjatë vitit kanë ndodhur arkëtime.

Konkretisht në vitin 2019, nuk është planifikuar arkëtimi i taksës së zënies së hapësirës publike, tarifa e licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburantit, shërbimi i zjarrëfikses; Në vitin 2020 nuk është planifikuar arkëtimi i tarifës së shkollimit dhe tarifa për ujqin vaditës; Në vitin 2021 nuk është planifikuar arkëtimi i tarifës së shkollimit dhe tarifa vendore për hidrocentralin ujqor.

III. Debitorët sipas kategorive të tyre.

III.1. Biznesi dhe Institucionet

Titulli gjetjes: Debitorët obizneso të cilët nuk kanë likujduar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore, si dhe masat shtrënguese për arkëtimin e detyrimeve përkatëse.

Situata: Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, ecuria e debitorëve përgjatë periudhës 2019-2021, për tarifën e shërbimit, ndriçimit,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

taksën e ndërtesës, truallit, reklamës, tabelës, zënies së hapësirës publike, infrastrukturës arsimore, në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet si më poshtë.

Tabela nr.17 Debitor (Biznesi dhe Institucione)

Nr	Lloji	Debitor progresive 31.12.2019		Debitor progresive 31.12.2020		Debitor progresive 31.12.2021	
		Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë
1	Biznesi Vip	5	5,336,720	7	4,617,193	5	5,114,318
2	Biznesi i Madh	52	12,269,668	60	11,938,465	59	13,890,241
3	Biznesi i Vogël	242	13,050,726	250	28,334,009	273	16,659,480
4	Lojra Fati	9	680,355	9	701,435	10	722,515
5	Kompani Sigurimesh	2	50,736	2	106,236	2	60,500
6	Tregu Industrial (Ambulant)	29	447,000	29	447,000	46	1,053,335
7	Institucione	15	514,000	23	1,644,100	30	2,319,000
	TOTAL	354	32,349,205	380	47,788,438	425	39,819,389

Burimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme vihet re se nga viti 2019 në vitin 2021 kemi një rritje të debitorëve në numër dhe vlerë, konkretisht 71 debitorë / 7,470,184 lekë më tepër. Në vitin 2020 vlera debitorësh është më e lartë krahasuar me dy vitet e tjera, për arsye edhe të situatës së krijuar prej Pandemisë COVID-19, si rrjedhojë e të cilës përgjatë periudhave të ndryshme të vitit subjektet nuk kanë ushtruar aktivitetet.

Sa më sipër, konstatohet se në fund të vitit 2021 në Bashkinë Mat dhe NJA, janë debitor 425¹¹ subjekte në vlerën 39,819,389 lekë, e ndarë si më poshtë vijon:

-5 subjekte óBiznesi Vipó debitor në vlerën 5,114,318 lekë

-59 subjekte óBiznesi i Madhó në vlerën 13,890,241 lekë

-273 subjekte óBiznesi i Vogëló në vlerën 16,659,480 lekë

-10 subjekte óLojra Fatió në vlerën 722,515 lekë

-2 subjekte óKompani sigurimeshó në vlerën 60,500 lekë

-46 subjekte óTregtar Ambulantó në vlerën 1,053,335 lekë

-30 subjekte óInstitucioneó në vlerën 2,319,000 lekë.

-Për debitorët e krijuar më sipër, konstatohet se, nuk është aplikuar kamatëvonesë rast pas rasti, për mos likuidim të detyrimit tatimor.

-Për vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, nga bizneset, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifa Vendore, janë dërguar njoftim detyrimet për subjektet debitorë dhe më pas janë dërguar disa shkresa për bllokimin e llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë, barrë hipotekore në pasuritë e paluajtshme në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës/Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, por nuk ka pasur mbulim të mjaftueshëm në krahasim me numrin e debitorëve të rezultuar brenda vitit, pasqyruar në tabelën më poshtë:

Tabela nr.18 Masat Shtrënguese

Ndikimi i aplikimit të mjeteve ligjore	Viti 2019		Nr debitorësh (biznes dhe institucione)	Mbuluar	Viti 2020		Nr debitorësh (biznes dhe institucione)	Mbuluar	Viti 2021		Nr debitorësh (biznes dhe institucione)	Mbuluar
	Nr.i masave	Borxhi i mbledhur në lek			Nr.i masave	Borxhi i mbledhur në lek			Nr.i masave	Borxhi i mbledhur në lek		
Përmasa njoftimit për pagesën			354	79%			380	70%			429	35%
Njoftim dhe Kerkese per Pagese Debie	278	126,478			266	53,005,027			150	5,888,078		

¹¹(Lista analitike e biznesit dhe institucioneve, të cilët rezultojnë debitor në fund të vitit 2021, është pasqyruar në tabelën nr.4 Kapitullin Aneks)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Njoftim për vendosje të masave siguruese	-	-			-	-						
Përmasa masave shtënguese												
Blokime të llogarive bankare	278	-			266	53,005,027						
Vendosje të barrës hipotekore në Kadastër	30	-			-	-						
Vendosje të barrës siguruese në DPSHTTR	30	-			-	-						
Vendosje të barrës ndaj titujve në QKB	-	-			-	-						
Përmasa masave ekzekutuese												
Urdh-ekezuksioni kalim shumë nga llog e tatimpaguesve në llogari Bashkis Mat	-	-			-	-			10	-		
Totali i mbledhur	2	126,478			254	53,005,027			50	5,888,078		
Planifikimi vjetor për mbledhjen e borxhit	-	-			-	-						

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Pra siç shihet nga tabela e mësipërme, rezulton se Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2019 ka arritur të mbulojë me masa shtënguese 79% të debitorëve të biznesit, për vitin 2020 ka mbuluar 70%, si dhe për vitin 2021 ka mbuluar 35%.

Për më tej nuk është vazhduar për marrjen e masave të tjera shtënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit, sekuestron e mallrave të debitorëve deri në kallëzim penal.

Kriteri: Neni 76, neni 114, i Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në RSH, i ndryshuar;

-Pikat 1, 2 në nenin 4, neni 9, pikat 1 dhe 2 në nenin 20, pika 1 në nenin 22, neni 22/5, nenin 24, shkronjën ócô të pikës 3 në nenin 27, neni 34 dhe neni 35 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për sistemin e Taksave Vendore, i ndryshuar;

-Pikën 1.3 në pikën 1 në nenin 9, pikën 2 në nenin 27, neni 35, neni 64 në Ligjin nr.139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore, i ndryshuar;

-Shkronjën óaô të nenit 5, pikën 2 të nenit 7, pikën 1 të nenit 12, nenin 14, neni 40, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 për financat e Vetëqeverisjes Vendore;

-VKB nr.1, datë 04.01.2019, VKB nr.54, datë 24.12.2019 dhe VKB nr.137, datë 22.12.2020 për miratimin e paketave fiskale 2019-2021;

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës, si dhe nivel i ulët i ndërgjegjësimit të bizneseve për likuidimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore.

Efekt: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën 39,819,389 lekë.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë Mat, me qëllim përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët (bllokim të llogarive bankare, njoftim të Drejtorisë Rajonale të Transportit për vendosje të barrës siguruese për mjetet dhe në ASHK për pasuritë e paluajtshme, etj) për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, në vlerën 39,819,389 lekë.

III.2.Familjet.

Titulli i gjetjes: Debitorët ófamiljarô të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifat



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

vendore, si dhe puna e pamjaftueshme e agjentit tatimor UK Sha Mat.

Situata: Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet ecuria e debitorëve familjar për tarifën e shërbimit (gjelbërim, pastrim), ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, si dhe tarifën e infrastrukturës arsimore:

Tabela nr.19 Numër familje debitoare sipas NJA, të cilat rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa

Nr	NJA	2019			2020			2021		
		Familje gjithësej të taksuara dhe tarifuara	Familje Debitore	Në %	Familje gjithësej të taksuara dhe tarifuara	Familje Debitore	Në %	Familje gjithësej të taksuara dhe tarifuara	Familje Debitore	Në %
		Nr	Nr		Nr	Nr		Nr	Nr	
1	Burrel	5238	4176	80%	5253	3119	59%	5254	4911	93%
2	Derjan, Macukull	965	882	91%	960	838	87%	960	927	97%
3	Ulëz	560	508	91%	559	339	61%	559	510	91%
4	Rukaj	939	880	94%	934	919	98%	934	918	98%
5	Lis	1279	1205	94%	1269	898	71%	1269	1244	98%
6	Komsi	1373	1234	90%	1369	1120	82%	1369	1346	98%
7	Baz	849	811	96%	866	538	62%	866	859	99%
	TOTAL	11203	9696	87%	11210	7771	69%	11211	10715	96%

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se numri i familjeve debitoare në mënyrë të grupuar, ndarë sipas Njësi Administrative, në fund të vitit 2021 është:

-4911 familje nga 5238 gjithësej të taksuara për Qytetin e Burrelit, ose 93% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa, ose ndryshe vetëm 7% e familjeve i kanë likujduar plotësisht detyrimet për taksat/tarifat vendore;

-927 familje nga 960 gjithësej të taksuara për NJA Derjan-Macukull, ose 97% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;

-510 familje nga 559 gjithësej të taksuara për NJA Ulëz, ose 91% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa, ose ndryshe vetëm 9% e familjeve i kanë likujduar plotësisht detyrimet për taksat/tarifat vendore;

-918 familje nga 934 gjithësej të taksuara për NJA Rukaj, ose 98% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;

-1244 familje nga 1269 gjithësej të taksuara për NJA Lis, ose 98% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;

-1346 familje nga 1369 gjithësej të taksuara për NJA Komsi, ose 98% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;

-859 familje nga 866 gjithësej të taksuara për NJA Baz, ose 99% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa.

Tabela nr.19 Numër familjesh debitoare sipas llojit të taksës/tarifës

Nr	Familjar	Bashki Mat dhe NJA Debitor 31.12.2019		Bashki Mat dhe NJA Debitor 31.12.2020		Bashki Mat dhe NJA Debitor 31.12.2021		TOTAL
		Nr debitor/Taksë ose Tarifë	Vlerë	Nr debitor/Taksë ose Tarifë	Vlerë	Nr debitor/Taksë ose Tarifë	Vlerë	
1	Tarifë Ndricimi	4316	420,350	3,223	644,372	5,094	1,018,800	
2	Tarifë Shërbimi	7707	8,483,533	7,749	9,633,050	10,676	13,578,900	
3	Taksë Ndërtese	8765	8,087,976	6,810	6,183,782	9,323	8,692,984	
4	Taksë Trualli	5119	432,222	4,426	363,067	5,351	460,480	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

5	Tarifë Arsimi	-	-	7,740	2,321,700	10,666	3,199,800	
	TOTAL	25,907	17,424,081	29,948	19,145,971	41,110	26,950,964	36,597,002

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sqarojmë se vlerat 25,907; 29,948 dhe 41,110 sipas viteve, përfaqësojnë numrin total të debitorëve sipas llojit të taksës/tarifës vendore, që do të thotë se një familje është debitore në një apo disa taksa/tarifa vendore.

Referuar tabelës së mësipërme, konstatohet se në fund të vitit 2021 në Bashkinë Mat dhe NJA, vlera debitore për taksat dhe tarifat për familjarët është 36,597,002 lekë:

-5,094 familje debitore nga 11211 gjithësej, në vlerën 1,018,800 lekë për **tarifën e ndriçimit**;

-10,676 familje debitore nga 11211 gjithësej, në vlerën 13,578,900 lekë për **tarifën e shërbimit** (pastrim, gjelbërim, dekor);

-9323 familje debitore nga 11211 gjithësej, në vlerën 8,692,984 lekë për **taksën e ndërtesës**;

-5351 familje debitore nga 11211 gjithësej, në vlerën 460,480 lekë për **taksën e truallit**;

-10,666 familje debitore nga 11211 gjithësej, në vlerën 3,199,800 lekë, për **tarifën e infrastrukturës arsimore**.

Kriteri: Neni 5, neni 8, neni 11 dhe neni 19 në VKB nr.1, datë 04.01.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2019;

Neni 5, neni 8, neni 11 dhe neni 19 në VKB nr.54, datë 24.12.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2020;

Neni 4, neni 6, neni 8 dhe neni 17 në VKB nr.137, datë 22.12.2020 për miratimin e paketave fiskale 2019-2021;

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën 36,597,002 lekë.

Shkaku: Nga UK sha Mat nuk janë marrë masa për arkëtimin e vlerës debitore, si dhe nga Bashkia Mat nuk është marrë masë për gjobitjen në masën 50% të vlerës së pa arkëtuar të agentit tatimor UK sha.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat të marrë masat e nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar si pasojë e detyrimeve të krijuara nga puna e dobët e UK ShA., Mat (në rolin e agentit tatimor) për taksat dhe tarifat vendore nga abonentët familjarë, me qëllim marrjen e përgjegjësisë ligjore nga palët dhe shmangien e veprimeve abuzive në mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifat vendore si edhe të përditësohet regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 36,597,002 lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

III.3. Familje debitore për taksën e tokës bujqësore.

Titulli i Gjetjes: Keqmenaxhim mbi procedurat e ndjekura të planifikimit, arkëtimin të taksës së tokës bujqësore.

Situata:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Tabela nr.20 Debitor për taksën bujqësore 2019-2021

N.J.A.	Debitorë 31.12.2019 (Lekë)				Debitorë 31.12.2020 (Lekë)				Debitorë 31.12.2021 (Lekë)				TOTAL Lekë
	Familje me tokë bujqësore	Sip (m2)	Maturimi	Debia	Familje me tokë bujqësore	Sip (m2)	Maturimi	Debia	Familje me tokë bujqësore	Sip (m2)	Maturimi	Debia	
Burrel	5062	1,078,624	100,512	75,560	5,059	1,051,985	93,470	43,918	5,052	1,098,505	95,287	53,338	
Derj Macukull	965	1,053,079	93,576	65,650	960	1,052,754	91,042	80,130	960	1,052,754	90,935	81,613	
Ulez	560	274,114	23,985	10,797	557	273,814	23,978	10,609	557	273,814	23,978	10,197	
Rukaj	942	811,966	72,536	50,656	934	810,006	70,401	69,624	934	810,006	70,401	68,940	
Lis	1272	1,833,914	158,542	138,247	1,264	1,841,932	156,986	101,793	1,264	1,849,982	155,816	103,594	
Komsi	1,373	3,770,732	325,052	231,975	1,361	3,731,020	306,448	249,307	1,361	3,741,420	304,036	147,650	
Baz	857	185,347	165,241	139,012	861	1,850,826	167,597	98,536	860	1,850,876	166,780	102,057	
Total	11,031	9,007,776	939,444	711,897	10,996	10,612,337	909,922	653,917	10,988	10,677,357	907,233	567,389	1,933,203

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Referuar tabelës së mësipërme rezulton se vlera debitore gjithësej për taksën e tokës bujqësore, krijuar përgjatë periudhës 2019-2021 është **1,933,203 lekë**. Thëkssojmë se, sipërfaqja e mësipërme e tokës bujqësore të taksuar, është bërë mbi bazën e vetëdeklarimeve të familjeve që përdorin tokë bujqësore, si dhe jo të jenë bërë verifikime me qëllim sigurimin e të dhënave dhe krijimin e kadastrës vendore të tokës bujqësore, detyrë e Specialistit të Kadastrës dhe Menaxhimit të Tokës.

Mangësi konstatohen edhe në organizimin e strukturave për ndjekjen e kësaj takse, mos përditësimi i regjistrave të familjeve fermere që disponojnë toke si dhe niveli i ulët i realizimit të taksës së tokës bujqësore, duke u evidentuar një numri i madh i familjeve debitore në vlera të konsiderueshme debitore.

Regjistrat nuk janë të përditësuar sipas ndryshimeve të bëra vit pas viti në kadastrë për tokat në disponim dhe përdorim. Nuk janë bërë njoftim detyrime për të gjithë fermerët e evidentuar në regjistrat, pasi faturimet dhe arkëtimet janë kryer vetëm në rastet, kur fermerët janë paraqitur pranë Bashkisë.

Kriteri: Neni 10 në VKB nr.1, datë 04.01.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2019;

Neni 10 në VKB nr.54, datë 24.12.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2020;

Neni 7 në VKB nr.137, datë 22.12.2020 për miratimin e paketave fiskale 2019-2021;

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara në vlerën **1,933,203 lekë**.

Shkaku: Keqmenaxhim dhe mos marrja e masave për ndjekjen e debitorëve nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Tokës, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrat të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse dhe verifikimit në terren.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të nxjerrë njoftim detyrimin për familjet, si dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **1,933,203 lekë**.

III.4 Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale (banim ose e kombinuar), objekt legalizimi.

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

dërguara nga zyra e vendore e ASHK Mat, u auditua i gjithë dokumentacioni për periudhën e vitit 2019-2021, i paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit. Në Bashkinë Mat deri në 31.12.2021, disponohen shkresat përcjellëse dhe listat me emrat përkatës që ju janë miratuar Lejet e Legalizimit për ndërtimet pa leje ndërtimi brenda territorit të Bashkisë Mat. Nga ZVASHK Mat, janë dërguar dokumentet për çdo person që ka ndërtuar objekt banimi apo social ekonomik në territorin e Njësi Administrative të Bashkisë Mat, ku përcaktohet edhe detyrimi për të paguar vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Bashkia Mat, nuk janë marrë masa të veçanta për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ZVASHK Mat. Në vijim paraqiten pasqyra e personave të cilët janë pajisur me Leje Legalizimi, sipërfaqet ndërtimore sipas objekteve, funksioni, vendndodhja e objektit, sipërfaqja e objektit, detyrimi sipas personave që duhet të paguanin, për periudhën 2019, 2020 dhe 2021, sipas tabelës përmbledhëse më poshtë (analitikisht pasqyruar në tabelën nr.5 në Kapitullin 6 Aneksë):

Tabela nr.21 Detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për lejet e legalizimit

Viti	Nr. subjekte debitor TNI	Vlera e detyrimit
2019	66	2,154,475
2020	5	308,368
2021	10	263,659
Total	81	2,726,502

Titulli i Gjetjes:Procedurat e ndjekura për arkëtimin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtimeve informale që ndodhen në territorin e Bashkisë Mat.

Situata:Bazuar në të dhënat e marra nga Bashkia Mat u konstatua se, nuk janë marrë masa për vjeljen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje ndërtimi, të pajisura me leje legalizimi nga ZVASHK Mat konkretisht:

Për vitin 2019 në vlera debitoare është **2,154,475 lekë**;

Për vitin 2020 - vlera debitoare është **308,368 lekë**;

Për vitin 2021 - vlera debitoare është **263,659 lekë**;

Progresive për periudhën 2019-2021 në vlera debitoare është **2,726,502 lekë**, e cila përfaqëson të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat. Në numër personash të cilët posedojnë lejen e legalizimit dhe që nuk kanë shlyer detyrimin e taksës vendore të ndikimit në infrastrukturë është 81 posedues, ose 44% e totalit të poseduesve të lejeve të legalizimit. Për debitorët e mësipërm nuk janë marrë masat e nevojshme të përcaktuara në nenet 90-91 në Kreun XI të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. Theksojmë se nga sektori i urbanistikës janë bërë njoftimet për pagesën e taksës, por në vijimësi nga sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk janë marrë të gjitha masat për arkëtimin e kësaj takse.

Kriteri:Neni 13 në VKB nr.1, datë 04.01.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2019;

Neni 13 në VKB nr.54, datë 24.12.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2020;

Neni 10 në VKB nr.137, datë 22.12.2020 për miratimin e paketave fiskale 2019-2021;

Ndikimi/Efekti:Të ardhura të munguara në vlerën **2,726,502 lekë**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Shkaku: Mungesa e marrjes së masave shtrënguese për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 2,726,502 lekë, për legalizimin e objekteve informale.

Në mënyrë të përmbledhur vlera e detyrimit tatimor, për taksa dhe tarifa (gjelbërim, pastrim, dekor, ndriçim, ndërtesë, truall, ndikim në infrastrukturë, reklama, tabelë, zënie të hapësirës publike, infrastrukturë arsimore, tregtim karburanti) të vlerësuara dhe njoftuara/faturuara për pagesë, në mënyrë progresive deri më datë 31.12.2021 është në vlerën 83,146,096 lekë nga të cilat:

-4 subjekte të tregtimit të karburantit në vlerën 2,070,000 lekë;

-425 subjekte (Biznes dhe Institucione) në vlerën 39,819,389 lekë;

-10715 familje në vlerën 38,530,205 lekë (shërbim, ndriçim, ndërtesë, truall, arsim, tokë bujqësore);

-78 subjekte për taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtesave informale në vlerën 3,077,803 lekë;

V.Debitor nga gjoba të vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit dhe Policia Bashkiake.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton në fund të vitit 2021 nga gjobat e vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, të cilat janë në formë të prerë dhe që nuk pengohet ekzekutimi i tyre, janë 5 gjoba në vlerën 4,016,922 lekë, si dhe nga Policia Bashkiake janë vendosur 764 gjoba në vlerën 806,000 lekë, nga të cilat nuk janë paguar 434 gjoba në vlerën 459,820 lekë.

Tabela nr.23 Gjocat e IMT

Nr.	Subjekti	Vendimi i gjobës	Statusi Juridik	Vlera e detyrimit
1	D. K	Nr.26, datë 08.01.2020	Në fuqi	500,000
2	I. Xh	Nr.27, datë 08.05.2020	Në fuqi	100,000
3	V Sh.p.k	Nr.29, datë 09.07.2021	Në fuqi	3,223,809
4	M .K	Nr.30, datë 03.09.2021	Në fuqi	104,794
5	F. M	Nr.33, datë 01.10.2021	Në fuqi	88,319
	Total			4,016,922

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.24 Gjocat e Policisë Bashkiake

Gjoha Policia Bashkiake		Nr	Vlerë	Paguar	Debi Nr.	Debi vlerë
Viti	2019	57	59,000	22,240	37	36,760
Viti	2020	391	426,000	204,000	203	222,000
Viti	2021	316	321,000	119,940	194	201,060
	Total	764	806,000	346,180	434	459,820

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Titulli i Gjetjes: Procedurat e ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV dhe Policia Bashkiake.

Situata: Konstatohet se për gjobat e vendosura nga IMTV të formës së prerë, nga Kryeinspektori i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit nuk është bërë kërkesë në gjykatën përkatëse për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

lëshimin e urdhrin të ekzekutimit të tyre. Gjithashtu kjo situatë konstatohet edhe për gjobat e vendosura nga policia bashkiake.

Kriteri: Pika 4 e nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 óPër kundërvajtjet administrativeó;

Nenet 164 dhe 165 të Ligjit nr.44/2015 óKodi i Procedurës Administrative në RSHó;

Neni 14 në Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 óPër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeó, i ndryshuar;

Neni 13 në Ligjin nr.8224, datë 15.5.1997 óPër organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunësó, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara në vlerën **4,476,742 lekë**.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandim: Titullari i Bashkisë Mat në bashkëpunim me drejtuesit e sektorëve të mësipërm, të marrin masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës **4,476,742 lekë**, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

Titulli i Gjetjes: Përlllogaritje të gabuara/përrjashtim nga taksa e ndërtesës dhe tarifës së shërbimit të disa bizneseve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë Mat.

Situata: Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, kryqëzimi i të dhënave me kontratat e qirasë për sipërfaqet pyjore, ekstraktet e regjistrimit të subjekteve në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Licencimet e Entit Rregullator të Energjisë për subjektet me aktivitet prodhim tregtim të energjisë elektrike, u përzgjedhën në mënyrë rastësore përlllogaritjet e bëra në Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, për taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimeve (pastrim, gjelbërim, ndriçim) për subjektet óBiznesi Vipó, óBiznesi i Madhó dhe óBiznesi i Vogëló.

Nga ky vlerësim u konstatua se, për periudhën 2019-2021 janë përrjashtuar/përlllogaritur gabim taksa e ndërtesës dhe tarifa e shërbimit për subjektet e mësipërme, konkretisht: Për taksën e ndërtesës 10 subjekte óbiznes i madhó, 40 subjekte óbiznes i vogëló dhe 6 subjekte me aktivitet HEC; Për tarifën e shërbimit 42 subjekte óbiznes i madhó dhe 10 subjekte me aktivitet HEC, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën **15,148,685 lekë** të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat¹².

Kriteri: Neni 5 dhe neni 20 në VKB nr.1, datë 04.01.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2019;

Neni 5 dhe neni 20 në VKB nr.54, datë 24.12.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2020;

Neni 4 dhe neni 18 në VKB nr.137, datë 22.12.2020 për miratimin e paketave fiskale 2019-2021;

Ndikimi/efekti: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën 15,148,685 lekë.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat e nevojshme, duke vlerësuar dokumentacioni (kontrat qiraje, dokument pronësie, leje ndërtimi, etj), duke kryer

¹²Përlllogaritjet sipas llojit të taksës/tarifës dhe kategorisë së biznesit, pasqyrohen në tabelat nr.6-11 në Kapitullin Aneksë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

verifikimet në terren për subjektet e mësipërme, si dhe në vijim, njoftimin për vlerësimin e detyrimit tatimor, si dhe ndjekjen etë gjithë procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës 15,148,685 lekë.

Konkluzion i përgjithshëm.

Përgjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2021 Bashkia Mat ka treguar një performancë të dobët në vlerësimin dhe marrjen e masave të nevojshme për arkëtimin e detyrimeve nga taksat dhe tarifatat vendore, si dhe nga gjobat e vendosura, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën 103,406,823 lekë për buxhetin e Bashkisë, e ndarë si vijon:

-Borxhi tatimor, për taksa dhe tarifa (gjelbërim, pastrim, dekor, ndriçim, ndërtesë, truall, ndikim në infrastrukturë, reklama, tabelë, zënie të hapësirës publike, infrastrukturë arsimore, tregtim karburanti) në vlerën **83,146,096 lekë**;

-Gjoha nga IMT dhe Policia Bashkiake Mat në vlerën **4,476,742 lekë**;

-Përllogaritje të gabuara/përrjashtuar nga taksa e ndërtesës dhe tarifa e shërbimit në vlerën **15,283,985 lekë**.

Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar në krye të herës, llojin e mangësive të identifikuar si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, ngarkohen me përgjegjësi:

1.Z.N.R, ish Kryetar i Bashkisë Mat për periudhën 01.01.2019-01.08.2019;

2.Z.A.M, Kryetari në detyrë i Bashkisë Mat;

3.Z.B.B, ish Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave për periudhën 22.04.2016-14.11.2019;

4.Z.E.B, ish Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave për periudhën 22.11.2019-21.01.2022;

5.Z.S.R, ish Specialist i Sektorit të Taksave për periudhën 23.05.2016-22.12.2020, aktualisht Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit NJA Derjan;

6.Z.J.K, ish Specialist i Sektorit të Taksave për periudhën 10.02.2015-05.07.2021, aktualisht Specialist i Kadastrës së Tokës NJA Ulëz;

7.Z.K. Sh, Specialist i Taksave për periudhën 23.12.2020 dhe në vijim;

8.Z.O.H, Specialist i Taksave për periudhën 23.12.2019 dhe në vijim;

9.Z.P.S, në rolin e ish Agjentit Tatimor për periudhën 26.04.2017-13.08.2021, në kuptim të përcaktimit të bërë në Ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 óPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, për detyrat e agjentit tatimor;

10.Z.E. Xh, në rolin e ish Agjentit Tatimor për periudhën 21.09.2020 dhe në vijim, në kuptim të përcaktimit të bërë në Ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 óPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, për detyrat e agjentit tatimor;

11.Z.R. N, specialist i taksës së pronës;

12.Zj.Y. R, specialiste e taksës së pronës;

13.Z.S. D, Kryeinspektor i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit;

14.Z.A.D, ish Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës, deri në 25.09.2019;

15.Z.A. GJ, Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës;

16.Z.K.K, Specialist i Kadastrës dhe Tokës Bujqësore deri më 11.11.2019.

2.2.6.1. Për auditimin e të ardhurave nga kontrata e qirasë të Bashkisë Mat me palët e treta.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Për auditimi e kontratave të qirasë lidhur ndërmjet Bashkisë Mat dhe subjekteve juridik/fizik, saktësinë e tarifave të aplikuara dhe arkëtimin e tyre, të cilat e shtrijnë efektin e tyre deri më datë 31.12.2021, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

- Ligj nr.7850, datë 29.7.1994 óPër Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;
- Ligj nr.9385, datë 4.5.2005 óPër pyjet dhe shërbimin pyjor, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
- Ligj nr.57/2020 óPër pyjet, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020;
- VKM nr.54, datë 5.2.2014 óPër përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, e ndryshuar me VKM nr.735, datë 5.11.2014, nr.445, datë 20.05.2015, nr.992, datë 9.12.2015, nr.299, datë 20.04.2016, nr.606, datë 31.08.2016, nr.693, datë 5.10.2016;
- VKB për miratimin paraprak të heqjes së fondit pyjor/kullosor nga ekonomia pyjore/kullosore;
- Urdhrat e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit për miratimin e heqjes së fondit pyjor/kullosor nga ekonomia pyjore/kullosore, sipas ngastrave dhe sipërfaqeve përkatëse;
- Kontratat e lidhura me subjektet juridike/fizike për përdorim të fondit pyjor/kullosor/tokës bujqësore, për ngritjen e hidrocentraleve, antenave të telefonisë celulare, linja të transmetimit të energjisë elektrike, agropylltari, kullotje, gurore, si dhe të parkut të lojrave për fëmijët;
- Raportet teknike për përdorimin e ekonomisë pyjore/kullosore, planvendosje në ekonominë pyjore të tubacioneve të HEC-eve, sipas ngastrave pyjore;
- Ekstrakti i regjistrimit në QKB të subjekteve që kanë lidhur kontrata;
- Rregullore e brendshme e Bashkisë Mat, e muajit Nëntor 2016, në të cilën përcaktohet detyrat për sektorin e pyjeve, zyrën e kadastrës dhe menaxhimit të tokës, sektorin juridik.

1. Kontrata e enfiteozës nr., s'ka, datë 07.07.2017 ndërmjet Bashkisë Mat, përfaqësuar nga ish Kryetari i Bashkisë z.N. R dhe enfiteozëmarrësit zj.F. N.

Objekti i kontratës: Kompleksi i lodrave, Burrel, me të dhënat, sipërfaqe nën ndërtesë 531m², sipërfaqe rrugë trotuare, sheshe dhe gjelbëruar 4639 m², sipërfaqe terrene sportive, kalceto, pistë makinash, treni elektrik, makina elektrike 2958 m².

Afati i kontratës: 15 vite.

Vlera e kontratës:

Nr	Emërtimi	Tarifa	Qera Mujore	Qera Vjetore
1	Sip. nën ndërtesë 531 m ²	50 lekë	27,081	324,972
2	Sip. rrugë trotuare, sheshe dhe gjelbëruar 4639 m ²	10 lekë	46,390	556,680
3	Sip. terrene sportive, kalceto, pistë makinash, treni elektrik, makina elektrike 2958 m ²	10 lekë	29,582	354,984
4	Shuma		103,053	1,236,636

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

1.Sipas certifikatës së pasurisë së kompleksit të lodrave, nr.3/323, ZK 1326, rezulton se sipërfaqja nën ndërtesë e dhënë me enfiteozë është 552 m² dhe jo 531 m², ose 21 m² më tepër, e përkthyer në vlerë monetare 1,050 lekë * 53 muaj (nga lidhja e kontratës në Dhjetor 2021) = **55,650 lekë**, e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të bashkisë.

2.Sipas fletë-daljes nr.318, datë 28.07.2017 nga Bashkia Mat janë bërë dalje sende të luajtshme (sipas përkufizimit të tyre në nenin 142 të Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 óPër Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar), si vijon:

- Park lodrash në 1 cop në 620,400 lekë;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

- Park multifunksional në 2 cop në 828,000 lekë;
- Aeroplan lodër në 1 cop në 300,000 lekë;
- Lisharë në 5 cop në 312,000 lekë;
- Pelivan lodër në 5 cop në 174,000 lekë;
- Elefant lodër në 1 në 69,600 lekë.

Total = 2,304,000 lekë

-Veprimi i mësipërm bie në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 2, kreu I, në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, e ndryshuar me VKM nr.735, datë 5.11.2014, nr.445, datë 20.05.2015, nr.992, datë 9.12.2015, nr.299, datë 20.04.2016, nr.606, datë 31.08.2016, nr.693, datë 5.10.2016, në fuqi për periudhën kur është kryer veprimi i mësipërm, përcaktuar shprehimisht:

“Pasuritë shtetërore, që jepen me enfiteozë sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij vendimi, janë vetëm pasuritë e paluajtshme të institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve dhe shoqërive shtetërore”.

-Për sendet e luajtshme nga Bashkia Mat nuk është përlogaritur detyrimi mujor për dhënien në përdorim të tyre subjektit F. N, sipas përcaktimit të bërë në pikën 5 të Kreut III të VKM-së së mësipërme, ku sipas përlogaritjeve të grupit të auditimit, tarifa mujore për dhënien në përdorim të këtyre sendeve, është 10,441 lekë dhe për 53 muaj nga momenti i lidhjes së kontratës deri në Dhjetor 2021, si pasojë e dhënies dhe përdorimit pa të drejtë të sendeve të mësipërme, si dhe mos tarifimit të tyre, ndaj buxhetit të bashkisë është krijuar dëm ekonomik në vlerën **951,774 lekë**. Konkretisht përlogaritjet janë bërë mbështetur përcaktimit të bërë në pikën 5 të Kreut III të VKM-së së mësipërme, përcaktuar shprehimisht:

“Për përcaktimin e vlerës së detyrimit mujor të qirasë, për pasuritë e luajtshme (makineritë, pajisjet, linjat teknologjike, makineritë e pajisjet në galeritë minerare etj.), që jepen me qira, institucioni shtetëror, ndërmarrja apo shoqëria shtetërore që ka në administrim pasurinë, përcakton vlerën e qirasë vjetore, që është sa 1/10 e VAM-it (vlerës aktuale minimale), të llogaritur si diferencë e vlerës fillestare të kontabilizuar minus amortizimin në vite, mbështetur në vendimin nr. 401, datë 23.10.1989 të Këshillit të Ministrave (pjesa për investime), shumëzuar me indeksin e çmimeve të muajit përkatës, të publikuar nga INSTAT-i”.

-Normat e amortizimit vjetor të përcaktuar në Udhëzimin nr. 14 datë 28.12.2006 për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre, si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj, të ndryshuar, në fuqi për periudhën kur janë bërë dalje nga Bashkia Mat, sendet e mësipërme:

“Amortizimi vjetor të llogaritet dhe të kontabilizohet sipas normave të përcaktuara në VKM nr. 401 të vitit 1989, ndërsa për pajisjet informatike dhe elektronike të përdoret ligji aktual fiskal “Për Tatimin mbi të Ardhurat” me norma amortizimi 25% dhe aplikimi të bëhet mbi vlerën e mbetur (kosto ose vlera kontabël minus amortizimin e akumuluar të llogaritur, shumëzuar me 25%). Në bazë të këtyre dispozitave këto norma të jenë:

- 1 % për ndërtesat e konstruksionet
- 3 % për Inventarin ekonomik



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

- 25 % për pajisjet informatike, kompjuterike e elektronike
- 5.8 % për makineritë e pajisjet operationale, instrumenta e vegla
- 13.8 % për Mjetet e transportit”.

- Periudha për të cilën është bërë përlogaritja e amortizimit, ka filluar nga data 08.06.2015 (fletë-hyrje nr.43, datë 08.06.2015) deri në 28.07.2017 (data në të cilën janë bërë dalje sendet e mësipërme).

1. Për aktivet e mësipërme është aplikuar norma e amortizimit 0.03%, si vijon: 2,304,000 lekë * 0.03 = 69,120 lekë amortizim në vit/5,760 lekë në muaj * 2 vite e 1 muaj e 27 ditë = 149,016 lekë. Duke vijuar 2,304,000 lekë ÷ 149,016 lekë = 15,462 (1/10 e VAM-it) = 215,498 lekë qera vjetore/17,958 lekë në muaj.

➤ Në mënyrë të përmbledhur si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të mësipërme në kontratën e enfiteozës së parkut të lodrave, është krijuar dëm ekonomik në vlerën **1,007,424 lekë**.

2.Kontrata qiraje nr.1864, datë 23.07.2018 ndërmjet Bashkisë Mat, përfaqësuar nga ish Kryetari i Bashkisë z.N. R dhe qiramarrësit V- A Sha.

Objekti i kontratës: Fond pyjor me qira në NJA Ulëz, 300 m² për vendosjen e antenës dhe 1.2 km për hapjen e rrugës nga antena në rrugën kryesore.

Afati i kontratës: 10 vite.

Vlera e kontratës: 300,000 lekë në vit.

Kësti	Periudha e paguar	Shuma e kesit	Paguar	Mbetje	Detyrimi në 31.12.2021
1	22.01.2017 - 21.01.2018	300,000	282,000	18,000	18,000
2	22.01.2018 - 21.01.2019	300,000	282,000	18,000	18,000
3	22.01.2019 - 21.01.2020	300,000	300,000	-	-
4	22.01.2020 - 21.01.2021	300,000	-	300,000	300,000
5	22.01.2021 - 21.01.2022	300,000	-	300,000	283,870
Shuma					619,870

➤ Në marrëdhënien kontraktore të mësipërme, konstatohet se subjekti nuk ka paguar detyrimet vjetore plotësisht/aspak, çka deri në 31.12.2021, detyrimi i krijuar ndaj Bashkisë Mat është në vlerën **619,870 lekë**, të cilat përbëjnë dëm ekonomik shkaktuar ndaj buxhetit të bashkisë.

3.Kontrata qiraje nr.1865, datë 23.07.2018 ndërmjet Bashkisë Mat, përfaqësuar nga ish Kryetari i Bashkisë z. N.R dhe qiramarrësit V-A Sha.

Objekti i kontratës: Fond pyjor me qira në NJA Lis, 300 m² për vendosjen e antenës dhe 1.2 km për hapjen e rrugës nga antena në rrugën kryesore.

Afati i kontratës: 10 vite.

Vlera e kontratës: 300,000 lekë në vit.

Kësti	Data e fillimit dhe mbarimit	Shuma e kesit	Paguar	Mbetje	Detyrimi në 31.12.2021
1	30.10.2016 - 29.10.2017	300,000	300,000	-	
2	30.10.2017 - 29.10.2018	300,000	300,000	-	
3	30.10.2018 - 29.10.2019	300,000	210,000	90,000	90,000
4	30.10.2019 - 29.10.2020	300,000	-	300,000	300,000
5	30.10.2020 - 29.10.2021	300,000	382,500		(390,000 ÷ 82,500)
Shuma					307,500



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

➤ Në marrëdhënien kontraktore të mësipërme, konstatohet se subjekti nuk ka paguar detyrimet vjetore plotësisht/aspak, çka deri në 31.12.2021, detyrimi i krijuar ndaj Bashkisë Mat është në vlerën **307,500 lekë**, të cilat përbëjnë dëm ekonomik shkaktuar ndaj buxhetit të bashkisë.

4.Kontrata qiraje nr.1186, datë 07.05.2019 ndërmjet Bashkisë Mat, përfaqësuar nga ish Kryetari i Bashkisë z.N.R dhe qiramarrësit A- Sha.

Objekti i kontratës: Fond pyjor me qira në NJA Ulëz, 200 m² për vendosjen e antenës dhe 1.2 km për hapjen e rrugës nga antenna në rrugën kryesore.

Afati i kontratës: 9 vite.

Vlera e kontratës: 220,000 lekë në vit.

Kësti	Periudha e paguar	Shuma e kesit	Paguar	Mbetje	Kamatvonesa	Detyrimi 31.12.2021
1	01.01.2019 - 31.12.2019	220,000	-	220,000	22,000	242,000
2	01.01.2020 - 31.12.2020	220,000	-	220,000	22,000	242,000
3	01.01.2021 - 31.12.2021	220,000	220,000			-
	Shuma					484,000

➤ Në marrëdhënien kontraktore të mësipërme, konstatohet se subjekti nuk ka paguar detyrimet vjetore plotësisht/aspak, çka deri në 31.12.2021, detyrimi i krijuar ndaj Bashkisë Mat është në vlerën **484,000 lekë**, të cilat përbëjnë dëm ekonomik shkaktuar ndaj buxhetit të bashkisë.

5.Kontrata qiraje nr.3024 REP., 1024 KOL., datë 07.09.2009 ndërmjet ish Komunës Lis, aktualisht NJA Lis, përfaqësuar nga ish Kryetari i Komunës z.A. S dhe qiramarrësit E-M sha, bashkuar me përthithje sipas marrëveshjes nr.780 REP., 250 KOL., datë 25.01.2013 me subjektin A- Sha. Sipas kësaj marrëveshje janë transferuar asetet e paluajtshme dhe të luajtshme, si dhe çdo detyrim dhe të drejtë të subjektit E- M sha ndaj palëve të treta. Në tërësinë e aseteve të transferuara është edhe antenna GSM/UMTS në fshatin Vinjoll, NJA Lis (koordinata v.41, Lindje 20)

Objekti i kontratës: Fond pyjor me qira në NJA Lis, 200 m² për vendosjen e antenës.

Afati i kontratës: 9 vite.

Vlera e kontratës: 170,000 lekë në vit.

Megjithëse kontrata ka përfunduar më datë 06.09.2018, subjekti A. Telekom Sha, nuk ka kryer asnjë likuidim të tarifës vjetore të qirasë, si dhe për periudhën deri më 31.12.2021 nuk është bërë rinovim i kontratës, megjithëse fondi pyjor/kullosor shfrytëzohet.

Nr	Periudha e pageses	Shuma e kesit vjetor	Paguar	Mbetje
1	01.01.2019-31.12.2021	170,000	-	510,000
	Shuma		-	510,000

➤ Në marrëdhënien kontraktore të mësipërme, konstatohet se subjekti nuk ka paguar detyrimet për shfrytëzimin e fondit pyjor/kullosor, çka deri në 31.12.2021, detyrimi i krijuar ndaj Bashkisë Mat është në vlerën **510,000 lekë**, të cilat përbëjnë dëm ekonomik shkaktuar ndaj buxhetit të bashkisë.

6.Kontrata qiraje nr.3474, datë 02.08.2021 ndërmjet Bashkisë Mat, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z.A.M dhe qiramarrësit A- Sha.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Objekti i kontratës: Fond pyjor me qira në NJA Lis, 264 m² për vendosjen e antenës dhe 0.9 km për hapjen e rrugës nga antena në rrugën kryesore.

Afati i kontratës: 9 vite.

Vlera e kontratës: 256,000 lekë në vit.

Nr	Periudha e pageses	Vlera e kestit	Faturuar	Paguar	Data e pagesës	Kamatvonesë	Mbetje
1	02.02.2021 në 02.02.2022	256,000	16.08.2021	256,000	22.10.2021	25,600	25,600
	Shuma				-		25,600

➤ Në marrëdhënien kontraktore të mësipërme, konstatohet se subjekti nuk ka respektuar pikën 7.1 të nenit 7 të kontratës, konkretisht afatin 30-ditor nga momenti i lëshimit të faturës, për kryerjen e pagesës, për të cilën nga Bashkia Mat duhet të ishte përlogaritur kamatvonesë mbështetur në pikën 7.3 të nenit 7 (0.06% për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 10% të vlerës së kestit përkatës), që sipas përlogaritjeve rezulton vlera **25,600 lekë, të cilat përbëjnë dëm ekonomik shkaktuar ndaj buxhetit të bashkisë.**

7.Kontrata qiraje nr.1304, datë 12.08.2021 ndërmjet Bashkisë Mat, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z.A. M dhe qiramarrësit z.A. K.

Objekti i kontratës: Sipërfaqe kullimore 5.3 ha për kullotjen e bagëtive, në ekonominë pyjore Mbas Deje .

Afati i kontratës: 10 vite.

Vlera e kontratës: 40,200 lekë në vit.

Mënyra e pagesës: Kësti i parë për 3 vite qira/120,600 lekë

Nr	Periudha e pageses	Vlera e kestit	Paguar	Mbetje
1	12.08.2021-12.08.2024	120,600	-	120,600
	Shuma			120,600

➤ Në marrëdhënien kontraktore të mësipërme, konstatohet se subjekti nuk ka respektuar pikën 6.2 të nenit 6 të kontratës, konkretisht parapagimin e kestit të parë për 3 vite qira, duke krijuar dëm ekonomik në vlerën **120,600 lekë ndaj buxhetit të bashkisë.**

8.Kontrata qiraje nr.1287, datë 18.03.2021 ndërmjet Bashkisë Mat, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z.A. M dhe qiramarrësit K- I Sha.

Objekti i kontratës: Fond pyjor me qira në ekonominë pyjore Ulëz-Shkopet 12 ha për veprimtarinë óAgropylltarió.

Afati i kontratës: 10 vite.

Vlera e kontratës: 121,000 lekë në vit.

Pagesa: Brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Nr	Periudha e pageses	Vlera e kestit	Paguar	Data e pagesës	Kamatvonesë	Mbetje
1	18.03.2021 në 18.03.2022	121,000	121,000	08.07.2021	12,100	12,100
	Shuma			-		12,100

➤ Në marrëdhënien kontraktore të mësipërme, konstatohet se subjekti nuk ka respektuar pikën 5.2 të nenit 5 të kontratës, konkretisht afatin 10-ditor nga momenti i lëshimit të faturës, për kryerjen e pagesës, për të cilën nga Bashkia Mat duhet të ishte përlogaritur kamatvonesë mbështetur në pikën 5.5 të nenit 5 (0.01% për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 10% të vlerës së kestit përkatës).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

6	Ndërtimi i Aneksit të Stadiumit	ó2A-Pô & óKô	Jo	Jo	80,000	2,500	82,500
7	Rikualifikim urban i sheshit dhe fasadave të Nj. Administrative Lis dhe Koms	ó2 Nô	Jo	Jo	46,667	2,500	49,167
8	Rikonstrukcion i godinave për strehim social	R	Jo	Jo	80,000	2,500	82,500
9	Ndërtim i rrjetit shpërndarës së qytetit të Burrel (Faza 1 + Faza II)	óL-Oô dhe óFô	Po	Po	150,000	6,000	-
	TOTAL 2021						214,167
TOTAL 2019-2021							504,001

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Titulli i Gjetjes:Procedurat e kryera për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e shërbimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike në territorin e Bashkisë Mat.

Situata:Bazuar në dokumentet e paraqitura nga Sektori i Prokurimeve, si dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore konstatohet se, për periudhën 2019-2021 kanë kryer punime ndërtimi me fondet e Bashkisë Mat, 9 operatorë ekonomik të shpallur fitues, nga të cilët vetëm 1 prej tyre ka paguar tarifën e shërbimit dhe 9 të tjerë jo, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën **504,001 lekë**.

Kriteri:Shkronja óaô e pikës 5 të nenit 35, në Ligjin nr.139/2015 óPër Vetëqeverisjen Vendoreó, i ndryshuar;

Pika 10 e nenit 3 dhe pika 2 në nenin 18 të Ligjit nr. 68/2017 óPër financat e Vetëqeverisjes Vendoreó.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETQEVERISJES VENDORE RAPORT AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën 550,667 lekë.

Shkaku: Mos marrja e masave për ndjekjen dhe arkëtimin e të ardhurave nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të nxjerrin njoftim detyrimin për tarifën e shërbimit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës prej 504,001 lekë.

Përdorimi i të ardhurave.

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2019 është realizuar në vlerën **81,376 mijë** lekë, ose **11%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2019, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe shpenzime operative.

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2020 është realizuar në vlerën **56,138 mijë** lekë, ose **0.06%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2020, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe investime (bashkëfinancim të punëve publike me fondet e transfertës së kushtëzuar).

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2021 është realizuar në vlerën **86,469 mijë** lekë, ose **0.06%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2021, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe shpenzime operative.

Tabela nr.28 Përdorimi i të ardhurave 2019-2021

Art.	Emertimi	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021
		Te ardhurat e veta	Te ardhurat e veta	Te ardhurat e veta
231	Investime	7,848	14,984	6,938
600	Paga	42,695	28,774	35,445
601	Sigurime Shoqërore	5,848	4,805	5,919
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	24,985	2,625	29,697
604	Transferta Korente të Brendshme		4,950	7,800
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ			670
	Total	81,376	56,138	86,469

Burimi: Bashkia Mat, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.53/13 prot., datë 28.04.2022 dhe nr.53/12 prot., datë 26.04.2022 Mbi Projektraportin e Auditimit, janë paraqitur observacionet nga z.V. S, z.A. P, z.A. S, z.A. H, z.E. A, z.D. Rr, A. Ç, E. A më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

V. S., lidhur me kontratat e qirasë së fondit pyjor, sipas numrit rendor të tyre kontrata nr.11, 13, 17, 21, 22, 23, 25, 26, 27, 29, 30, 33, 37.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Lidhur me pretendimet e ngritura për kontratat e mësipërme, si fillim sqarojmë se ju nuk jeni ngarkuar me përgjegjësi për tarifën e aplikuar, pasi këtë e kemi të qartë që e kanë bërë grupet e punës të cilat kanë hartuar raportet teknike. Sa i takon likuidimit të tarifave të qirasë, theksojmë se në pjesën më të madhe të rasteve që keni cituar, edhe grupi i auditimit e ka cituar që është kryer pagesa, pasi nuk ka asnjë arsye të shprehet kundër. Sa i përket likuidimit të tarifës 983,243 lekë bazuar në kontratën e qirasë nr.2749, datë 29.10.2018 ndërmjet Bashkisë Mat, përfaqësuar nga ish Kryetari i Bashkisë z.N R dhe qiramarrësit N E shpk, merret në konsideratë dhe është bërë ndryshimi përkatës. Ne jemi shprehur për diferencat e krijuara si rrjedhojë e mos tarifimit të plotë të sipërfaqeve të dhëna me qira/tarifimit të pasaktë të tyre, duke krijuar diferenca në vlerë. Ju si drejtor i drejtorisë së bujqësisë jeni ngarkuar me përgjegjësi sa i përket rasteve kur subjekte të caktuara nuk kanë rinovuar kontratat e qirasë, megjithëse kanë qenë në përdorim të fondit



pyjor, rastit të subjektit DV, i cili ka përdorur fondin pyjor pa nënshkruar kontrat qiraje, si dhe kontrollin e punës së përgjegjësve të sektorëve, konkretisht të sektorit të pyjeve, ku disa nga detyrat: 1. Administrimin e fondit pyjor e kullësor publik, në përputhje me politikat dhe strategjitë e miratuara, legjislacionin në fuqi; 3. Njoftimin e inspektoratit të policisë pyjore për shkeljet dhe dëmtimet e konstatuara në fondin pyjor dhe kullësor, kanë qenë objekt i kontrollit të realizimit të tyre nga juve si drejtor i kësaj drejtorie deri më 10.11.2019.

Pretendimi i subjektit:

A.P lidhur me mangësitë e evidentuara në licencimin dhe tarifimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet otëgim të karburanteve, shpreheni se Bashkia Mat ka ngritur komisionin për marrjen e masave për subjektet që nuk kanë licencë për shfrytëzimin e aktivitetit dhe është bërë i mundur bllokimi i llogarive të subjekteve. Gjithashtu afati për dhënien e licencave është deri në 5 vjet dhe jo 5 vjet.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Sa është paraqitur në pretendimet e mësipërme nuk janë bashkëlidhur dokumente justifikuese. Gjithashtu grupi i auditimit nuk është shprehur për bllokimin e llogarive bankare, por për njoftimin e Inspektoratit përkatës, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Për pjesën e afatit është bërë ndryshimi që në fazën e Projekt Raportit të Auditimit, ku është ndryshuar baza ligjore, mbështetur në përcaktimin e bërë nga Bashkia Mat për afatin e dhënies së licencës.

Pretendimi i subjektit:

A. S dhe A. Ç për kontratën e enfiteozës dhe banesave sociale.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Lidhur me pretendimin e mësipërm, sqarojmë se, përgjegjësia e z.S bazuar në funksionet tuaja pranë Bashkisë Mat, pra deri më datë 04.11.2019 (Specialist i emergjencave civile dhe pronave), si dhe nga data 04.11.2019 e në vazhdim (Përgjegjës i sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Pronave), si dhe përcaktimet e bëra në pikën 1 të nenit 58 dhe pikat 16, 20, 21, 25, 32, 39 në Rregulloren e Brendshme, lidhur me menaxhimin, ndjek dhe zbaton, qiradhënien e objekteve me sipërfaqe mbi 200m², administrimin e banesave sociale me qira. Sa më sipër në asnjë prej kontratave të mësipërme, enfiteoza, qiradhëniet e banesave sociale, nuk administrohej asnjë dokument ku të evidentohet puna juaj mbi informimin e eprorit se enfiteozëmarrësit i janë dhënë në përdorim lojrat e parkut, për të cilat theksojmë se VKM nr.54, datë 05.02.2014 përjashton dhënien e tyre. Pra sa më sipër jemi në një situatë që është vepruar në kundërshtim me kuadrin rregullator, si dhe në dosjen përkatëse të dhënies me enfiteozë janë dokumentet mbi monitorimin e kontratës, por jo informacioni i përgatitur nga ana juaj për parregullësinë e evidentuar. Nuk jemi shprehur nëse është monitoruar kontrata, por jemi shprehur vetëm për 1 element të saj, për të cilin nga ju nuk është marrë ndonjë masë, qoftë edhe informimin e eprorit.

Sa i përket komentit tuaj se nuk jeni kërkuar për ballafaqim, po ju bashkëlidh komunikimin zyrtar me Zv.Kryetarin e Bashkisë, si dhe listën e personave që duhet të ishin prezent në takim për fundimtar, ku diskutohen gjetjet e auditimit. Në këtë takim ju nuk keni marrë pjesë.

Sa i përket komentit të bërë nga A. C, më poshtë pasqyrohet email-i i dërguar grupit të auditimit të KLSH, pjesë e të cilit ka qenë informacioni për asetet në pronësi të Bashkisë Mat, si dhe në sheet emërtuar óEKBô ishin të dhënat për banesat sociale, të cilat sipas observacionit të bërë nga ana juaj për akt-konstatimin përkatës, u ndryshuan ekstremitetet e kontratave.

Informacioni i dhënë në emailin tuaj, shërbeu si indicie për kontratat e qirasë për banesat sociale. Ju jeni shprehur se me urdhër të titullarit është ngarkuar strukturë tjetër për ndjekjen e këtyre kontratave, por nuk keni bashkëlidhur dokument justifikues.



-Sa më sipër pretendimi juaj nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

A. H, E. A dhe E. A për kontratën qirasë për HEC Vinjoli: Si fillim konfirmohet gjetja e grupit të auditimit, si dhe për sipërfaqen e ndërtimit të veprës së marrjes, basenit të presionit, godinës së HEC, nuk mund ti referohemi tarifave pasi për heqjen e sipërfaqes për objektet e mësipërme është përgjegjëse Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Lidhur me pretendimin e mësipërm, sqarojmë se, në asnjë rast nuk kemi cituar se përse Bashkia Mat nuk ka hequr nga fondi pyjor sipërfaqen për ndërtimin e objekteve të mësipërme, por kemi cituar se për këto objekte është dhënë leja e ndërtimit dhe në këtë kohë sipërfaqja në të cilën janë ndërtuar këto objekte, akoma nuk ishte hequr nga fondi pyjor me urdhër të ministrit përgjegjës. Në këto kushte për këtë sipërfaqe në të cilën do ndërtoheshin objektet e mësipërme, duhej të aplikoheshin tarifat përkatëse në kontratën e parë të qirasë (tabela 10 në VKM nr. 1064, datë 22.12.2010), pasi këto sipërfaqe në këtë kohë kanë qenë në pronësi të Bashkisë Mat dhe janë shfrytëzuar nga subjekti privat për ndërtimin e veprës së marrjes, basenit të presionit, godinës së HEC. Gjithashtu theksojmë se nga ju nuk është pasqyruar asnjë dokumentacion ku të pasqyrohet fillimi dhe përfundimi i punimeve të ndërtimit për objektet e mësipërme. Ky qëndrim vlen edhe për observacionet e tjera të së njëjtës natyrë.

-Sa më sipër pretendimi juaj nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

D. Rr për ngritjen e ekipeve të menaxhimit të programit (bashkëlidhur urdhrat e titullarit). Për vitet buxhetore janë përgatitur kërkesat nga drejtuesit e ekipeve të menaxhimit të programit (bashkëlidhur njoftimet për drejtuesit e programeve dhe kërkesat e tyre për fonde buxhetore). Gjithashtu është bërë observacion për saktësimin e vlerës debitoare për subjektet E shpk dhe E shpk.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Lidhur me pretendimin e mësipërm, sqarojmë se, nuk jemi shprehur se nuk janë nxjerrë urdhrat për ngritjen e ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore, por që nuk dokumentohet procesi i përgatitjes së kërkesave për nevoja buxhetore. Megjithatë nga vlerësimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nëpërmjet observacionit, shprehem se observacioni merret pjesërisht në konsideratë dhe është bërë ndryshimi përkatës.

III.2.3. Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë.

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njesisë.

2.3.3. Opinioni mbi pasqyrat financiare.

Titulli i gjetjes nr. 1: Mbi kontabilizimin e Aktiveve afatgjata materiale, pa titull pronësie.

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se, nga objektet inventari të pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 800,075,612 lekë, objektet nuk janë pajisur plotësisht me titull pronësie, konkretisht sipas llogarive paraqiten si më poshtë:

- llog 210 óToka troje terreneô, elementë në vlerën neto 27,399,128 lekë

-llog. 211 óPyje plantacioneô, elementë në vlerën neto 10,550,203 lekë,

-llog. 212 óNdërtesa e konstruksioneô, 103 objekte me vlerën neto 762,126,281 lekë

-Për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë



pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dukumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë.

Kriteri: Pikën 2 të nenit 6 në Ligjin nr.8743, datë 22.02.2001 óPër pronat e paluajtshme të shtetit, i ndryshuar; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 óPër inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme, Kreu VI óTransferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme, ku cilësohet:

ó1. Bashkia është subjekti juridik që trashëgon të drejtat e pronësisë, të luajtshme dhe të paluajtshme të Njësive që Shkrihen (NJSH). Nga momenti i konstituimit të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive ajo ushtron të drejtën e pronësisë si dhe të drejta të tjera sipas mënyrës të përcaktuar me ligj.

2. NJSH-të duhet të plotësojnë dhe depozitojnë pranë bashkisë inventarin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi. Për pronat e paluajtshme inventari duhet të përmbajë edhe informacionin për fazën e regjistrimit në të cilën ndodhen.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e titullit të pronësisë:

- është pengesë për kryerjen e transaksioneve të ndryshme me pasuritë e paluajtshme;
- është pengesë për menaxhimin e risqeve dhe mbrojtjen ndaj tyre, pasi mungesa e titullit të pronësisë pengon sigurimin e tyre.
- ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Titull i cili vërteton pronësisë dhe ushtrimin e të drejtave mbi një pasuri të paluajtshme.

Shkaku: Nga ballafaqimi i problematikës, gjatë auditimit në terren, ka rezultuar se shkaqe të kësaj gjendjeje edhe pas 5 vitesh nga kryerja e këtij procesi janë:

- dokumentacioni i paplotë i trashëguar nga ish-Komunat;
- vështirësia e hasur në plotësimin e dosjeve sipas kërkesave të akteve ligjore e nënligjore për regjistrimin e titujve të pronësisë;
- kostoja e kryerjes së këtyre veprimeve në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila është e konsiderueshme referuar numrit të objekteve të cilët duhet të regjistrohen.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Bashkia Mat duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ZRPP dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të përlllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Për këtë veprim mban përgjegjësi përgjegjësia e Sektorit të Financës dhe Buxhetit zj. D. T si dhe Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe të Ardhurave z. D. Rr.

Pretendimi i subjektit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.53/12 prot., datë 26.04.2022 óMbi Projektraportin e Auditimit, janë paraqitur observacionet nga Drejtoria Ekonomike dhe Të Ardhurave për sa më poshtë:

Sqarojmë se mosregjistrimi i këtyre pronave nuk është bërë akoma pasi kanë kosto të lartë ekonomike, dhe ne si Bashki e vogël që jemi nuk i kemi kapacitetet financiare për momentin që të kryejmë procedurat e regjistrimit pranë ZVRPP por kjo nuk është përgjegjësi e Drejtorisë Ekonomike por e Sektorit të pronave që mbulon procesin e regjistrimit të pronave të luajtshme dhe të paluajtshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Në lidhje me sa trajtuar në Projekt Raport dhe sa trajtuar nga ana e juaj në komente, Ju sqarojmë se çështja e kostove nuk përbën argumentim për mosregjistrim të pronave. Për situatën e përgjegjësisë së regjistrimit, siç është shprehur nga ana juaj se këtë përgjegjësi e



ka Sektori i pronave, ne jemi dakort me ju, por grupi i auditimit i referohet rregjistrimit në kontabilitet nga ana juaj pa dokumentacion pronësie. Pra i referohemi çështjes së rregjistrimit kontabël nga Drejtoria Ekonomike, dhe jo rregjistrimit të aseteve në ZVRPP. Sa më sipër cituar, grupi i auditimit i qëndron gjetjes.

Titulli i gjetjes nr. 2: Mbi kontabilizimin e llogarisë 213 óRrugë, rrjete, vepra ujoreô.

Situata:Duhet theksuar se jo cdo shpenzim investimi mund të kapitalizohet ne aktivin përkatës për të cilin po bëhet investimi, dhe në rastin tonë janë ndërtesat dhe konstruksionet si dhe rrugët dhe veprat ujore. Vetëm shpenzimet kapitale të cilat janë situacione përfundimtare dhe për të cilat është marrë në dorëzim objekti, atëherë kapitalizohet e gjithë vlera e tij te llogaria e aktivit.

Shtesa në tabelën e gjendjeve të ndryshimit të aktiveve afatgjata materiale për llogarinë 213 óRrugë, rrjete, vepra ujoreô, ka qenë në vlerën 185,352,032 lekë, ndërsa sipas dokumentacionit shoqërues në urdhër-shpenzimet e verifikuara në ditarët e bankës, disa prej faturave të sipërcituara nuk përbëjnë rritje aktivi sepse projekti përkatës në fund të vitit 2020 nuk ishte mbaruar si investim dhe nuk ishte marrë në dorëzim, që do të thotë është një investim në proces. Pra shpenzimi kapital duhet të ishte rregjistruar në llogarinë 231 óShpenzime për rritjen e AAGJMô, specifikisht si më poshtë;

-Për vitin 2020: në llogarinë 231 óShpenzime për rritjen e AAGJMô për shumën 185,352,032 lekë dhe jo në llogarinë e aktivit 213 óRrugë, rrjete, vepra ujoreô.

Kriteri: Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 óPër menaxhimin financiar dhe kontrollinô neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareô udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeô.

Ndikimi/Efekti:Paraqitja e aktivit 213 óRrugë, rrjete, vepra ujoreô në vlerën 185,352,032 lekë më shumë në vitin 2020 sjell pasqyrim jo të saktë të AQT-ve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

Shkaku:Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit si dhe parimeve kontabël mbi pjesën e hyrjes së aktivit në njësi

Rëndësia:I Lartë

Rekomandimi:Nga Bashkia Mat, Drejtoria e financës dhe të ardhurave, të bëhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë 213 óRrugë, rrjete, vepra ujoreô përkatësisht për shumat 185,352,032 lekë për vitin 2020, me mbylljen e bilancit kontabël të vitit të ardhshëm.

Për këtë veprim mban përgjegjësi përgjegjësia e Sektorit të Financës dhe Buxhetit zj. D T si dhe Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe të Ardhurave z. D. Rr

Titulli i gjetjes nr. 3: Mbi kontabilizimin e llogarisë AAGJJM 202 óStudime e kërkimeô.

Situata:Llogaria 202 óStudime dhe Kërkimeô paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën neto 30,066,269 lekë, dhe në fund të vitit 2019 në vlerën neto 22,122,269 lekë, Diferenca në rritje vjen për shkak të 5 projekteve infrastrukturore me vlerë 7,944,000 lekë. Sipas inventarit kontabël, gjendja e kësaj llogaritje është në vlerën neto 30,066,269 lekë dhe përbëhet nga 19 projekte për investime të kryera , nga të cilat 12 prej tyre nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve.

Kriteri:Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 óPër menaxhimin financiar dhe kontrollinô neni 6; të nenit 10 dhe



11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareó udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeó.

Aneksi 1 óAnaliza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publikó Pika 2. Klasa 2, óAktivet afatgjataó (përbërja dhe trajtimi kontabël).

Ndikimi/Efekti:Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2020 të llogarisë 202 óStudime e kërkimeó.

Shkaku:Mos njohja dhe mos zbatim i udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeó.

Aneksi 1 óAnaliza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publikó Pika 2. Klasa 2, óAktivet afatgjataó (përbërja dhe trajtimi kontabël).

Rëndësia:I Lartë

Rekomandimi:Nga Bashkia Mat, Drejtoria Ekonomike dhe e të ardhurave, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet për kalimin e vlerës së atyre projekteve për të cilat investimi ka mbaruar (specifikisht ato projekte të trashëguara nga ish komunat) si vlerë e shtuar çdo aktiv afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve, si dhe të rishihet dhe vet llogaria 202 studime e kërkime për vlerën kontabël neto 30,066,269 lekë.

Për këtë veprim mban përgjegjësi përgjegjësia e Sektorit të Financës dhe Buxhetit zj. D.T si dhe Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe të Ardhurave z. D.Rr.

Pretendimi i subjektit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.53/12 prot., datë 26.04.2022 óMbi Projektraportin e Auditimitó, janë paraqitur observacionet nga Drejtoria Ekonomike dhe Të Ardhurave për sa më poshtë:

Ky argument nuk qëndron për arsye se kur janë kryer procedurat e blerjes së këtyre projekteve janë bërë kontabilizimet përkatëse konformë ligjit duke debituar llogarite e klases 23 dhe kredituar llogarite e klasës 4 nga njëra anë dhe, duke debituar klasen 20 dhe kredituar klasen 10 Fonde bazë nga ana tjetër.

Keto vlere të projektimit nuk u janë shtuar Objekteve për të cilat janë hartuar projektet për arsye se këto objekte janë të pafinancuara akoma ose disa janë në process dhe për këtë arsye projektet do mbeten të pasqyruara në pasyrat financiare vjetore tek klasa 20 dhe jo te klasa 21, Në momentin që këto projekte financohen dhe merren në dorëzim nga Bashkia atëhere këto kosto të projektimit I shtohen vlerës së financuar për zbatim te kontratës dhe bëhet kalimi nga klasa 20 tek klasa 21.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Në lidhje me sa trajtuar në Projekt Raport dhe sa trajtuar nga ana e juaj në komente, Ju sqarojmë se çështja e mungesës së financimit të projekteve të investimit, nuk na rezulton e tillë, pasi nëse shohim investimet e zhvilluara nga Bashkia Mat për vitin 2020, disa prej tyre janë investime të cilat kanë dhe projektin përkatës në llogarinë 202 óStudime dhe kërkimeó (investimi óNdërtim i rrjetit të Kuz Blloku Drita Nr.1 dhe Drita Nr. 2 dhe lagjja e Re, qyteti Burrelô, ka dhe projektin óBlloku Drita nr.1ó dhe óBlloku Drita nr.2ó). Megjithatë në rekomandimin e dhënë më sipër, duke marrë pjesërisht në konsideratë observimet tuaja, është lënë si detyrë të rishihet dhe të reflektohet pjesa e regjistrimit në kontabilitet e projekteve dhe të specifikohet se cilit prej tyre i ka mbaruar investimi në mënyrë që të kapitalizohet.



Titulli i gjetjes nr. 4: Mbi kontabilizimin e llogarisë 26 óAktivet Afatgjata Financiareó.

Situata: Bashkia Mat, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të óUjësajllës Mató sh.a. me NUIS óJ68103917Fó e cila është shoqëri aksionere me objekt óShërbimi i furnizimit me uje të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirembajtja e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëveó. Numri i aksioneve është 1 me vlerë nominale 729,777,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 729,777,000 lekë

Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesmarrje të Bashkisë Mat në óUjësajllës Mató Sh.A. në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2019 dhe 2020, më konkretisht në llogarinë 26 óPjesmarrje në kapitalet e vetaó në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 óPër shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaró me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 óAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomaterialeó pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 óTrajtimi kontabël i investimeve në pjesmarrjeó

Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) 729,777,000 lekë dhe investori është Bashkia Mat.

Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesmarrje me vlerë kontabël 729,777,000 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar.

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareó, Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 óPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaró me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 óAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materialeó pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 óTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeó

Ndikimi/Efekti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2020 të llogarisë 26 óPjesëmarrje në kapitalin e vetó, gjendje kjo e nën vlerësuar me 729,777,000 lekë.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareó, urdhrin nr.64 datë 22.07.2014 óPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaró, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 óAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materialeó dhe Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.28 óInvestime në Pjesëmarrjeó.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Nga Bashkia Mat, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të óUjësajllës Mató sh.a me vlerë kontabël 729,777,000 lekë në debi të llogarisë 26 óPjesëmarrje në kapitalin e vetó dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Titulli i gjetjes nr. 5: Mbi kontabilizimin e llogarisë 466 óKreditorë për mjete në ruajtjeó.

Situata: Llogaria 466 óKreditorë për mjete nën ruajtjeó, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Mat, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 18,402,483 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, ose shumën 18,261,283 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2019 dhe 2020, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 óKreditorë për mjete nën ruajtjeó duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e



dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Përfundimisht për vitin 2019 dhe 2020;

Llogaria 466 óKreditore për mjete nën ruajtjeó është mbivlerësuar për 5,841,471 lekë për vitin 2020 dhe 5,037,881 lekë për vitin 2019, për të cilat duhet të bëhet sistemimi i llogarisë.

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; 28/2018 datë 10.05.2018 óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareó neni 5, 6, 7, 9 dhe 10ó; ligjin 10296 datë 08.07.2010 óPër menaxhimin financiar dhe kontrollinó neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeó seksioni óFunksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4., Llogaria 466 óKreditore për mjete në ruajtjeó.

Ndikimi/Efekti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2020 të llogarisë 466 óKreditore për mjete në ruajtjeó

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeó.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Nga Bashkia Mat, Drejtoria e Financës dhe të ardhurave, të merren masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 óKreditore për mjete nën ruajtjeó duke rakorduar me Drejtorinë e Shërbimeve cdo muaj mbi balancat e llogarisë 466 si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Për këtë veprim mban përgjegjësi përgjegjësia e Sektorit të Financës dhe Buxhetit zj. D.T si dhe Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe të Ardhurave z. D. Rr.

Pretendimi i subjektit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.53/12 prot., datë 26.04.2022 óMbi Projektraportin e Auditimitó, janë paraqitur observacionet nga Drejtoria Ekonomike dhe Të Ardhurave për sa më poshtë:

Ky argument nuk qëndron për arsye se ne nuk mund ti fshijmë nga bilanci keto garanci edhe pse ju kanë kaluar të gjitha afatet. Ky veprim nuk na lejohet nga thesari.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Në lidhje me sa trajtuar nga ana e juaj në komente, Ju sqarojmë se nuk po kërkohet fshirja nga bilanci, sic e shprehni ju, por po kërkohet sistemimi i llogarisë pasi llogaria 466 óKreditore për mjete në ruajtjeó, është një llogari kumulative për garancitë e punimeve 5%, dhe në kontratat e investimeve kjo garanci kthehet pasi një afati të rënë dakort (maksimumi deri në dy vjet), për këtë arsye në këtë llogari nuk mund të kemi garanci që kanë një periudhë rregjistrimi në kontabilitet që nga ish komunat (përpara vitit 2016), pasi nuk i përkasin më kësaj llogarie. Për këtë arsye observimi juaj nuk mund të merret në konsideratë.

Titulli i gjetjes nr. 6: Mbi kontabilizimin e llogarisë 467 óKreditore të ndryshëmó.

Situata: Llogaria 467 óKreditore të ndryshëmó paraqiten faturat e pa likuiduara, vendime Gjyqesore dhe investime dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2020 paraqiten në shumën 19,924,791 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2020 paraqitet si më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë	
Gjendja në 01.01.2020	38,675,907
Shtesa gjatë vitit 2020 (D)	3,142,991
Pakësime gjatë vitit 2020 (K)	21,894,107
Gjendja në 31.12.2020	19,924,791



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETQEVERISJES VENDORE RAPORT AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Siç shihet edhe nga tabela llogaria 467 paraqitet në vlerën 19.924.791 lekë e përbërë nga:
-shpenzime të kryera por të pafinacuara per mallra dhe shërbime ne masen 15,212,010 lekë
-shpenzimet për vendime gjyqesore në shumën 3,750,850 lekë;
-shpenzime të tjera për sigurime shoqërore ,shëndetësore dhe shpërblim këshilli dhe kryetarë fshatrash por të pa likuiduara në shumën 961,931 lekë.
dhe që janë pasqyruar në llogarinë 486 në shumën 19,924,791 lekë;

Ky zë i bilancit përfaqëson detyrimet e vitit si dhe detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera. Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Mat nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likuiduara në 2021 por të parregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2020.

Në mënyrë analitike këto fatura me kompetencë vitin 2020 por të parregjistruara dhe të likuiduara në 2021, paraqiten si më poshtë:

Emri_Institucionit	Ec_Account	Ec_Account_Description	Kodi_Projekt	Projekt_Description	Furnitori	Shuma	Data_Furnitori	Data_Urdher_Shipencimit	Gl Date	Data_Regjistrimit	Data_Ekzekutimit
Bashkia Mat (0625)	2313300	Shpenz. per mjetin e AQT - konstruksione te rrejetve	1880645	Ndërtim i rrjetit te luz Bloku Drita nr. 1 dhe Drita Nr. 2 dhe lagja e re, qytet	CARA	11,334,123	2-Dec-20	12-Feb-21	12-Feb-21	2/12/2021	2/16/2021
Bashkia Mat (0625)	2302100	Shpenz. per mjetin e AQ - studime ose lerkime	1320205	Harim projekte ne Aparat	BASHKIM MATA	2,000,000	20-Dec-20	2-Jun-21	2-Jun-21	6/2/2021	6/4/2021
Bashkia Mat (0625)	2313300	Shpenz. per mjetin e AQT - konstruksione te rrejetve	1320207	Cezma Publike	"ALIAJ - 79" SHPK	996,316	23-Dec-20	26-May-21	26-May-21	5/26/2021	5/27/2021
Total						14,330,439					

Mosparaqitja e tyre në kontabilitet, edhe pse janë kompetencë e vitit ushtrimor 2020, ka nënvlerësuar llogarinë 467 óKreditorë të ndryshëmô me 14,330,439 lekë.

Kjo procedurë mospasqyrimi në llogarinë 467 óKreditorë të ndryshëmô të detyrimeve për faturat e likuiduara në 2021 por me kompetencë vitin 2020, përbën shtrembërim të informacionit financiar, duke qenë së detyrimet e prapambetura për vitin 2020 të përcjella në Ministrinë e Financave janë nënvlerësuar me 14,330,439 lekë.

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; Ligji 9228 datë 29.04.2004 óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareô neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, ligjin 10296 datë 08.07.2010 óPër menaxhimin financiar dhe kontrollinô, urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 ó Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuarô dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 óKudri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiareô.

Ndikimi/Efekti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2020 të llogarisë 467 óKreditorë të ndryshëmô, gjendje kjo e nën vlerësuar me 14,330,439 për vitin 2020.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareô, urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 óPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuarô, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 óKudri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiareô

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Nga Bashkia Mat, nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike dhe të ardhurave, të bëhen sistemimet në kontabilitet të llogarisë 467 óKreditorë të ndryshëmô e cila është nënvlerësuar me 14,330,439 për vitin 2020. Ky sistemim të bëhet duke e transferuar këtë vlerë nga llogaria 41-408 óFurnitorë e llogari të lidhura me toô, në llogarinë 467 óKreditorë



të ndryshëm. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

Për këtë veprim mban përgjegjësi përgjegjësia e Sektorit të Financës dhe Buxhetit zj. D.T si dhe Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe të Ardhurave z. D. Rr.

Pretendimi i subjektit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.53/12 prot., datë 26.04.2022 óMbi Projektraportin e Auditimit, janë paraqitur observacionet nga Drejtoria Ekonomike dhe Të Ardhurave për sa më poshtë:

Ky argument nuk qëndron për arsye se këto fatura janë përfshirë në llogarinë 401-408 të bilancit të vitit 2020 për arsye se në llogarinë 467 në pasiv dhe në llogarinë 486 në aktiv përfshihen të gjitha detyrimet tatimore deri më 30.11. të vitit ushtrimor duke rakorduar me Degën e Thesarit dhe Ministrinë e Financave për këto periudha bazuar në Udhëzimin nr 37 datë 06.10.2020 óPër monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura, dhe detyrime të cilat i përkasin muajit dhjetor përfshihen në llogarinë 401-408 në pasiv dhe 4342 në aktiv të bilancit .

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Në lidhje me sa trajtuar në Projekt Raport dhe sa trajtuar nga ana e juaj në komente, Ju sqarojmë se udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, pika 42 citon;

Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas në pasqyratfinanciare vjetore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, përshtetëzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës sëfondeve. Për të evidentuar këto detyrime, do të përdoren llogari specifike të kontabilitetit llogarisë 486 óShpenzime të periudhave të ardhshme, në varësi të natyrës së tyre:

- óShpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për vendimet
- gjyqësore
- óShpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për shërbime
- óShpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për
- mirëmbajtje;
- óShpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për investime;
- óShpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura të tjera.

Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për detyrimet e prapambetura të bëhen si më poshtë:

- **Debitohet llogaria përkatëse 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura” dhe**
- **Kreditohet llogaria përkatëse 467 “Kreditorë të ndryshëm”**

Këto fatura nuk janë detyrim dhjetori, sic mund të jetë detyrimet për shpenzime operative si energjia elektrike, telefoni, internet, të cilat faturohen në fund të muajit. Këto fatura janë investime për të cilat nuk është bërë e mundur pagesa për arsye mungesë fondesh nga Bashkia Mat. Kjo është mëse e evidente pasi likuidimet e tyre janë bërë në qershor të 2021, kur fatura ka ardhur në dhjetor të 2020. Nisur nga udhëzimi nr.8 datë 09.03.2018, këto janë óshpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për investime, dhe si të tilla duhet të raportohen si detyrime të prapambetura në llogarinë 486 óShpenzime të periudhave të ardhshme me kundërparti llogarinë 467 óKreditorë të ndryshëm. Paraqitja



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETQEVERISJES VENDORE RAPORT AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

nga ana e Drejtorisë Ekonomike e vlerës 14,330,439 së këtyre 3 faturave në llogarin 401-408 óFurnitorë e llogari të lidhura me toë, praktikisht con drejtpërdrejt në ófshehjenë e detyrimit të prapambetur që i raportohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke mos u reflektuar në llogarinë makro që ka MFE për monitorimin e detyrimeve të prapambetura (486 Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura). Për këtë arsye observimi juaj nuk mund të merret parasysh.

Titulli i gjetjes nr. 7: Mbi procedurën e inventarizimit për vitet 2019 dhe 2020ë.

Situata:Në procedurën e inventarizimit të vitit 2019, është bërë dhe inventarizimi i materialeve të ndërmarrjes së pastrimit, pra kontenierëve dhe kazanëve të plehrave. Më poshtë paraqitet kartela e inventarizimit.

INVENTARI I SIPERMARRJES SË PASTRIMIT viti 2019													
Nr	Nr.	EMERTIMI	Njesia	Çmimi	Sipas te dhenave		Sipas te dhenave		REZULTATET				Viti Hyrjes
					kontabile		te inventarizimit		Mungesat		Tepriat		
					Sasia	Vlefte	Sasia	Vlefte	Sasia	Vlefte	Sasia	Vlefte	
1	218	Kazana Plenash	cope	28,286	70	1,979,9	70	1,979,999					2007
2	218	Kontenjere	cope	27,726	39	1,081,3	39	1,081,303					2010
		Shuma 218				3,061,302	3,061,302						
3	214	Kontinjere	cope	16,663	30	499,896	30	499,896					2015
4	214	Kontenjere	cope	33,552	25	838,801	25	838,801					2015
5	214	Kontinjer mbetje metalike	cope	30	17	510	17	510					2019
6	214	Kontenjer plastike	cope	24	15	360	15	360					2019
7	214	Kosha mbeturinash statik	cope	16,8	6	100,8	6	100,8					2019
		Shuma 214				2,309,497	2,309,497						
		SHUMA				5,370,799	5,370,799						

Kjo gjendje inventari i ka kaluar nën përgjegjësinë materiale z. K. K, administrator i kompanisë óE 1ë shpk, në datën 29.06.2019.

Kronologjikisht janë ndërmarrë këto hapa;

Nga auditimi u konstatua se shërbimi i pastrimit ka qenë një shërbim i kontraktuar me kompani private të pastrimit, kompaninë óA. G.ô sh.p.k, me administrator në atë kohë, z. K. M. Midis Bashkisë Mat dhe kompanisë óA. G.ô sh.p.k , referuar të dhënave publike të Agjensisë së Prokurimit Publik (faqja web e APP), është zhvilluar procedura e prokurimit për shërbimin e pastrimit në Bashkinë Mat në 20.10.2017 dhe është shpallur fituese kompania óA.Groupô shpk. Lidhja e kontratës është bërë në datën 09.03.2018, me afat deri në datën 31.12.2021 me opsion rinovimi.

Ky shërbim pastrimi përpara vitit 2018, ka qenë përsëri i kontraktuar me një operator ekonomik privat, përkatësisht óKô sh.p.k, me administrator z. G. K.

Pas lidhjes së kontratës së re me operatorin óA Gô shpk në datën 09.03.2018, kontenierët të cilët deri para lidhjes së kontratës së re, ishin në pronësi të bashkisë dhe nën përgjegjësin materiale të operatorit óKô shpk me administrator z. G. K, këto kontenierë nuk janë kaluar nën përgjegjësinë materiale të operatorit të ri fitues, kompanisë óA Gô shpk deri në datën 29 qershor 2019.

Pra praktikisht óA Gô shpk nuk ka pasur kontenierë nga data e lidhjes së kontratës më 09.03.2018 deri në datën 29.06.2019. Sipas kontratës që Bashkia Mat ka me OE óA Gô shpk, në nenin 37 óSpecifikime Teknikeô, pika 37.1.1, citohet ótë gjithë kontenierët do të sigurohen nga punëdhënësi (Bashkia Mat). Mirëmbajtja dhe siguria e kontenierëve do të kryhet nga punëmarrësi (A G shpk)ô.

Gjithashtu në nenin 37 të kontratës, specifikimet teknike pika 37.1.2 dhe pika 37.1.3 përcaktohen respektivisht; óShërbimi i grumbullimit, largimit, transportit dhe sistemimit të mbetjeve të ngurta urbaneô si dhe óPlani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeveô



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETQEVERISJES VENDORE RAPORT AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

Në konkluzion, Bashkia Mat nuk i ka siguruar dhe nuk i ka kaluar në përgjegjësi materiale operatorit ekonomik óA Gô shpk kontenierët për realizimin e kontratës, deri në datën 29.06.2019.

Në këtë datë të sipërcituar ka ndodhur këto lëvizje nga magazina e Bashkisë Mat;

Flet Hyrje Materiale 2019

Fatura	Dokumenti	Furnitori	Pershkrim	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlefte	
21-Pri	28.06.2019	Gani Kola	Kazan Plehr	cope	70	28,286	1,979,999	
21-Pri	28.06.2019	Gani Kola	Konteniere	cope	39	27,726	1,081,302	
21-Pri	28.06.2019	Gani Kola	Konteniere	cope	30	16,663	499,896	
21-Pri	28.06.2019	Gani Kola	Konteniere	cope	25	33,552	838,8	4,399,997
398	20.06.2019	Leka 2007	kontinjer mb	cope	17	30	510	
398	20.06.2019	Leka 2007	kontinjer pla	cope	15	24	360	
398	20.06.2019	Leka 2007	kosha mbetu	cope	6	16,8	100,8	970,8

Flet Daljet Materiale 2019

Nr	Date	Klienti	Pershkrim malli,sherbimi,pagese	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlefte	
74	29.06.2019	Shoqeria Anti grup sh.p.	kontinjer mbetje metalike	cope	17	30	510	
74	29.06.2019	Shoqeria Anti grup sh.p.	kontinjer plastike	cope	15	24	360	
74	29.06.2019	Shoqeria Anti grup sh.p.	kosha mbeturinash statik	cope	6	16,800.0	100,800.0	970,800.00
75	29.06.2019	Shoqeria Anti grup sh.p.	kazana plastik	cope	70	28,286	1,979,999	
75	29.06.2019	Shoqeria Anti grup sh.p.	kontinjer	cope	39	27,726	1,081,302	
75	29.06.2019	Shoqeria Anti grup sh.p.	kontinjer	cope	30	16,663	499,896	
75	29.06.2019	Shoqeria Anti grup sh.p.	kontinjer	cope	25	33,552	838,8	4,399,997.30

Praktikisht në këtë datë ka pasur dy fletë hyrje dhe dy flet dalje magazine, të shoqëruara dhe më një autorizim nga një specialist. Me specifikisht;

Nëpërmjet flet hyrjes nr. 21/4 datë 28.06.2019, dorëzohen kontenierët me kosto historike 4,399,997 lekë nga ish përgjegjësi material z. G K, pra nga ish kompania e pastrimit óKô shpk, bëhen hyrje në magazinë dhe me një autorizim në kundërshtim të plotë me ligjin, bëhen direkt dalje dhe i dorëzohen kompanisë óA. Gô shpk. Autorizimi është firmosur nga specialist i furnizimit material-teknik z. A P, në datën 28.06.2019 në kundërshtim të plotë me ligji Nr.10296, datë 08/07/2010, óPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, neni 6 si dhe udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, pika 41 ku citohet;

ónë raste të caktuara sipas nevojave të njësive publike, bëhet dërgimi i aktiveve drejtpërdrejt nga furnizuesi ose dhuruesi te përdoruesi (p.sh direkt në njësinë shpenzuese të njësive publike) dhe bëhen hyrje e dalje pa kaluar në magazinë (psh. në magazinën qendrore të njësive publike). Në këtë rast duhet të miratohen nga Nëpunësi Autorizues i njësive publike procedura të qarta të lëvizjes, të shoqëruara me përgjegjësitë respektive. Veprimet bëhen në prani të punonjësve të ngarkuar me administrimin e aktiveve.

Ky dokument duhet të ishte parashikuar në procedurat e menaxhimit të aktiveve të Bashkisë Mat, si dhe nëse nuk do kishte procedurë për lëvizje të aktiveve pa hyrë në magazinë, cdo hyrje në magazinë duhet të shoqërohej me urdhërin për komisionin e marrjes në dorëzim, miratuar nga titullari, si dhe me relacionin e mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim, në përputhje me pikat 42-50 të udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik.

E njëjta procedurë është ndjekur edhe për lëvizjen e aktiveve me kosto historike 970,800 lekë, të hyra me flet hyrjen nr. 398 datë 20.06.2019, blerë nga Bashkia Mat me procedurë prokurimi nga furnitori Leka 2007, dhe nëpërmjet po të njëjtut format autorizimi të firmosur



nga z.A.P, është mundësuar nëpërmjet flet daljes nr. 75 datë 29.06.2019, dalja e kontenierëve dhe dorëzimi i tyre të kompania e pastrimit óA. Gô shpk.

Në të dyja këto procedura të lëvizjes së aktiveve, përvec të tjerash janë konstatuar dhe mangësi për sa i përket urdhërit të marrjes në dorëzim të aktiveve që duhej të ishte cikluar nga Nëpunësi Autorizues. Për flet hyrjen 21/4 datë 28.06.2019 nga kompania óK Shpkô, nuk egziston një flet dalje e kësaj kompanie që ti bashkangjitej flet hyrjes së sipërcituar, si dhe për flet hyrjen nr. 398 datë 20.06.2019 nuk egziston një flet dalje nga furnitori shoqëria óL Shpkô.

Këto veprime janë ndërmarrë në kundërshtim me pika 42-50, 55 të udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikô.

Për veprimet e lëvizjes së aktiveve në kundërshtim me pikat e sipërcituara të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikô, mbajnë përgjegjësi ish Nëpunësi Autorizues i Bashkisë Mat, z. N. R, z. L.K nën cilësinë e përgjegjëses materiale, si dhe z.A. P për dhënie autorizimi në munges kompetencash ligjore dhe detyre funksionale.

Në konkluzionin, nëpërmjet auditimit të dokumentacionit të lëvizjes së aktiveve të njësisë publike, nga data e lidhjes së kontratës 09.03.2018 deri në datën 29.06.2019, kompania óA Gô shpk nuk ka pasur përgjegjësi materiale dhe nuk ka marrë në dorëzim kontenierët e mëposhtëm me kosto historike 4,399,997 lekë, nëpërmjet të cilëve do të realizohej edhe një nga kushtet e kontratës , pikërisht neni 37 i saj óSpecifikimet Teknikeô pika 37.1 óGrumbullimi dhe Transportimi i Mbetje Urbane dhe Tregjeveô.

Kontenierët që nuk janë marrë në dorëzim deri në datën 29.06.2019

Përshkrim malli,shërbimi,page	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera	Vlera total
Kazan Plehrash	cope	70	28,286	1,979,999	
Kontenierë	cope	39	27,726	1,081,302	
Kontenierë	cope	30	16,663	499,896	
Kontenierë	cope	25	33,552	838,800	4,399,997

Gjithashtu, nga auditimi i dokumentacionit të hyrje daljeve të kontenierëve, është konstatuar gjithashtu një prokurë e posacme përfaqësimi e kompanisë óA Gô shpk. Kjo prokurë me nr. 312 rep, nr.82/2 kol e datës 17.08.2018, protokolluar në Bashkinë Mat me nr.prot, 1044 datë 23.04.2018, pra pak ditë pas nënshkrimit të kontratës për shërbimin e pastrimit në Bashkinë Mat, mes ish Nëpunësit Autorizues z. N. R dhe administratorit të kompanisë óA. Gô shpk z. K. M, ka në thelb të saj përfaqësimin e shoqërisë óA Gô shpk nga përfaqësuesi i posacëm kompania óE lô shpk me administrator z. K K.

Sic citohet, në këtë prokurë kompania óA Gô shpk autorizon që të përfaqësohet nga kompania óE lô shpk, me administrator z. K.K, në marrëdhëniet e saj me Bashkinë Mat për zbatimin e kontratës óPër Shërbimin e Pastrimit të Bashkisë Matô, lidhur me datë 09.03.2018 , si dhe për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për ndjekjen e të gjitha procedurave dhe problematikave që mund të lindin gjatë kësaj kontrate. Githashtu shtohet se kjo prokurë ka kohëzgjatje **deri në marrjen e miratimit paraprak nga Bashkia Mat për lidhjen e kontratës së nënkontraktimit....**

Në aneksin e kontrates së shërbimit të pastrimit, nenin 36 ó Transferimi i të drejtaveô pika 36.1 specifikohet se;

óKontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktorô.

Nëpërmjet prokurës së mësipërme shohim një transferim nga ana e óA Gô shpk të të gjitha detyrimeve kontraktuale deri në momentin që do të ketë një miratim paraprak nga Bashkia Mat për lidhjen e kontratës së nënkontraktimit. Nga të dhënat e Bashkisë Mat, nuk arritëm të identifikonim një marrje miratimi paraprak si dhe vet nënkontraktimin.



Kjo prokurë është hartuar tërësisht në kundërshtim me kontratën e nënshkruar mes óA Gô shpk dhe Bashkisë Mat neni 36 óTransferimi i të drejtaveô pika 36.1.

Gjithashtu transferimi i të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale është bërë në kundërshtim me;

- nenin 61 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikô i ndryshuar,
- nenin 75 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ó Për miratimin e rregullave të prokurimit publikô, i ndryshuar, pasi në DST nuk përcaktohet nënkontraktimi si opsion i pjesmarrjes në tender të kontraktorit óA Gô shpk.

Nisur nga kjo prokurë, edhe hyrjet dhe daljet e kontenierëve të cilat, sic janë referuar më sipër, kanë kaluar nga kompania óKô shpk me administrator z. G K, tek shoqëria óA Gô shpk me administrator z. K M, dhe janë marrë në dorëzim jo nga shoqëria A G shpk, por nga shoqëria përfaqësuese óE 1ô shpk me administrator z. K K.

Z. K K figuron si marrësi në dorëzim i kontenierëve të plehrave të dalë nga magazina e Bashkisë Mat (flet dalja nr. 74 dhe 75 datë 29.06.2019).

Pra, praktikisht kontenierët me kosto historike 4,399,997 lekë dhe në pronësi të Bashkisë Mat, kanë kaluar nga kompania óKô shpk me administrator z. G. K., tek shoqëria óE1ô shpk me administrator z. K.K, lëvizje kjo e mundësuar nëpërmjet flet hyrjes 21/4 datë 28.06.2019 dhe flet daljes nr. 75 datë 29.06.2019 si dhe autorizimit të datës 28.06.2019 firmosur nga z. A.P.

Duke observuar me tej në faqen e QKB, janë konstatuar aktet e themelimit të shoqërive óKô shpk me administrator z. G. K, dhe óE1ô shpk me administrator z. K K. Në statutin e shoqërisë óE 1ô shpk, administrator z. K. K, paraqet të dhënat personale, ku ndër të tjerat evidentohet fakti që është i biri i z. G. K, pra administratorit të shoqërisë óKô shpk. Nga ana tjetër përsëri këto kontenierë, janë mbajtur në ngarkim deri në 29.06.2019 nga kompania óKô shpk, edhe pse është lidhur kontrata me operatorin e ri óA Gô shpk , i cili nga ana e tij, nëpërmjet prokurës së sipërcituar, ka deleguar detyrat tek përfaqësuesi i posacem kompania óE 1ô shpk.

Në situacionet e likujduara gjatë kësaj periudhe, pra nga data 09.03.2018 deri në datën 29.06.2019, janë përzgjedhur 2 praktika likujdimesh për të parë dokumentacionin justifikues.

a-Likujdimi i faturës së shërbimit të pastrimit dhe gjelbërimit me urdher shpenzimin nr.367 datë 18.03.2019.

Është paraqitur fatura tatimore nr.91 datë 01.03.2019 për situacionin nr.2 të pastrimit për periudhën shkurt 2019, si dhe situacionin përkatës në vlerën 1,488,643 lekë.

Në zërat e situacionuar paraqitet edhe zëri óHeqja dhe largimi i mbetjeve dhe transporti nga koshat tek fusha njësia adm. Burrelô në vlerën 490,484 lekë, situacion ky i firmosur nga administrator i kompanisë óA Gô shpk z. K. M, nga specialistja e Bashkisë Mat e cila ka rol monitorimin e kontratës zj. L K, si dhe nga nëpunësi autorizues z. N R. Gjithashtu është hartuar dhe një relacion mujor nga specialistja dhe monitoruesja e kontratës zj. L. K për aktivitetin dhe zbatimin e kontratës nga kompania óA Gô shpk ku specifikohet edhe certifikohet puna e bërë nga OE për grumbullimin transportin e mbeturinave nga kontenierët për në vend depozitimet.

b-Likujdimi i faturës së shërbimit të pastrimit dhe gjelbërimit me urdher shpenzimin nr.625 datë 17.04.2019.

Është paraqitur fatura tatimore nr.110 datë 09.04.2019 për situacionin nr.3 të pastrimit për periudhën mars 2019, si dhe situacioni përkatës në vlerën 1,648,141 lekë.



Në zërat e situacionuar paraqitet edhe zëri òHeqja dhe largimi i mbetjeve dhe transporti nga koshat tek fusha njësia adm. Burrelò në vlerën, situacion ky i firmosur nga administrator i kompanisë òA. Gò shpk z. K.M, nga specialistja e Bashkisë Mat e cila ka rol monitorimin e kontratës zj. L. K, si dhe nga nëpunësi autorizues z. N. R.

Gjithashtu është hartuar dhe një relacion mujor nga specialistja dhe monitoruesja e kontratës zj. L. K për aktivitetin dhe zbatimin e kontratës nga kompania òA. Gò shpk ku specifikohet edhe certifikohet puna e bërë nga OE për grumbullimin transportin e mbeturinave nga kontenierët për në vend depozitim.

Duke parë këto dokumenta justifikues, del në pah se puna e grumbullimit të mbeturinave dhe marrja e tyre nga kontenierët për në vend depozitim, sipas raportit mujor nga Drejtoria e Shërbimeve, është kryer dhe faturuesi ka qenë shoqëria òA. Gò shpk.

Në konkluzion të gjithë sa më sipër u citua, gjendemi përball fakteve si më poshtë:

1. Kontraktuesi i shërbimit të pastrimit të Bashkisë Mat, përpara vitit 2018, ka qenë kompania òKò shpk dhe administrator z. G.K.

2. Kontraktuesi i shërbimit të pastrimit të Bashkisë Mat, nga data 09.03.2018 deri 31.12.2021 ka qenë kompania òA Gò shpk dhe administrator të asaj periudhe z. K.M, si dhe administrator aktual z. B.B. Kjo kompani është përfaqësuar dhe i ka transferuar 100% të detyrimeve kontraktuale nëpërmjet prokurës nr.312 rep, nr.82/2 kol tek kompania òE 1ò shpk dhe administrator z. K K. Ky veprim transferimi është bërë në kundërshtim të plotë me kontratën e lidhur mes Bashkisë Mat dhe kontraktuesit òA Gò shpk (neni 36.1), pasi në kontratë nuk përcaktohet nënkontraktimi, si dhe në kundërshtim me;

- nenin 61 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò i ndryshuar,

- nenin 75 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, pasi në DST nuk përcaktohet nënkontraktimi si opsion i pjesmarrjes në tender të kontraktorit òA Gò shpk.

3. Nga data 09.03.2018 deri 29.06.2019, kontenierët e bashkisë Mat, nuk i janë dorëzuar kontraktuesit òA Gò shpk, megjithëse në situacionet e tyre paraqiten zërat e grumbullimit të mbeturinave dhe marrja e tyre nga kontenierët për në vend depozitim.

4. Në datën 29.06.2019 u janë transferuar kontenierët, me një autorizim të datës 28.06.2019 në kundërshtim me ligjin dhe udhëzimin për ruajtjen e aktiveve, nga kompania òKò shpk me administrator z. G K, tek marrësi në dorëzim z. K.K, ky i fundit administrator i përfaqësueses òE 1ò shpk si dhe i biri i z. G K (referuar statutit të themelimit të shoqërisë).

5. Referuar pikës 3, në popullatën e likuidimeve të faturave të kontraktuesit òA. Gò shpk për shërbimin e pastrimit të Bashkisë Mat nga data 09.03.2018 deri 29.06.2019, është përzgjedhur kampioni prej 2 muaj (shkurt, mars 2019). Në këtë kampion janë konstatuar situacione me zërat e punimeve grumbullimi i mbeturinave dhe marrja e tyre nga kontenierët për në vend depozitim.

6. Në ekstraktin historik të shoqërisë òA. Gò shpk, ekstrakt ky i nxjerrë në datën 04.02.2021 nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në seksionin òVende të tjera të ushtrimit të aktivitetitò, në asnjë rast nuk paraqitet ushtrimi i aktivitetit në territorin e Bashkisë Mat. Gjithashtu kjo kompani nuk rezulton as në regjistrat e biznesit të Bashkisë Mat.

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë;

- ligjin nr.10296, datë 08/07/2010, òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, neni 6 si dhe udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, pika 41,42-50,55.

- ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò i ndryshuar, neni 61.

- VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ò Për miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 75



Ndikimi/Efekti: Kryerja e punëve publike nga OE të cilët nuk paraqesin besueshmëri nëse kjo punë është kryer nga vet OE fitues i prokurimit publik (në rastin tonë shoqëria A G SHPK). Fakti i neglizhencës së Bashkisë Mat se egzistenca e një prokure për delegim detyrash dhe të drejtash që vijnë nga një OE i cili ka kontratë publike me këtë bashki, si dhe fakti i neglizhencës së kësaj bashkie duke mos menaxhuar asetet e shërbimit të pastrimit (kontenierët), ka sjell një impakt të konsiderueshëm në kompromentimin e besueshmërisë së kryerjës së punës publike (shërbimin e pastrimit të Bashkisë Mat) është kryer nga OE A G SHPK.

Shkak: Mos respektimi i ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikó i ndryshuar, neni 61, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ó Për miratimin e rregullave të prokurimit publikó, i ndryshuar, neni 75, papërgjegjshmëria e AK në menaxhimin e aktiveve të veta, si dhe neglizhenca e fakteve të cilat janë të protokolluara në bashki (deklaratat noteriale për delegim të drejtash dhe detyrash).

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat të mmarë masa për ngritjen e një grupi pune për inventarizimin e aktiveve që janë nën përgjegjësinë materiale të Drejtorisë së Shërbimeve, duke përfshirë këtu dhe të gjitha aktivet që i janë dorëzuar shoqërisë A G SHPK. Gjithashtu nga ana e Kryetarit të Bashkisë Mat, të ndërmerren hapa konkretë në evidentimin e kushteve në të cilën ka vepruar dhe ekzekutuar kontratën e shërbimit të pastrimit shoqëria A G SHPK, në raport me AK Bashkia Mat, duke pasur parasysh evidencat që kanë dalë nga auditimi.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi përkatësisht:

- Për veprimet e lëvizjes së aktiveve në kundërshtim me pikat e sipërcituara të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, mbajnë përgjegjësi ish Nëpunësi Autorizues i Bashkisë Mat, z. N. R, z. L. K nën cilësinë e përgjegjësies materiale, si dhe z.A. P për dhënie autorizimi në munges kompetencash ligjore dhe detyre funksionale.

- Për monitorimin e kontratës së shërbimit të pastrimit, bazuar dhe në detyrën funksionale të caktuar më urdherin e brendshëm nr.92 datë 12.03.2018 me përgjegjësinë “supervisor për kontratën me objekt : Shërbimi i Pastrimit në Bashkinë Mat”, mban përgjegjësi zj. L. K.

Pretendimi i subjektit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.53/12 prot., datë 26.04.2022 óMbi Projektraportin e Auditimitó, janë paraqitur observacionet nga Drejtoria Ekonomike dhe Të Ardhurave për sa më poshtë:

Në poqes verbalin e hartuar nga grupi i auditimit janë nxjerrë disa mangësi, ku nga data 09.03.2018 deri në datën 29.06.2019 kontenierët e Bashkisë Mat nuk janë dorëzuar kontraktuesit óA G shpk, megjithëse në situacionet e tyre paraqiten zërat e grumbullimit të mbeturinave dhe marrja e tyre nga kontenierët për në vend depozitim. Ju bëjmë me dije se kontenierët e mbeturinave nuk magazinohen në magazinë pasi janë të shpërndarë nëpër pikat e caktuara me Vendim të Këshillit Bashkiak si dhe janë në shërbim të vazhdueshëm të qytetarëve për hedhjen e mbetjeve. Procedura e inventarizimit si dhe e kalimit të aktiveve (kontenierëve) nga firma Kreshnik shpk tek A. G shpk për shkak se firma K i ka patur në përdorim dhe mirëmbajtje në kuadër të kryerjes së shërbimit të pastrimit për të cilën ishte kontraktuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Në lidhje me sa trajtuar në Projekt Raport dhe sa trajtuar nga ana e juaj në komente, Ju sqarojmë se nuk keni paraqitur asnjë fakt që të ndryshoj ndonjë prej konstatimeve tona. Ajo



cka keni shprehur është një mendim dhe jo fakte..Për këtë arsye observimet tuaja nuk merren në konsideratë.

II.2.4. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

Konkluzion.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së administruar në KLSH me shkresën nr.82 prot., datë 17.01.2022, rezultoi se: Bashkia Mat gjatë procesit të miratimit të kërkesës për heqjen e sipërfaqes nga fondi pyjor dhe kullosor, lidhjes së kontratës së qirasë, si dhe marrjes së masave për rehabilitimin e ekonomisë pyjore dhe kullosore, nuk ka qenë plotësisht transparente dhe nuk ka zbatuar plotësisht kuadrin rregullator përkatës.

Më hollësisht trajtuar në vijim.

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit *óTë ndryshme të dala gjatë auditimitó*, u auditua ankesa e Banorëve të Njesisë Administrative Derjan, Bashkia Mat, me objekt *óShkalla e ndjekjes nga autoritetet publike të përfshira, të kuadrit juridik përkatës lidhur me projektin e HEC-eve Sekë dhe Zais, brenda Parkut Kombëtar Lurë Mali i Dejësó*, dorëzuar në Zyrën e Protokollit të KLSH-së nga shtetasi Dh. K, si dhe administruar në KLSH me shkresën nr.82 prot., datë 17.01.2022.

Dokumentacioni bashkëlidhur ankesës:

- Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit;
- Raporti i Grupit Ndërinstitucional të Punës.

1.Përshkrimi i situatës.

Ankuesit në fjalë janë banorë dhe ish banorë të Njesisë Administrative Derjan, Bashkia Mat. Shqetësimi i ngritur prej tyre lidhet me ndërtimin e HEC Sekë dhe Zais nga subjekti S H, në pellgun ujëmbledhës të Lumit të Urakës dhe Zallit të Melthit. Zona që preket nga ndërtimi i këtyre dy HEC-eve shtrihet pjesërisht në Parkun Kombëtar *óLurë Mali i Dejësó* dhe Parku Kombëtar *óZall Gjoçajó*, në Bashkinë Mat Qarku Dibër dhe në Bashkinë Mirditë Qarku Lezhë.

Më konkretisht Kanali i Derivacionit dhe Vepra e Marrjes së HEC-it Zais (Bashkia Mirditë) shtrihet me gjatësi 2.08 Km në zonën qendrore të zonës së mbrojtur të Parkut Kombëtar *óLurë Mali i Dejësó* (shkresa nr.1044/1 prot., datë 06.09.2019 e AKZM).

2.Veprimet e institucioneve të përfshira në këtë proces, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë, mbështetur në dokumentacionin e administruar në Bashkinë Mat, bashkëlidhur ankesës, si dhe në faqet zyrtare të institucioneve përkatëse.

-Kontrata e Koncesionit nr.7030 REP., nr.2134 KOL, datë 12.06.2013, e formës BOT (Ndërtim-Operim-Transferim) ndërmjet ish-Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, aktualisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Bashkimit të Operatorëve *óH-Pô shpk* dhe *óG 2ô shpk*, për ndërtimin, operimin dhe transferimin e HEC Sekë, në përfundim të afatit 35 vjeçar.

-Me shkresën nr.257/2 prot., datë 13.03.2014 nga Autoriteti Kontraktues, aktualisht MIE, është dërguar për oponencë teknike pranë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, projekti i zbatimit për ndërtimin e HEC-it Sekë.

-Me shkresën nr.2489 prot., datë 09.03.2016 është përcjellë oponenca teknike e AKBN-së në MIE.

-Me shkresën nr.1881/3 prot., datë 26.04.2017 Autoriteti Kontraktues ka miratuar oponencën teknike.



- Kontratë shtesë nr.2247 REP., nr.1095 KOL., datë 18.08.2017, për ndryshimin e kontratës bazë të koncesionit, lidhur ndërmjet ish Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, aktualisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe subjektit S H, duke bërë ndryshimin si vijon: Hidrocentrali Sekë do të quhet Hidrocentrali Sekë dhe Zais, si dhe parashikimet përkatëse që vijnë si rrjedhojë e ndryshimit të sipërcituar.
- Kërkesë për dhënie mendimi nr.983 prot., datë 03.08.2017, drejtuar Bashkisë Mat nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Qarku Dibër, për ndikimin në mjedis të projektit në fjalë.
- Kthim përgjigje nr.1948 prot., datë 03.08.2017, nga Bashkia Mat drejtuar DRM Dibër, për shprehjen e dakortësisë për vazhdimin e procedurave të mëtejshme.
- Pas veprimeve të mësipërme, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) me Vendimin nr.34, datë 07.09.2017 ka vendosur që projekt i HEC-eve të nënshtrohet vlerësimit të ndikimit të thelluar në mjedis. Në këtë vendim, AKM parashtroi si arsye për kryerjen e vlerësimit të ndikimit të thelluar, ndër të tjera: óBazuar në koordinatat e dhëna, mund të ndikojë në monumentin e natyrës Kanioni i Urakës. Është e nevojshme të merret mendimi i administratës së zonave të mbrojtura AKZMô.
- Vendimi nr.177, datë 05.09.2017 i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, për miratimin e raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor për projektin e ndërtimit të dy HEC-eve.
- Vendimi nr.248, datë 09.09.2017 i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, ku është vendosur miratimi i projektit të ndërtimit të HEC Sekë dhe Zais.
- Marrëveshje për lidhjen me rrjetin e transmetimit me nr. 4899 Prot, datë 12.09.2017, të lidhur midis S H dhe shoqërisë OST sh.a., për HEC nët Sekë dhe Zais të cilët do të lidhen në rrjetin 110 kV të transmetimit nëpërmjet një trakti transformatori 110 kV në N/Stacionin 110/6.3 kV HEC Prellë.
- Me shkresën nr.493 prot i Bashkisë Mat., datë 23.10.2017, si dhe nr.18 prot., datë 23.10.2017 i subjektit, nga ky i fundit është kërkuar në Bashkinë Mat marrjen në përdorim të fondit pyjor/kullosor.
- Me shkresën nr.3163 prot., datë 22.12.2017 subjekti S H ka kërkuar në Bashkinë Mat marrjen në përdorim të fondit pyjor/kullosor.
- Me shkresën nr.1245 prot., datë 19.12.2017 subjekti S H i është drejtuar AKZM për dhënien e mendimit për zonën ku do të ndërtohet projekti.
- Me urdhrin nr.638, datë 27.12.2017 ish Kryetari i Bashkisë Mat ka ngritur grupin e punës për hartimin e raportit tekniko-ekonomik për HEC Sekë dhe Zais.
- Kontratë qiraje nr.83, datë 10.01.2018 ndërmjet Bashkisë Mat, përfaqësuar nga ish Kryetari i Bashkisë z.N R dhe qiramarrësit Seka H sha me Objekt të kontratës: Fond pyjor/kullosor me qira në ekonominë pyjore Derjan 1 dhe 2 dhe Mbasdeje, me afat 6 vite.
- Shkresa nr.1245/3 prot., datë 23.01.2018 drejtuar subjektit S H nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, me mbishkrimin: Sipas planvendosjes dërguar nga ju, ku pasqyrohet gjurma e projektit me ndryshimet e kërkuara, konstatojmë se sipërfaqja e cila kërkohet për ndërtimin e HEC-it, ndodhet jashtë sistemit të zonave të mbrojtura dhe jashtë zonës buferike të Monumentit të Natyrës óKanioni i Urakësô;
- Kërkesë për dhënie mendimi nr.169 prot., datë 01.03.2018, drejtuar Bashkisë Mat nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Qarku Dibër, për ndikimin në mjedis të projektit në fjalë.
- Kthim përgjigje nr.622 prot., datë 06.03.2018, nga Bashkia Mat drejtuar DRM Dibër, për shprehjen e dakortësisë për vazhdimin e procedurave të mëtejshme, si dhe kërkohet nga zhvilluesi i projektit S H, kryerja e konsultimeve me komunitetin për ndërtimin e HEC Sekë dhe Zais.
- Deklarata Mjedisore miratuar me Vendimin nr.33, datë 19.07.2018, lëshuar nga AKM për subjektin, për të zhvilluar projektin e ndërtimit të HEC Sekë dhe Zais.
- Leje për përdorim të burimit ujor me nr. 179 Prot, datë 17.09.2018;



- Dhënie mendimi datë 29.10.2018, nga Bashkia Mat drejtuar Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, për dakortësinë në zhvillimin e projektit óLeje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m², për HEC Sekë dhe Zais.
- Vendimi nr.16, datë 03.10.2018 i Këshillit Kombëtar të Territorit për miratimin e lejes së ndërtimit për dy HEC e mësipërme;
- VKM Nr. 661, datë 31.10.2018 óPër zgjerimin e sipërfaqes së Parkut Kombëtar óLurëo dhe krijimin e Parkut Kombëtar óLurëoMali i Dejës.
- Shkresa nr.8391 prot., datë 03.12.2018 drejtuar Bashkisë Mat nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ku kërkohet raporti tekniko-ekonomik për sipërfaqen pyjore/kullosore që preket nga ndërtimi i godinës së HEC-it.
- Shkresa nr.95 prot., datë 15.01.2019 drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nga Bashkia Mat, bashkëlidhur raportin teknik, VKB nr.110, datë 20.12.2018 për miratimin e vazhdimit të procedurës për heqjen e fondit pyjor/kullosor, konfirmimin e VKB, nga Prefekti i Qarkut Dibër nr.2016/1 prot., datë 24.12.2018.
- Shkresa nr.1308/2 prot., datë 15.02.2019 drejtuar Bashkisë Mat dhe Mirditë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, bashkëlidhur së cilës është Urdhri nr.25, datë 07.02.2019 óPër heqjen nga fondi pyjor publik dhe zvogëlimin në volum të sipërfaqes prej 0.618 Ha në Ekonomitë Pyjore óDerjan 2o dhe óMbasdejeo të Bashkisë Mat, si dhe në Ekonomitë Pyjore óKunor Valmoró dhe óSelitëo të Bashkisë Mirditë, për ndërtimin e HEC-eve.
- Akt marrëveshja nr.684 prot., datë 13.03.2019 ndërmjet Bashkisë Mat dhe subjektit S. H. për rehabilitimin nëpërmjet pyllëzimit të sipërfaqes që është hequr nga fondi pyjor/kullosor, si dhe vërtetimi nr.775 prot., datë 26.03.2019 i lëshuar nga Bashkia Mat për rehabilitimin e sipërfaqes pyjore.
- Kërkesa nr.1921 prot., datë 16.07.2019 e bërë nga Komuniteti i Zall Gjocaj, Gjocaj, Dukagjin, Rukaj, Derjan, Macukull, Urzallë dhe Barbullej, drejtuar Bashkisë Mat, për projektin e HEC-eve dhe raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, si dhe kthim përgjigje nga Bashkia Mat me shkresën nr.1921/1 prot., datë 25.07.2019, ku shprehet se dokumentacioni administrohet nga Këshilli Kombëtar i Territorit.
- Shkresa nr.1044/1 prot., datë 06.09.2019 nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, e cila referon se: órreth 2.08 Km gjatësi të kanalit të derivacionit dhe vepra e marrjes së ujit për HEC-in ndodhet brenda zonës së mbrojtur të Parkut Kombëtar óLurë Mali i Dejës.
- Urdhëri i Përbashkët në datën 22.10.2019 i Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit për "Ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Verifikimin e Problematikave të Ngritura nga Banorët e Zonës për Ndërtimin e HEC-it Sekë dhe Zais". Grupi i kryesuar nga përfaqësuesi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe në përbërje të të cilit ishin edhe përfaqësues të MIE, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Lezhë dhe asaj Dibër që kanë nën administrim zonën ku do të ndërtohet ky HEC, si dhe një përfaqësues i Zyrës së Administrimit të Burimeve Ujore për Basenin Ishëm në Erzen në Mat.
- Vendimi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 146, datë, 10.09.2020 óMbi licencimin e shoqërisë óS Hó sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et óSekëo me kapacitet të instaluar 12667 kë dhe óZaisó, me kapacitet të instaluar 2295 kë, me kapacitet total të instaluar 14962 kë;
- Shkresa nr.K1/I 47-4 prot., datë 28.06.2021 drejtuar Bashkisë Mat nga Avokati i Popullit, për vendosje në dispozicion të dokumentacionit.
- Kthim përgjigje nr.2972/1 prot., datë 05.07.2021 drejtuar Avokatit të Popullit nga Bashkia Mat, për vendosje dokumentacioni në dispozicion.



-Cështja administrative nr.14238 datë 09.04.2021 në Gjykatën Administrative të Apelit, padia e ngritur ndaj Entit Rregullator të Energjisë dhe Shoqërisë S. H. shpk. Objekti i padisë: Shfuqizimi i vendimit nr.146, datë 10.09.2020 mbi licencimin e shoqërisë S. H. shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike në HEC-et Sekë me kapacitet 12667 kë dhe Zais me kapacitet 2295 kë, në total kapaciteti i instaluar 14962 kë.

-Vendimi nr.559, datë 10.11.2021, i Gjykatës Administrative të Apelit, ku është lënë në fuqi Vendimi nr.49, datë 18.01.2021 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, si vijon:

- a) Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësit B.P, etj.
- b) Shfuqizimin e pjesshëm të aktit administrativ Vendim nr.146, datë 10.09.2020 të ERE për licencimin e shoqërisë S H shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC mbi Zais me kapacitet 2295 kë.
- c) Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit të kërimit si të pabazuar në ligj dhe në prova.
- d) Refuzimin e kërkesës për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm si të pabazuar në ligj dhe në prova.
- e) Ky vendim është titull ekzekutiv në zbatim të nenit 510/a të K.Pr.Civile, për pjesën e shpenzimeve gjyqësore dhe është drejtpërdrejtë i ekzekutueshëm nga Shërbimi Përmbarimor shtetëror/privat, nga data që ky vendim merr formë të prerë.
- f) Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar dhe në lidhje me rrëzimin e kërkesës për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm lejohet ankim i vecantë brenda 5 ditëve, po nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

-Kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ka bërë ankim pala e paditur dhe Avokatura e Shtetit. Pala paditëse B. P, më datë 22.02.2021, ka paraqitur kundërankim ndaj ankimeve të ushtruara nga palët më sipër, me objekt: mbi Shfuqizimi i vendimit nr.146, datë 10.09.2020 mbi licensimin e shoqërisë S. H shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike në HEC-et Sekë me kapacitet 12667 kë dhe Zais me kapacitet 2295 kë, në total kapaciteti i instaluar 14962 kë.

3.Vlerësimi i grupit të auditimit të situatës së mësipërme dhe veprimeve/mosveprimeve të Bashkisë Mat në këtë procedurë.

-Si fillim për çështjen në fjalë ka dalë Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në të cilët është trajtuar gjerësisht veprimtaria e Entit Rregullator të Energjisë, në licensimin e Shoqërisë S H për prodhimin e energjisë elektrike në HEC Sekë dhe Zais. Në këto dy aktet e mësipërme të Gjykatave respektive është pranuar pjesërisht padia e banorëve të Njesisë Administrative Derjan, duke shfuqizuar vendimin e ERE-s vetëm për licensimin prodhimit të energjisë elektrike në HEC Zais, si dhe rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj, pra të shfuqizimit të plotë të vendimit të ERE-s për licensimin e Shoqërisë S H në prodhimin e energjisë elektrike në HEC Sekë dhe Zais.

-Sa më sipër, grupi i auditimit, bazuar në objektin dhe subjektin e auditimit (pra Bashkia Mat), si dhe vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, vlerëson dhe gjykon se nuk mund të shprehet mbi vendimmarrjen e organeve të pushtetit gjyqësor.

3.1.Mbi veprimet dhe mosveprimet e Bashkisë Mat në procedurën e mësipërme për pjesën takuese të saj.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se:

Titulli i Gjetjes:Mbi shqyrtimin e ankesës së banorëve të NJA Derjan, mbi ndërtimin e HEC Sekë dhe Zais.



Situata: Gjatë procesit të vendimmarrjes së Këshillit të Bashkisë Mat, finalizuar me VKB nr.110, datë 20.12.2018, për miratimin e kërkesës për heqjen nga fondi pyjor dhe kullor sipërfaqes së kërkuar nga subjekti S H, nuk është marrë asnjë masë për pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes, si dhe të kryerjes së seancave të këshillimit me publikun, duke përdorur një nga format e nevojshme, si takimet e hapura me banorët e grupet e interesit, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata jofitimprurëse ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore. Për kryerjen e veprimeve të mësipërme është shprehur edhe Prefekti i Qarkut Dibër, në konfirmimin e ligjshmërisë së VKB nr.110, datë 20.12.2018, ku citohet shprehimisht: *“Për më tepër kujtojmë se vendimmarrje të tilla nuk mund ti shmangen detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 18 të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, për realizimin paraprakisht të dëgjësive me komunitetet përkatëse në territoret e të cilëve ndodhen sipërfaqet e ngastrave që do të hiqen nga fondi pyjor dhe kullor, pasi siç dihet mosrespektimi i kërkesave të tilla në mjaft raste shoqërohet me konflikte mes palëve”.*

-Nuk ka gjetur zbatim shkronja ócô e pikës 2 në Urdhrin nr.25, datë 07.02.2019 të Ministrit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ku përcaktohet:

2.Strukturat përgjegjëse për pyjet në Bashkinë Mat dhe Mirditë, në prani të përfaqësuesve të shoqërisë S H shpk, duhet:

c.Të monitorojnë rehabilitimin dhe pyllëzimin e sipërfaqes sipas **marrëveshjes ndërmjet bashkisë dhe shoqërisë ndërtuese.**

Sa më sipër në dosjen përkatëse **nuk administrohet një marrëveshje e tillë**, por administrohet një marrëveshje tjetër nr. 684 prot., datë 13.03.2019 ndërmjet Bashkisë Mat dhe subjektit S H për rehabilitimin nëpërmjet pyllëzimit të sipërfaqes 0.1327 Ha në ngastrën nr.220 Ekonomia Pyjore Komsi, ndërkohë që HEC Sekë dhe Zais, sa i përket territorit administrativ të Bashkisë Mat, shtrihen në ekonominë pyjore Derjan 2 dhe Mbasdeje, **pra në asnjë rast në ekonominë pyjore Komsi.** Për më tepër në dosje nuk administrohet procesverbali i marrjes në dorëzim të punimeve të pyllëzimit, por administrohet vërtetimi nr.775 prot., datë 26.03.2019 i lëshuar nga Bashkia Mat, nënshkruar nga ish Kryetari i Bashkisë z.N. R, i cili është shprehur: Shoqëria S H ka realizuar detyrimin sipas akt-marrëveshjes nr.684 prot., datë 13.03.2019 për rehabilitimin nëpërmjet pyllëzimit të fondit pyjor.

-Pra sa më sipër arrihet në përfundimin se nuk është lidhur akt-marrëveshje me shoqërinë S. H. për rehabilitimin e fondit pyjor dhe kullor të hequr, me qëllim mbrojtjen dhe rehabilitimin e fondit pyjor, sipas raportit për 1 pemë trungishte të prerë të mbillen 3 të tilla/1 pemë cungishte të prerë të mbillen 3 të tilla, si dhe vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Mat, krijon dyshimin e arsyeshëm se është një dokument fiktiv.

-Bashkia Mat përfaqësuar nga ish Kryetari i Bashkisë z.N R, nuk ka respektuar detyrimin për të drejtën e informimit, sipas kërkesës nr.1921 prot., datë 16.07.2019 e bërë nga Komuniteti i Zall Gjocaj, Gjocaj, Dukagjin, Rukaj, Derjan, Macukull, Urzallë dhe Barbullej, drejtuar Bashkisë Mat, për vendosjen në dispozicion të projektit të HEC-eve dhe raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis. Bashkia Mat me shkresën nr.1921/1 prot., datë 25.07.2019, është shprehur se, dokumentacioni administrohet nga Këshilli Kombëtar i Territorit, ndërkohë që raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis ka qenë administruar në dosjen përkatëse, pasi është përcjellë nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Qarku Dibër me shkresën nr.983 prot., datë 03.08.2017, drejtuar Bashkisë Mat, për dhënie mendimi. Po kështu edhe projekti teknik i HEC-it, i cili i është vendosur në dispozicion Bashkisë Mat nga Shoqëria S H shpk, me shkresën nr.493 prot., datë 23.10.2017, në të cilën Shoqëria në fjalë ka kërkuar marrjen në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik.

-Nga Bashkia Mat përfaqësuar nga ish Kryetari i Bashkisë z.N R, nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në shkronjën ófô të pikës 24 në Udhëzimin nr.1, datë 09.06.2016 óPër



rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik, të Ministrit të Mjedisit, ku përcaktohet:

24. Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria që zotëron lejen/licencën përkatëse përbëhet nga:

f) lejen e ndërtimit;

Në kohën që është shqyrtuar kërkesa e subjektit S H dhe më pas lidhja e kontratës së qirasë nr.83 prot., datë 10.01.2018, nuk ka qenë e miratuar leja e ndërtimit për HEC në fjalë, **përkundrazi ajo është miratuar më datë 03.10.2018**. Ndodhur në këto kushte kërkesa për marrjen në përdorim të fondit pyjor duhej të ishte kthyer për plotësim dokumentacioni, si dhe në rast se nuk plotësohej, atëher të refuzohej kërkesa e subjektit nga Bashkia Mat.

Kriteri: Pikën 3 të nenit 2, pikën 2 të nenit 4, pikën 1 të nenit 16, pikat 1 dhe 2 të nenit 18, pikën 9 të nenit 23, pikën 1 të nenit 26, pikat 5 dhe 6 të nenit 27, shkronjën ógjô të nenit 64, në Ligjin nr.139/2015 óPër Vetëqeverisjen Vendore, i ndryshuar.

Pikën 13 të nenit 2, pikat 2, 3 dhe 4 në nenin 20, pikën 5 të nenit 21, pikën 2 të nenit 22, pikën 1 të nenit 27/6 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 óPër Pyjet dhe Shërbimin Pyjor, i ndryshuar në fuqi në periudhën kur është shqyrtuar kërkesa dhe është lidhur kontrata e qirasë për fondin pyjor dhe kullor.

Pikat 2 dhe 3 të nenit 3, shkronjën óaô të pikës 2 të nenit 14 në Ligjin nr.119/2014 óPër të drejtën e informimit.

Nenin 6 në Ligjin nr.146/2014 óPër njoftimin dhe konsultimin publik.

Pikën 1 të nenit 7, nenin 8, shkronjën óaô të pikës 1 të nenit 9, pikën 3 të nenit 11, nenin 12, shkronjën óbô të pikës 1 të nenit 19 në Ligjin nr.10431, datë 09.06.2011 óPër mbrojtjen e mjedisit, i ndryshuar.

Shkronjën ócô të pikës 2 në Urdhrin nr.25, datë 07.02.2019 të Ministrit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit óPër heqjen nga fondi pyjor publik dhe zvogëlimin në volum të sipërfaqes prej 0.618 Ha në Ekonomitë Pyjore Derjan 2, Mbasdeje të Bashkisë Mat, si dhe në Ekonomitë Pyjore Kunor Valmor dhe Selitë të Bashkisë Mirditë, për ndërtimin e HEC-eve Seka dhe Zais, nga Shoqëria S H.

Shkronjën ófô të pikës 24 në Udhëzimin nr.1, datë 09.06.2016 óPër rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik, të Ministrit të Mjedisit.

Shkronjat ócô, ójô, ómô, ónô të pikës 2 në nenin 49 óDetyrat dhe të Drejtat e Sekretarit të Këshillit Bashkiak të Rregullores së Brendshme të Këshillit të Bashkisë Mat, miratuar me Vendimin nr.96, datë 10.08.2020.

Pika 10 e nenit 3 dhe pika 2 në nenin 18 të Ligjit nr. 68/2017 óPër financat e Vetëqeverisjes Vendore.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e transparencës së Bashkisë Mat përballë grupeve të interesit, si dhe mungesa e mbrojtjes së fondit pyjor, nëpërmjet masave për ripyllëzimin e tij.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mat, të marrë masat e nevojshme duke ngritur një grup pune me specialist të fushës, të cilët të kryejnë verifikimin në terren dhe vlerësimin e druve të prerë në ekonominë pyjore Derjan 2 dhe Mbasdeje, nga punimet për ndërtimin e HEC Sekë dhe Zajs, si dhe lidhjen e akt-marrëveshjes me subjektin óS Hô për ripyllëzimin e fondit pyjor.

-Sa më sipër mbajnë përgjegjësi ish Kryetari i Bashkisë z.N. R, z.A D ish Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës, z.V S, ish Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pyjeve, si dhe zj.E P Sekretar i Këshillit të Bashkisë Mat.



Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.53/13 prot., datë 28.04.2022 mbi Projektraportin e Auditimit, janë paraqitur observacionet nga z.V S për sa më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

V S: Në lidhje me akt-verifikimin nr.1, mbi procedurën e dhënies me qira të fondit pyjor për ndërtimin e HEC Sekë dhe Zais, nga ish Kryetari i Bashkisë Mat ka ngritur grupin e punës për hartimin e raportit teknik, është lidhur akt-marrëveshja me subjektin që ka marrë me qira sipërfaqen pyjore, si dhe janë marrë në dorëzim punimet në ripyllëzimin e sipërfaqes pyjore të hequr nga fondi pyjor.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Lidhur me pretendimin si më sipër, si fillim sqarojmë se në observacionin përkatës keni bashkëlidhur dokumente të cilat nuk lidhen me objektin dhe çështjet e trajtuara. Pra ju keni bashkëlidhur raportin teknik, dokument për të cilin nuk jemi shprehur në asnjë moment. Ju keni bashkëlidhur akt-marrëveshjen për ripyllëzim, ndërkohë që grupi i auditimit këtë akt-marrëveshje e ka cituar në çështjen përkatëse dhe është shprehur se, nuk i përket ekonomive pyjore në të cilat është bërë heqja e fondit pyjor. Ju jeni ngarkuar me përgjegjësi për akt-marrëveshjen që duhej lidhur për ripyllëzimin e ekonomive pyjore përkatëse.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë:

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave në përgatitjen e PBA të hartuara gjatë periudhës 2019-2021, u konstatua se:

-Për PBA 2019-2021 dhe PBA 2021-2023 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Mat;

-Për PBA 2019-2021 dhe buxhetin vjetor 2019, Kryetari i Bashkisë Mat nuk ka marrë masat për të përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin e Bashkisë, kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 1 të nenit 33 të Ligjit nr. 68/2017 óPër financat e Vetëqeverisjes Vendore;

-Nuk administrohet dokumenti përfundimtar i PBA për periudhën 2019-2021, por në dosje administrohet vetëm VKB nr.34, datë 18.05.2018 për miratimin e tavanëve përgatitore për PBA 2019-2021, i cili nuk ka dalë në përputhje me përcaktimin e bërë pikën 6 të nenit 34 në Ligjin nr.68/2017 óPër financat e Vetëqeverisjes Vendore;

-Për PBA 2019-2021, Kryetari i Bashkisë Mat nuk ka marrë masat për të përgatitur dhe paraqitur për miratim në Këshillin e Bashkisë, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 1 të nenit 37 të Ligjit nr. 68/2017 óPër financat e Vetëqeverisjes Vendore;

-Për PBA 2019-2021, 2020-2022 dhe 2021-2023 nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;

-Buxheti vjetor i vitit 2019, nuk është miratuar brenda datës 25.12.2018, por është miratuar më datë 04.01.2019 me VKB nr.3, pra jashtë afatit;

-Për PBA 2019-2021 nga Kryetari i Bashkisë nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik, strukturë e cila është përgjegjëse për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të integruar të planifikimit brenda njësisë së vetëqeverisjes vendore;

-Procedura e përgatitjes së PBA 2019-2021 nuk dokumentohet plotësisht, pasi në dosjen përkatëse të PBA, nuk administrohet dokumentacioni mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Mat, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore



përkatëse, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjat óa-hô të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 óPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetqeverisjes vendore, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 óPër pyjetó. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Mat.

1.2. Rekomandimi: Për çdo vit buxhetor të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Mat.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave për investime të Bashkisë Mat, financiar nga Ministritë e Linjës, konstatohet se, në 3 raste në vlerën 2,247,632,489 lekë, janë ndërmarrë angazhime buxhetore duke lidhur kontratë me operatorë ekonomik, për investime në punë publike, pa pasur në dispozicion fondet e plota për realizimin e kontratës. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 1, 9, 10, 14 dhe 38 të nenit 3, nenin 40, nenin 50, nenin 51 në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 óPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; Pikën 2 të VKM nr. 807, datë 16.11.2016 óPër disiplinimin e angazhimeve buxhetore, i ndryshuar; Nenin 70 dhe nenin 76 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar; Pikat 81, 142, 155, 165 në Udhëzimin nr.9, datë 20.03.2018 óPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të marrë masat e nevojshme në mënyrë që lidhja e kontratës me operatorët ekonomik të bëhet vetëm pasi fondi i nevojshëm sipas vlerës së kontratës, të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor. Për çdo rast të angazhimeve buxhetore, kryesisht të investimeve për punë publike, Nëpunësi Zbatues të japë opinion me shkrim, për fondin buxhetor që është i disponueshëm për lidhjen e kontratës përkatëse.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit të procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli, konstatohet se niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet në nivele të ulta në vitin 2019, konkretisht në masën 75%, në vitin 2020 duke ardhur me një rritje të tyre në masën 91%, si dhe duke vijuar me vitin 2021 në masën 88%. Kjo situatë vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se, nga Bashkia Mat në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore. Gjithashtu planifikimi i procedurave të prokurimeve nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën óa në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 óPër financat e vetqeverisjes vendore; Nenin 47 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 óPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të marrë masa që planifikimi i fondeve për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave në vitin paraardhës dhe jo të planifikimit të tyre.

**Në vijimësi**

4. Gjetje nga auditimi: Përgjatë periudhës 2020-2021 konstatohet se në 5 raste Bashkia Mat ka ndërmarrë angazhime të reja buxhetore pas datës 15 tetor, me vlerë totale 32,323,128 lekë, duke hyrë në marrëdhënie kontraktuale me operator ekonomik, për kryerjen e punimeve publike të ndryshme. Veprime e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 51 në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 óPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të marrë masat e nevojshme që të eliminohet praktikat e ndërmarrjes së angazhimeve buxhetore përtej afatit ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacion shoqëruar në Degën e Thesarit Mat, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 2019-2021 ky afat nuk është respektuar në 563 raste për vlerën 279,939,309 lekë. Në fund të vitit 2021 detyrimi progresiv i Bashkisë Mat ndaj palëve të treta është në vlerën 316,892,067 lekë, nga të cilat krijuar brenda vitit 2021 gjithsej 57 fatura për shpenzime për mallra, shërbime dhe investime në vlerën 309,026,173 lekë. Stoku i detyrimeve të prapambetura, pra për fatura të cilat nuk janë likuajduar brenda 60 ditëve kalendarike dhe vendimet gjyqësore, është në vlerën 32,115,797 lekë²⁷. Në krahasim me vitin 2020 kemi rritje të stokut të detyrimeve të prapambetura në vlerën 16,447,779 lekë. -Gjithashtu sa i përket likuidimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, u konstatua se, në 6 raste nuk është respektuar rradha e likuidimit të tyre, pra detyrimi i parë likujdohet më parë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 óPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të marrë masa për:

-Sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përgjashtuar kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë dhe duke respektuar rradhën e likuidimit sipas parimit óhyrje e parë ñ dalje e parë.

-Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i procedurës së ndjekur nga Bashkia Mat në marrëdhënien kontraktore me subjektin S. H., heqjen e fondit pyjor, lidhjen e kontratës së qirasë, etj, iniciuar nga ankesa e banorëve të NJA Derjan, mbi ndërtimin e HEC Sekë dhe Zais, administruar në KLSH me shkresën nr.82 prot., datë 17.01.2022, u konstatua se:

-Gjatë procesit të vendimmarrjes së Këshillit të Bashkisë Mat, finalizuar me VKB nr.110, datë 20.12.2018, për miratimin e kërkesës për heqjen nga fondi pyjor dhe kullor të sipërfaqes së kërkuar nga subjekti S H, nuk dokumentohet kryerja e seancave të konsultimit me publikun;

²⁷Llogaria 467 dhe 401-408.



-Nuk është lidhur marrëveshje ndërmjet Bashkisë Mat dhe subjektit S H për ripyllëzimin e fondit pyjor dhe kullësor të hequr, me qëllim mbrojtjen dhe rehabilitimin e tij, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën ôcô të pikës 2 në Urdhrin nr.25, datë 07.02.2019 të Ministrit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ku përcaktohet:

-Bashkia Mat përfaqësuar nga ish Kryetari i Bashkisë z.N R, nuk ka respektuar detyrimin për të drejtën e informimit, sipas kërkesës nr.1921 prot., datë 16.07.2019 e bërë nga Komuniteti i Zall Gjocaj, Gjocaj, Dukagjin, Rukaj, Derjan, Macukull, Urzallë dhe Barbullej, drejtuar Bashkisë Mat, për vendosjen në dispozicion të projektit të HEC-eve dhe raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis;

-Bashkia Mat përfaqësuar nga ish Kryetari i Bashkisë z.N R, ka lidhur kontratë qiraje për shfrytëzimin e fondit pyjor dhe kullësor, për ndërtimin e HEC-it, para se subjekti S H, të pajisej me leje ndërtimi, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën ôfô të pikës 24 në Udhëzimin nr.1, datë 09.06.2016 ôPër rregullat, procedurat e kërkit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publikô, të Ministrit të Mjedisit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 3 të nenit 2, pikën 2 të nenit 4, pikën 1 të nenit 16, pikat 1 dhe 2 të nenit 18, pikën 1 të nenit 26, pikat 5 dhe 6 të nenit 27, shkronjën ôgjô të nenit 64, në Ligjin nr.139/2015 ôPër Vetëqeverisjen Vendoreô, i ndryshuar; Pikën 13 të nenit 2, pikat 2, 3 dhe 4 në nenin 20, pikën 2 të nenit 22, pikën 1 të nenit 27/6 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 ôPër Pyjet dhe Shërbimin Pyjorô, i ndryshuar në fuqi në periudhën kur është shqyrtuar kërkesa dhe është lidhur kontrata e qirasë për fondin pyjor dhe kullësor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 132-135, të Raportit të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi:Kryetari i Bashkisë Mat, të marrë masat e nevojshme duke ngritur një grup pune me specialist të fushës, të cilët të kryejnë verifikimin në terren dhe vlerësimin e druve të prerë në ekonominë pyjore Derjan 2 dhe Mbasdeje, nga punimet për ndërtimin e HEC Sekë dhe Zajs, si dhe lidhjen e akt-marrëveshjes me subjektin ôS Hô për ripyllëzimin e fondit pyjor.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se objektet, inventar i pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 800,075,612 lekë, nuk janë pajisur plotësisht me titull pronësie, konkretisht sipas llogarive paraqiten si më poshtë:

-llog 210 ôToka troje terreneô, elementë në vlerën neto 27,399,128 lekë

-llog. 211 ôPyje plantacioneô, elementë në vlerën neto 10,550,203 lekë,

-llog. 212 ôNdërtesa e konstruksioneô, 103 objekte me vlerën neto 762,126,281 lekë

-Për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 2 të nenit 6 në Ligjin nr.8743, datë 22.02.2001 ôPër pronat e paluajtshme të shtetitô, i ndryshuar.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 118-132, të Raportit të Auditimit).*

7.1 Rekomandimi:Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Sektorin Juridik të marrë masat e nevojshme dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të përlllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Menjëherë



8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se shtesa në tabelën e gjendjeve të ndryshimit të aktiveve afatgjata materiale për llogarinë 213 óRrugë, rrjete, vepra ujoreô, ka qenë në vlerën 185,352,032 lekë, ndërsa sipas dokumentacionit shoqërues në urdhër-shpenzimet e verifikuara në ditarët e bankës, disa prej faturave të sipërcituara nuk përbëjnë rritje aktivi sepse projekti përkatës në fund të vitit 2020 nuk ishte mbaruar si investim dhe nuk ishte marrë në dorëzim, që do të thotë është një investim në proces. Pra shpenzimi kapital duhet të ishte regjistruar në llogarinë 231 óShpenzime për rritjen e AAGJMô, specifikisht si më poshtë;

-Për vitin 2020: në llogarinë 231 óShpenzime për rritjen e AAGJMô për shumën 185,352,032 lekë dhe jo në llogarinë e aktivit 213 óRrugë, rrjete, vepra ujoreô. Theksojmë se jo çdo shpenzim investimi mund të kapitalizohet në aktivin përkatës për të cilin po bëhet investimi, dhe në rastin tonë janë ndërtesat dhe konstruksionet si dhe rrugët dhe veprat ujore. Vetëm shpenzimet kapitale të cilat janë situacione përfundimtare dhe për të cilat është marrë në dorëzim objekti, atëherë kapitalizohet e gjithë vlera e tij të llogaria e aktivit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën ódô pika 2.1 óTrajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2ô, në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeô, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 118-132, të Raportit të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë 213 óRrugë, rrjete, vepra ujoreô përkatësisht për shumat 185,352,032 lekë për vitin 2020, me mbylljen e bilancit kontabël të vitit të ardhshëm.

Me mbylljen e bilancit kontabël të vitit të ardhshëm

9. Gjetje nga auditimi: Llogaria 202 óStudime dhe Kërkimeô paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën neto 30,066,269 lekë ndërsa në fund të vitit 2019 në vlerën neto 22,122,269 lekë. Diferenca në rritje vjen për shkak të 5 projekteve infrastrukturore me vlerë 7,944,000 lekë. Sipas inventarit kontabël, gjendja e kësaj llogaritje është në vlerën neto 30,066,269 lekë dhe përbëhet nga 19 projekte për investime të kryera, nga të cilat 12 prej tyre nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik, si dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën ódô pika 2.1 óTrajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2ô, në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeô, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 118-132, të Raportit të Auditimit).*

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin në kontabilitet për kalimin e vlerës së atyre projekteve për të cilat investimi ka mbaruar (specifikisht ato projekte të trashëguara nga ish komunat) si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve, si dhe të rivlerësohet llogaria 202 studime e kërkime për vlerën kontabël neto 30,066,269 lekë.

Me mbylljen e bilancit kontabël të vitit të ardhshëm

10. Gjetje nga auditimi: Bashkia Mat, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të óUjësajllës Matô ShA. me NUIS óJ68103917Fô e cila është shoqëri aksionere me objekt óShërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëveô. Numri i aksioneve është 1 me vlerë nominale 729,777,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 729,777,000 lekë



Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Mat në ÕUjësjeellës Matõ ShA., në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2019 dhe 2020, më konkretisht në llogarinë 26 ÕPjesëmarrje në kapitalet e vetaõ në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 ÕPër shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuarõ me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 ÕAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomaterialeõ pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 ÕTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeõ. ***Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) 729,777,000 lekë dhe investitori është Bashkia Mat.*** Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksionerëve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël **729,777,000 lekë** përbën shtrembërim të informacionit financiar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 119-133, të Raportit të Auditimit).*

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të ÕUjësjeellës Matõ ShA me vlerë kontabël **729,777,000 lekë** në debi të llogarisë 26 ÕPjesëmarrje në kapitalin e vetõ dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e bilancit kontabël të vitit të ardhshëm

11. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 ÕKreditore për mjete nën ruajtjeõ, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Mat, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 18,402,483 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, ose shumën 18,261,283 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2019 dhe 2020, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 ÕKreditore për mjete nën ruajtjeõ duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Pra llogaria 466 ÕKreditore për mjete nën ruajtjeõ është mbivlerësuar për **5,700,271 lekë për vitin 2020 dhe 5,037,881 lekë për vitin 2019**, për të cilat duhet të bëhet sistemimi i llogarisë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 3.3 ÕLlogaria 466 Kreditore për mjete në ruajtjeõ, në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 ÕPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeõ, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 118-132, të Raportit të Auditimit).*

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë 466 ÕKreditore për mjete nën ruajtjeõ duke rakorduar me Drejtorinë e Shërbimeve çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466 si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Me mbylljen e bilancit kontabël të vitit të ardhshëm

12. Gjetje nga auditimi: Llogaria 467 ÕKreditore të ndryshëmõ paraqiten faturat e pa likuiduara, vendime gjyqësore dhe investime dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2020 paraqiten në shumën 19,924,791 lekë, e cila përbëhet nga:

- shpenzime të kryera por të pafinacuara për mallra dhe shërbime në masën 15,212,010 lekë
 - shpenzimet për vendime gjyqësore në shumën 3,750,850 lekë;
 - shpenzime të tjera për sigurime shoqërore, shëndetësore dhe shpërblim këshilli dhe kryetarë fshatrash por të pa likuiduara në shumën 961,931 lekë.
- dhe që janë pasqyruar në llogarinë 486 në shumën **19,924,791 lekë**.



Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Mat nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar 3 pagesa faturash të cilat paraqiten të likujduara në 2021 por të paregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2020 me vlerë totale **14,330,439 lekë**. Kjo procedurë mospasqyrimi në llogarinë 467 óKreditorë të ndryshëm të detyrimeve për faturat e likujduara në 2021 por me kompetencë vitin 2020, përbën shtrembërim të informacionit financiar, duke qenë se detyrimet e prapambetura për vitin 2020 të përcjella në Ministrinë e Financave **janë nënvlerësuar me 14,330,439 lekë**. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 42 në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 118-132, të Raportit të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë 467 óKreditorë të ndryshëm, e cila është nënvlerësuar me 14,330,439 për vitin 2020. Ky sistemim të bëhet duke e transferuar këtë vlerë nga llogaria 41-408 óFurnitorë e llogari të lidhura me to, në llogarinë 467 óKreditorë të ndryshëm. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

Me mbylljen e bilancit kontabël të vitit të ardhshëm

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportit të inventarizimit të aktiveve të institucionit dhe kontratës së shërbimit të pastrimit në Bashkinë Mat, u konstatua:

1. Kontraktuesi i shërbimit të pastrimit të Bashkisë Mat, përpara vitit 2018, ka qenë kompania óKô shpk me administrator z. G K.

2. Kontraktuesi i shërbimit të pastrimit të Bashkisë Mat, nga data 09.03.2018 deri 31.12.2021 ka qenë kompania óA Gô shpk me administrator të asaj periudhe z. K M, si dhe administrator aktual z. B B. Kjo kompani është përfaqësuar dhe i ka transferuar 100% të detyrimeve kontraktuale nëpërmjet prokurës nr.312 rep, nr.82/2 kol tek kompania óE lô shpk me administrator z. K K. Ky veprim transferimi është bërë në kundërshtim të plotë me kontratën e lidhur mes Bashkisë Mat dhe kontraktuesit óA Gô shpk (neni 36.1), pasi në kontratë nuk përcaktohet nënkontraktimi, veprim në kundërshtim me;

- nenin 61 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,

- nenin 75 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi në DST nuk përcaktohet nënkontraktimi si opsion i pjesëmarrjes në tender të kontraktorit óA Gô shpk.

3. Nga data 09.03.2018 deri 29.06.2019, kontenierët e bashkisë Mat, nuk i janë dorëzuar kontraktuesit óA Gô shpk, megjithëse në situacionet e tyre paraqiten zërat e *grumbullimit të mbeturinave dhe marrja e tyre nga kontenierët për në vend depozitim*.

4. Në datën 29.06.2019 u janë transferuar kontenierët, me një autorizim të datës 28.06.2019 në kundërshtim me ligjin dhe udhëzimin për ruajtjen e aktiveve, nga kompania óKô shpk me administrator z. G K, tek marrësi në dorëzim z. K K, ky i fundit administrator i përfaqësueses óE lô shpk si dhe i biri i z. G K (referuar statutit të themelimit të shoqërisë).

5. Referuar pikës 3, në popullatën e likujdimeve të faturave të kontraktuesit óA Gô shpk për shërbimin e pastrimit të Bashkisë Mat nga data 09.03.2018 deri 29.06.2019, është përzgjedhur kampioni prej 2 muaj (shkurt, mars 2019). Në këtë kampion janë konstatuar situacione me zërat e punimeve *grumbullimi i mbeturinave dhe marrja e tyre nga kontenierët për në vend depozitim*.

6. Në ekstraktin historik të shoqërisë óA Gô shpk, ekstrakt ky i nxjerrë në datën 04.02.2021 nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në seksionin óVende të tjera të ushtrimit të aktivitetit, në asnjë rast nuk paraqitet ushtrimi i aktivitetit në territorit e Bashkisë Mat. Gjithashtu kjo



kompani nuk rezulton as në regjistrat e biznesit të Bashkisë Mat. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 118-132, të Raportit të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat të mmarë masa për ngritjen e një grupi pune për inventarizimin e aktiveve që janë nën përgjegjësinë materiale të Drejtorisë së Shërbimeve, duke përfshirë këtu dhe të gjitha aktivet që i janë dorëzuar shoqërisë A G SHPK. Gjithashtu nga ana e Kryetarit të Bashkisë Mat, të ndërmerren hapa konkretë në evidentimin e kushteve në të cilën ka vepruar dhe ekzekutuar kontratën e shërbimit të pastrimit shoqëria A G SHPK, në raport me AK Bashkia Mat, duke pasur parasysh evidencat që kanë dalë nga auditimi.

Menjëherë

14. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm u konstatua se akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

“Mjedisi i kontrollit”

Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit. Nga verifikimi rezulton se GSM nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë. Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS. Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive.

“Menaxhimi i Riskut”

Mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Nuk është bërë vlerësimi i riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, duke penguar marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Mat nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT.

“Informimi dhe Komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Nga Bashkia Mat kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, por konsultimet publike nuk janë të plota dhe mungon dokumenti i konsultimit publik.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Auditimi i brendshëm nuk ka dhënë vlerësime të plota për sistemin e kontrollit të brendshëm. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin e ndryshuar dhe Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 20-32, të Raportit të Auditimit).*



14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat me atributet e Kryetarit të GMS në bashkëpunim me Koordinatorin e Riskut të institucionit, të marrë masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

14.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa që të planifikojë dhe kryejë Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtëm të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Njësia e Auditit të Brendshëm, Bashkia Mat, për periudhën objekt auditimi, nuk ka vlerësuar si duhet riskun, duke mos audituar drejtoritë që mbartin risk të lartë. Në këtë mënyrë nuk i ka dhënë siguri të plotë Titullarit të institucionit për realizimin e objektivave.

-Për rekomandimet e lëna në auditimet e mëparshme nuk ka hartuar program të veçantë për auditimin e nivelit të zbatimit të tyre, duke sjellë që Titullari i institucionit të mos informohet mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditivet e kryera;

-Nga NJAB nuk është bërë kontrolli i cilësisë për çdo auditim, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Dy nga audituesit e NJAB nuk janë të certifikuar.

-Gjithashtu dosjet e auditimit nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore, por mbahen në ambientet e brendshme të Sektorit të Auditit të Brendshëm. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën óô në nenin 6, nenin 13, shkronjat óô dhe óô në nenin 14, shkronja óô në nenin 16 të Ligjit nr. 114/2015 óPër auditimin e brendshëm në sektorin publikó, Ligjin nr.9154, datë 06.11.2003 óPër arkivató. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1, faqe 32-37, të Raportit të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Mat, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

15.2. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Mat, të marrë masa të menjëhershme për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

15.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat të marrë masa që punonjësit pa certifikatë të NJAB, të pajisjen me certifikata të auditit të brendshëm, si dhe kryerjen e trajnimeve të vazhdueshme.

15.4. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Mat, të marrë masa që të sigurojë paraqitjen në mënyrë periodike para nivelit drejtues të institucionit dhe Këshillit Bashkiak të raporteve të përmbledhura për rezultatet e veprimtarisë së auditimit, në mënyrë që të realizojë misionin e saj, ku veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari e pavarur, që mbështet menaxhimin e njësisë vendore për arritjen objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime, që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

B.1.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në përcaktimet e bëra në shkronjën óô në nenin 15 në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 óPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitó, shkronjën óô



në pikën 1.1 dhe shkronjën óô në pikën 1.6 në nenin 9 dhe shkronjën ógô në nenin 64, në Ligjin nr.139/2015 óPër vetëqeverisjen vendore, i ndryshuar, si dhe nenin 2, nenin 32, nenin 66, nenin 68, nenin 153 dhe nenin 154 në Ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 óKodi i procedurës civile në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, nga Kryetari i Bashkisë të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore, shpërblimi i dëmit të krijuar ndaj buxhetit të Bashkisë Mat në vlerën **21,133,920 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Mat me palët e treta, u konstatua se nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve, Sektori i Infrastrukturës, Emergjencës dhe Pronave, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (përlogaritje e gabuar e tarifave, mosaplikim i kamatvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e tarifave të qirave, etj), veprime dhe mosveprime të cilat kanë krijuar dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën 21,133,920 lekë, nga të cilat 4,682,674 lekë krijuar brenda vitit 2021. Konkretisht veprimet dhe mosveprimet janë konstatuar në marrëdhëniet kontraktuale si vijon: 1 kontratë enfiteoze për pasurinë e llojit óParku i lojrave, 5 kontrata për fond pyjor për vendosje të antenave të telefonisë celulare, 1 kontratë për sipërfaqe kullimore për kullotjen e bagëtive, 1 kontratë për fond pyjor për agropylltari, 29 kontrata për fond pyjor për ndërtimin e hidrocentraleve, si dhe 19 kontrata për qiradhënie të banesave sociale. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 142 dhe 154 në Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 óPër Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar; Pikën 5 në nenin 3, pikën 1 në nenin 16, shkronjën ógô në pikën 1 në nenin 17, shkronjën óô në pikën 1, pika 3 në nenin 25, pikën 1 dhe 4 në nenin 34, shkronjë óaô të pikës 2 në nenin 35 në Ligjin nr.57/2020 óPër pyjet; Pikën 2 në VKM nr.391 óPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010; Pikën 2, kreu I, në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 óPër përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat të analizojë sitatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës 21,133,920 lekë, sipas aneksit nr.VII, bashkangjitur raportit përfundimtar të auditimit.

Menjëherë

B.2.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Mat, konkretisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore, u konstatua se në 6 raste për vlerën 14,262,191 lekë, nuk është respektuar radha e likuidimit të tyre, sipas parimit óhyrje e parë-dalje e parë, si dhe nuk janë kryer likuidimet e plota të detyrimeve, megjithëse Bashkia Mat në fund të viteve 2019-2020-2021 ka patur disponibilitete në thesar.

-Sipas të dhënave të Sektorit Juridik, ka pasur 5 raste të punonjësve që kanë ankimuar në gjykatë ndaj Bashkisë Mat për largime nga puna pa shkaqe të arsyeshme ligjore, për të cilët ka përfunduar gjykimi dhe vendimi ka marrë formë të prerë për shumën 11,638,547 lekë, një pjesë e të cilave i përkasin periudhave të para këtij auditimi. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë, si dhe në urdhrin e likuidimit nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij ka krijuar detyrime të Bashkisë Mat ndaj palëve të treta.



Për likuidimin e detyrimit të mësipërm janë kryer pagesa pjesore në vlerën 1,930,648 lekë, që përfaqëson efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Mat (praktikisht paguhen dy persona për një vend pune) duke ndikuar në performancën financiare dhe funksionale të institucionit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 8 dhe 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, i ndryshuar; Udhëzimi nr.1, datë 04.06.2014 për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura nga vendimet gjyqësore, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat të marrë masat e nevojshme për analizimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, duke identifikuar personat përgjegjës dhe vendosjen e masave administrative ndaj tyre, si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Sektorin Juridik të bashkëveprojnë për shmangien e penalizimeve të tilla financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

B.3.TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifat vendore, për periudhën 2019-2021, u konstatua senë fund të vitit 2021 në Bashkinë Mat dhe NJA janë debitor 425 subjekte në vlerën 39,819,389 lekë (11,036,034 lekë debitor krijuar brenda vitit 2021), vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Mat, e ndarë si më poshtë vijon:

-5 subjekte óBiznesi Vipó debitor në vlerën 5,114,318 lekë

-59 subjekte óBiznesi i Madhó në vlerën 13,890,241 lekë

-273 subjekte óBiznesi i Vogëló në vlerën 16,659,480 lekë

-10 subjekte óLojra Fatió në vlerën 722,515 lekë

-2 subjekte óKompani sigurimeshó në vlerën 60,500 lekë

-46 subjekte óTregtar Ambulantó në vlerën 1,053,335 lekë

-30 subjekte óInstitucioneó në vlerën 2,319,000 lekë.

-Për debitorët e krijuar më sipër, konstatohet se, nuk është aplikuar kamatëvonesë rast pas rasti, për mos likuidim të detyrimit tatimor, nuk janë ndjekur plotësisht masat shtrënguese me qëllim arkëtimin e detyrimeve të prapambetura. Kjo situatë është krijuar edhe si rrjedhojë e mospërditësimit të regjistrit të subjekteve të mësipërme që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Mat, ku ka subjekte të cilat megjithëse kanë mbyllur aktivitetin e tyre/ose kanë ndryshuar adresën e aktivitetit, vazhdojnë të qëndrojnë në të njëjtën situatë në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 76 dhe nenin 114, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në RSH, i ndryshuar; Pikat 1, 2 në nenin 4, neni 9, pikat 1 dhe 2 në nenin 20, pikën 1 në nenin 22, nenin 22/5, nenin 24, shkronjën ócó të pikës 3 në nenin 27, neni 34 dhe neni 35, në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për sistemin e Taksave Vendore, i ndryshuar; VKB nr.1, datë 04.01.2019, VKB nr.54, datë 24.12.2019 dhe VKB nr.137, datë 22.12.2020 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë Mat, me qëllim përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët (bllokim të llogarive



bankare, njoftim të Drejtorisë Rajonale të Transportit për vendosje të barrës siguruese për mjetet dhe në ASHK për pasuritë e paluajtshme, etj.) për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, në vlerën 39,819,389 lekë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifave vendore, për periudhën 2019-2021, u konstatua senë fund të vitit 2021 në Bashkinë Mat dhe NJA, vlera debitore e kategorisë ofamiljarë është 36,597,002 lekë (26,950,964 lekë debitor krijuar brenda vitit 2021), vlerë e cila përbën të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Mat, e ndarë si vijon:

- 5,094 familje debitore nga 11211 gjithësej, në vlerën 1,018,800 lekë për tarifën e ndriçimit;
- 10,676 familje debitore nga 11211 gjithësej, në vlerën 13,578,900 lekë për tarifën e shërbimit (pastrim, gjelbërim, dekor);
- 9323 familje debitore nga 11211 gjithësej, në vlerën 8,692,984 lekë për taksën e ndërtesës;
- 5351 familje debitore nga 11211 gjithësej, në vlerën 460,480 lekë për taksën e truallit;
- 10,666 familje debitore nga 11211 gjithësej, në vlerën 3,199,800 lekë, për tarifën e infrastrukturës arsimore. Për situatën e mësipërme, nga UK Sh.A., Mat nuk janë marrë masa për arkëtimin e vlerës debitore, si dhe nga Bashkia Mat nuk është marrë masë për gjatësimin në masën 50% të vlerës së pa arkëtuar të agjentit tatimor UK Sh.A. Këto veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 5, nenin 8, nenin 11 dhe nenin 19 në VKB nr.1, datë 04.01.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2019; Nenin 5, nenin 8, nenin 11 dhe nenin 19 në VKB nr.54, datë 24.12.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2020; Nenin 4, nenin 6, nenin 8 dhe nenin 17 në VKB nr.137, datë 22.12.2020 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat të marrë masat e nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar si pasojë e detyrimeve të krijuara nga puna e dobët e UK Sh.A., Mat (në rolin e agjentit tatimor) për taksat dhe tarifave vendore nga abonentët familjarë, me qëllim marrjen e përgjegjësisë ligjore nga palët dhe shmangien e veprimeve abuzive në mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

2.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore si edhe të përditësohet regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave.

2.3. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 36,597,002 lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për planifikimin dhe arkëtimin e taksës së tokës bujqësore, u konstatua se, vlera debitore gjithësej për këtë taksë, krijuar përgjatë periudhës 2019-2021 është 1,933,203 lekë (nga të cilat 567,389 lekë krijuar brenda vitit 2021), vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Mat. Gjithashtu konstatohet se, regjistrat e tokës nuk janë të përditësuar sipas ndryshimeve të bëra vit pas viti në kadastrë për tokat në disponim dhe përdorim dhe nuk janë bërë njoftim-detyrime për të gjithë fermerët e evidentuar. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 10 në VKB nr.1, datë 04.01.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2019; Nenin 10 në VKB nr.54, datë 24.12.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2020; Nenin 7 në VKB nr.137, datë 22.12.2020 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të*



Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Tokës, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse dhe verifikimit në terren.

3.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të nxjerrë njoftim detyrimin për familjet, si dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **1,933,203 lekë**.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale, u konstatua se, vlera debitore për këtë taksë krijuar përgjatë periudhës 2019-2021, për 81 posedues të lejes së legalizimit është **2,726,502 lekë**, e cila përfaqëson të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat. Për debitorët e mësipërm nuk janë marrë masat e nevojshme të përcaktuara në nenet 90-91 në Kreun XI të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 óPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. Theksojmë se, nga sektori i urbanistikës janë bërë njoftimet për pagesën e taksës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 13 në VKB nr.1, datë 04.01.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2019; Nenin 13 në VKB nr.54, datë 24.12.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2020; Nenin 10 në VKB nr.137, datë 22.12.2020 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 2,726,502 lekë, për legalizimin e objekteve informale.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekur për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV dhe Policia Bashkiake, u konstatua se, për gjobat e vendosura nga IMTV dhe Policia Bashkiake, nga Kryetari i Bashkisë Mat dhe Kryeinspektori i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit nuk është bërë kërkesë në gjykatën përkatëse për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit të tyre, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën **4,476,742 lekë** në buxhetin e Bashkisë Mat. Mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 óPër kundërvajtjet administrative; Nenet 164 dhe 165 të Ligjit nr.44/2015 óKodi i Procedurës Administrative në RSH; Nenin 14 në Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 óPër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, i ndryshuar; Nenin 13 në Ligjin nr.8224, datë 15.5.1997 óPër organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-118, të Raportit të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat në bashkëpunim me drejtuesit e sektorëve të mësipërm, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 4,476,742 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi përlllogaritjet për taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit për subjektet óBiznesi Vip, óBiznesi i Madh dhe óBiznesi i Vogël, që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë Mat, u konstatua se, për periudhën 2019-2021 janë përjashtuar/përlllogaritur gabim taksa e ndërtesës dhe tarifa e shërbimit për subjektet e mësipërme, konkretisht: Për taksën e ndërtesës 10 subjekte óbiznesi i madh, 40 subjekte óbiznesi i vogël dhe 6 subjekte me aktivitet HEC; Për tarifën e shërbimit 42 subjekte óbiznesi i madh dhe 10 subjekte me aktivitet HEC, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën **15,148,685 lekë**, në buxhetin e Bashkisë Mat. Veprimet dhe



mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 5 dhe nenin 20 në VKB nr.1, datë 04.01.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2019; Nenin 5 dhe nenin 20 në VKB nr.54, datë 24.12.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2020; Nenin 4 dhe nenin 18 në VKB nr.137, datë 22.12.2020 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit).*

6.1.Rekomandimi:Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masat e nevojshme, duke vlerësuar dokumentacionin (kontratë qiraje, dokument pronësie, leje ndërtimi, etj), kryer verifikimet në terren për subjektet e mësipërme, si dhe në vijim, njoftimin për vlerësimin e detyrimit tatimor, si dhe ndjekjen etë gjithë procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës 15,148,685 lekë.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve u konstatua se 18 subjekte, që operojnë në territorin në Juridiksionin e Bashkisë Mat nuk është aplikuar saktë tarifa e licencimit, *me pasojë të ardhura të munguara në vlerën prej 18,850,000 lekë për buxhetin e Bashkisë Mat.* Gjithashtu konstatohet se, 14 subjekte për 17 stacione të shitjes së karburanteve, të cilët kanë ushtruar aktivitet për tregtimin e karburanteve përgjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2021, nuk janë pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit, ku 3 prej tyre, nuk janë të regjistruar në QKB, duke operuar në informalitet. Për këtë situatë nuk janë marrë masat e nevojshme, si për njoftimin e tyre për detyrimin e pajisjes me licencë për ushtrimin e aktivitetit, ose në të kundërt njoftimin e Inspektoratit përkatës dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për bllokimin e aktivitetit, etj. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 të nenit 4, pikat ôi-viô në shkronjën ôçô në nenin 5 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 ôPër sistemin e Taksave Vendore, i ndryshuar; Pikat 15.1 dhe 15.2 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 ôPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajô i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi:Kryetari i Bashkisë Mat, nëpërmjet sektorit të licencimit dhe sektorit të taksave dhe tarifave vendore, të marrë masat e nevojshme, për identifikimin dhe pajisjen me licencë të ushtrimit të aktivitetit subjektet të cilat nuk e disponojnë një të tillë. Gjithashtu të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e detyrimeve ndaj subjekteve të cilat kanë pasur licencë të ushtrimit të aktivitetit, por nuk kanë kryer pagesën/paguar pjesërisht tarifën përkatëse, në vlerën 18,850,000 lekë në total.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e shërbimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike në territorin e Bashkisë Mat, ukonstatua se, për periudhën 2019-2021 kanë kryer punime ndërtimi me fondet e Bashkisë Mat, 9 operatorë ekonomik të shpallur fitues, nga të cilët vetëm 1 prej tyre ka paguar tarifën e shërbimit dhe 9 nuk e kanë paguar, *duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 504,001 lekë.* *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit).*

8.1.Rekomandimi:Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të nxjerrin njoftim detyrimin për tarifën e shërbimit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës prej 504,001 lekë.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETQEVERISJES VENDORE RAPORT AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË MAT

II. Bazuar në nenet 111 - 131 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 óPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëô i ndryshuarsi dhe në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 óPër parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmitô, dhe nenin 15 shkronja (c dhe ç), nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, óPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitô, i rekomandojmë **Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve**, shqyrtimin e informacionit për aktin abuziv në lidhje me aktivitetin financiar të shoqërive private si më poshtë:

Subjektet private, pjesë e konstatimeve:

1-óA Gô shpk

2-óE1ô shpk

Palë të lidhura

3-óKô shpk

4-Bashkia Mat, përfaqësuar në kontratë nga ish Kryetari i Bashkisë z. N R.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT